

**DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR
I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË
FERIZAJT 2026 – 2034**



TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE	8
2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE	10
2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN	10
2.2. PROCEDURA E VSM-së	10
2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së	10
2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së	11
2.5. OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA.....	11
2.6. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT	12
2.6.1. KONVENTA ÅRHUS	12
2.6.2. KONVENTA ESPOO	12
2.6.3. PROTOKOLLI I KIEVIT	12
2.7. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE	13
2.7.1. LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR.....	13
2.7.2. LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR	14
2.8. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME.....	15
3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM-së.....	15
3.1. OBJEKTIVAT	15
3.2. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së	15
4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE.....	18
4.1. POZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE	18
4.2. VEÇORITË MJEDISORE	18
4.2.1. GJELOGJIA DHE PEDOLOGJIA.....	18
4.2.2. RELIEVI, LARTËSIA MBIDETARE DHE PJERRËSIA.....	21
4.2.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE	23
4.2.4. KUSHTET KLIMATIKE	24
4.2.5. BIODIVERSITETI, FLORA DHE FAUNA	25
4.2.6. PYJET DHE VEGJETACIONI	26
4.2.7. ZONAT E MBROJTURA DHE TRASHËGIMIA NATYRORE.....	26
4.2.8. FAKTORËT MJEDISORË DHE NIVELET E NDOTJES, KU MUND TA NDAJMË NË AJËR, UJË, TOKË DHE ZHURMË.....	26
4.2.9. SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI.....	29

5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE.....	31
5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE.....	31
5.1.1. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR.....	31
5.1.2. ZONAT ME NDJESHMËRI TË VEÇANTË MJEDISORE.....	33
6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHK-së	35
6.1 QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK SIPAS FUSHAVE TEMATIKE.....	35
6.1.1 ZHVILLIMI EKONOMIK.....	36
6.1.2 INFRASTRUKTURA TEKNIKE.....	37
6.1.3 INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI	39
6.1.4 INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE.....	40
6.1.5 MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI	42
6.1.6 TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE.....	43
6.1.7 VENDBANIMET	44
6.1.8 VENDBANIMET JO FORMALE	45
6.1.9 BANIMI	46
6.1.10 SHFRYTËZIMI I TOKËS.....	46
6.2 KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR	47
6.2.1 ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE.....	48
6.2.2 POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK	48
6.2.3 VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN	49
6.2.4 ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS.....	50
6.2.5 ÇËSHTJE MJEDISORE QË LIDHEN ME MJEDISIN FIZIK.....	52
6.2.6 ÇËSHTJE MJEDISORE QË LIDHEN ME BIODIVERSITETIN, FLORËN DHE FAUNËN.....	53
6.2.7 PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS DHE ÇËSHTJE TË SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE.....	53
6.2.8 RREZIQET NATYRORE NË MJEDISIN FIZIK.....	54
7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE	55
7.1 OBJEKTIVAT E VSM	55
7.2 PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL	57
7.3 QËLLIMET STRATEGJIKE.....	58
7.4 PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGJISË	61
8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE	63
8.1 METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE	63
8.2 PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT	64

8.3	ANALIZA E NDIKIMEVE	65
8.4	PËRPUTHSHMËRIA MJEDISORE.....	67
8.5	EFEKTET KUMULATIVE.....	71
9.	MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT	74
9.1	KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, ZHVILLIMI KOMPAKT.....	74
9.2	NDRYSHIMET KLIMATIKE.....	74
9.3	CILËSIA E AJRIT	75
9.4	HAPËSIRAT E GJELBRA DHE INFRASTRUKTURA E GJELBËR	75
9.5	ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME DHE EFIÇIENCA ENERGJETIKE	76
9.6	MBROJTJA E TOKËS.....	76
9.7	MBROJTJA E RESURSEVE UJORE	77
9.8	REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE	77
9.9	MENAXHIMI I MBETURINAVE	78
10.	PLANI I MONITORIMIT.....	79
11.	PËRFUNDIME	83
12.	LITERATURA	85
13.	LEGJISLACIONI DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE.....	86

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës	17
Tabela 2 Komponentët mjedisor të parapara në raportin e VSM.....	63
Tabela 3 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore	66
Tabela 4 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit në funksion të Objektivave Mjedisore	69
Tabela 5 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së	71
Tabela 6 Plani i Monitorimit Mjedor	82

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 Karakteristikat gjeologjike, Komuna e Ferizajt	19
Figura 2 Formacionet pedologjike, Komuna e Ferizajt	20
Figura 3 Hipsometria e terrenit	21
Figura 4 Pjerrësia e terrenit.....	22
Figura 5 Karakteristikat hidrografike, Komuna e Ferizajt.....	23
Figura 6 Potenciali fotovoltai, Komuna e Ferizajt	24
Figura 7 Vlerat e llogaritura të biodiversitetit, Komuna e Ferizajt.....	25
Figura 8 Zonat me përqendrim të aktiviteteve industriale në Komunën e Ferizajt	32

LISTA E SHKURTIMEVE

AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

ASK – Agjencia e Statistikave të Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

CO – Monoksidi i karbonit

DBP – Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari

DSHMS – Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

DSHPE – Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia

DUMM – Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

FKEE – Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë

GIS – Sistemi i Informacionit Gjeografik

HZK – Harta Zonale Komunale

IHMK – Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

IKMN – Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

ITUZ – Impianti për Trajtimin e Ujërave të Zeza

KEDS – Kompania Kosovare për Distributim të Energjisë Elektrike

KOSTT – Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës

KRM – Kompania Rajonale e Mbeturinave

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjetësimit

MBPZHRR – Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

NO₂ – Dioksidi i azotit

O₃ – Ozoni

OBSSH – Organizata Botërore e Shëndetësisë

OM – Objektiv Mjedisor

OJQ – Organizatë Joqeveritare

PM₁₀ – Grimecat e suspenduara me diametër aerodinamik deri në 10 µm

PM_{2.5} – Grimecat e suspenduara me diametër aerodinamik deri në 2.5 µm

PRrH – Plani Rregullues i Hollësishëm

PZHK – Plani Zhvillimor Komunal

RWH – Rainwater Harvesting – Sistemi për grumbullimin dhe ripërdorimin e ujërave të shiut

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

SDG – Sustainable Development Goals – Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

SO₂ – Dioksidi i squfurit

UNECE – Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën

VNM – Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

VSM – Vlerësimi Strategjik Mjedisor

1. HYRJE

Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) për politika, plane dhe programe vlerëson pasojat qysh në fazat e hershme të vendimmarrjes. Gjithashtu VSM është një proces që synon integrimin e konsideratave mjedisore në përgatitjen dhe miratimin e planeve, programeve dhe politikave. Koncepti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor vjen nga politikat dhe programet e niveleve më të larta të planifikimit dhe shfrytëzimit të tokës të cilat kanë synime strategjike dhe vizionare dhe për të cilat kërkohet VSM sipas ligjit.

Qëllimi i raportit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Ferizajt është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit, si dhe të ofrojë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore. Në raportin e VSM-së duhet të përfshihen edhe propozimi i masave për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e Planit Zhvillimor Komunal.

Metodologjia e ndjekur është në përputhje me Direktivën 2001/42/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, dhe ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, i cili është transpozim i Direktivës 2001/42/EC të Bashkimit Evropian dhe përcakton kushtet, procedurat dhe mënyrën e vlerësimit strategjik të mjedisit për të siguruar mbrojtjen e tij dhe shëndetit të njeriut.

Vlerësimi i strukturuar mjedisor për Planin Zhvillimor Komunal të Ferizajt do të organizohet si vijon:

- Përmbledhje të informacionit bazë për vlerësimin mjedisor; përshkrimin e vizionit, prioritetëve dhe objektivave kryesore të Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt dhe marrëdhëniet e tij me politikat, planet dhe programet e tjera që kanë lidhje me të;
- Përshkrimin e aspekteve të gjendjes aktuale të mjedisit si edhe zhvillimet e pritura në rast të mos zbatimit të planit;
- Përshkrimin e karakteristikave mjedisore të zonave që kanë të ngjarë të ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga plani;
- Përshkrimin e problemeve ekzistuese mjedisore të cilat kanë lidhje me planin;
- Përshkrimin e objektivave për mbrojtjen e mjedisit të përcaktuara në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të cilat kanë të bëjnë me planin dhe programin si dhe mënyrat në të cilat këto objektiva janë marrë parasysh gjatë përgatitjes së raportit;
- Përshkrimin e ndikimeve të mundshme dhe të konsiderueshme në mjedis duke përfshirë shëndetin publik, florën, faunën, biodiversitetin, tokën, klimën, ajrin, ujin, peizazhin, zonat natyrore, vlerat materiale, trashëgiminë kulturore si dhe ndërveprimin ndërmjet këtyre faktorëve;
- Efektet kumulative të komponentëve mjedisore;
- Përshkrimin e masave që parashikohen për parandalimin, reduktimin dhe/ose lehtësimin e ndikimeve negative në mjedis, të cilat mund të rezultojnë nga zbatimi i planit;
- Përmbledhje e alternativave të shqyrtuara, duke përfshirë vështirësitë e ndryshme ose mungesën e të dhënave që hasen gjatë përpilimit të raportit;
- Përshkrimin e planit të monitorimit dhe raportimit.

Të dhënat dhe informacionet për komunën e Ferizajt janë siguruar nga Komuna dhe drejtoritë përkatëse, nga hulumtime të ndryshme të kryera për këtë komunë, nga Plani Zhvillimor Komunal i vjetër dhe hulumtime tjera nga interneti.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

Ky raport përgatitet në funksion të dokumentit të ri planifikues dhe adreson ndryshimet, zhvillimet dhe kërkesat aktuale ligjore e mjedisore, për dallim nga dokumenti i vjetër. Si i tillë, ai synon të sigurojë që zhvillimet e ardhshme të jenë në përputhje me legjislacionin vendor për mjedisin, si dhe me direktivat dhe konventat ndërkombëtare përkatëse.

2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE

2.1. DIREKTIVA E VLERËSIMIT STRATEGJIK MJEDISOR E BASHKIMIT EVROPIAN

Direktiva 2001/42/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, u aprovua më 27 Qershor 2001. Kjo direktivë vlen për një varg të gjerë të planeve dhe programeve publike të cilat janë subjekt i përgatitjes dhe/ose miratimit nga një autoritet në nivelin kombëtar, rajonal ose lokal, ose që përgatiten nga një autoritet për miratim përmes procedurave legjislative dhe të cilat kërkohen nga dispozitat legjislative, rregullatore ose administrative.¹

Sipas Direktivës 2001/42/EC, Vlerësimi Strategjik Mjedisor është i detyrueshëm për planet dhe programet që:

- Përgatiten për sektorë si bujqësia, pylltaria, peshkimi, energjetika, industria, transporti, menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave, telekomunikimi, turizmi, planifikimi urban dhe rural ose shfrytëzimi i tokës, dhe që vendosin kornizën për miratimin e projekteve të ardhshme të listuara në Direktivën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM);
- Kërkojnë vlerësim sipas Direktivës për Vendbanimet (EU Habitats Directive).

Për planet dhe programet që nuk përfshihen drejtpërdrejt në këto kategori, shtetet anëtare janë të obliguara të zbatojnë procedurën e shqyrtimit (screening), me qëllim të përcaktimit nëse ato mund të kenë ndikime të rëndësishme mjedisore. Në rast se konstatohet një ndikim i tillë, realizimi i VSM-së bëhet i domosdoshëm. Kjo procedurë bazohet në kriteret e përcaktuara në Shtojcën II të Direktivës.

2.2. PROCEDURA E VSM-së

Raporti i VSM përgatitet dhe në të identifikohen efektet domethënëse të mundshme në mjedis dhe alternativa të arsyeshme të planit ose programit të propozuar. Autoritetet publike dhe mjedisore informohen dhe konsultohen lidhur me projektin e planit ose të programit dhe përgatitet raporti VSM. Raporti VSM dhe rezultatet e konsultimeve merren parasysh para aprovimit. Me aprovimin e planit apo programit, informohen autoritetet mjedisore dhe opinioni, si dhe informatat përkatëse vihen në dispozicion të tyre. Në mënyrë që të identifikohen efektet e pa parashikueshme jo të favorshme në fazat e hershme, efektet domethënëse mjedisore të planit ose të programit duhet të monitorohen.

2.3. DIREKTIVA TË TJERA TË BE-së

Ekzistojnë shumë direktiva të tjera të BE-së me të cilat Direktiva VSM ka lidhje të qarta dhe të cilat janë të rëndësishme nëse janë duke u shqyrtuar çështjet mjedisore. Sipas Marsden (2008) VSM-ja ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën e VNM, në veçanti me që vlerësimi i mjedisit për sektorët e shënuar nën këtë të fundit duhet ta vendosë kornizën për projektet e shënuara nën këtë të parën. Po ashtu ka lidhje të ngushta procedurale me Direktivën për Vendbanimet, e cila përmendet qartë në direktivën e VSM. Direktiva Kornizë për Ujërat bashkërisht me Direktivën për Vendbanimet përmban kërkesat e veta jo vetëm për paraqitjen e planeve dhe të programeve, por po ashtu edhe të vlerësimit, duke nxitur nevojën për procedura të bashkërenduara ndërmjet ligjeve të ndryshme.

¹ <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:32001L0042>

2.4. STRATEGJIA 2020 E BE-së

Përveç dokumenteve legjislativ të BE-së të përmendura më sipër, strategjia 2020 e BE-së me prioritetet, objektivat dhe nismat më të mëdha, është dokument i rëndësishëm i politikave si për vetë BE-në ashtu edhe për rajonet fqinje, në veçanti Ballkanin Perëndimor, duke qenë se bashkëpunimi rajonal me këtë rajon është identifikuar si njëri prej prioritetëve të politikave për BE-në. Në kuadër të strategjisë 2020 të BE-së zgjerimi i mundshëm i BE-së me vendet e Ballkanit Perëndimor është identifikuar si mjet i jashtëm i politikave për zhvillim dhe vende pune. Prioritetet strategjike përfshijnë “zhvillimin e shpejtë, të qëndrueshëm, gjithëpërfshirës”. Janë shtatë nisma të mëdha si: “Evropa efikase sa ju përket burimeve” dhe “Një politikë industriale për epokën e globalizimit” të lidhura drejtpërdrejtë me çështjet e qëndrueshmërisë. Nisma të tjera si “Agjenda Digjitale për Evropën”, “Unioni i Përtëritjeve”, “Rinia në lëvizje”, “Një agjendë për shkathtësi dhe vende të reja pune” dhe “Platforma evropiane kundër varfërisë”, gjithashtu kanë një kontribut në parimin e zhvillimit të qëndrueshëm nëse do të zbatoheshin në mënyrë efikase.

Strategjia gjithashtu përfshin objektivat e matshëm që duhet të arrihen gjatë periudhës së zbatimit, nuk ka dyshim që është plotësisht e dobishme si për shtetet anëtare aktuale ashtu edhe për ato të ardhshmet që të bashkëpunojnë në mënyrë që t’i arrijnë objektivat mjedisore të strategjisë, siç janë:

- Zvogëlimi prej 20% i emetimeve të gazrave serrë;
- 20% rritje të shkallës së energjisë nga burime të ripërtëritshme efikase të energjisë.

Prandaj është e arsyeshme që drejtimi i këtyre objektivave të integrohet në strategjitë dhe në planet e veprimit mjedisore kombëtare, rajonale dhe lokale, përfshirë procedurat për vlerësimin strategjik të mjedisit.

2.5. OBJEKTIVAT ZHVILLIMOR TË MIJËVJEÇARIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA

Kombet e Bashkuara kanë një rol aktiv në zhvillimin e Kosovës. Edhe pse jo shtet anëtar, KB vepron në Kosovë nën mandatin e Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), për të siguruar kushte për një jetë paqësore dhe normale për të gjithë banorët e Kosovës dhe avancimin e stabilitetit rajonal në Ballkanin Perëndimor. Objektivat strategjike të KB janë aprovuar në vitin 2000, kur udhëheqësit botërorë u mbledhën në New York për të marrë pjesë në Samitin e Mijëvjeçarit, ku pjesëmarrësit aprovuan Deklaratën e Mijëvjeçarit të KB (Asambleja e Përgjithshme e KB, 2000) me qëllimin kryesor të përgjithshëm për ta zvogëluar varfërinë me afatin e fundit kohor vitin 2015. Kjo nismë është bërë e njohur si Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit².

Nga shtatë (7) objektivat e kësaj nisme, një nga to i kushtohet qëndrueshmërisë mjedisore, në mënyrë që të sigurohet vendosja e qëllimeve në vijim:

- Integrimi i parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në politikat dhe programeve të vendit dhe kthimi mbrapsht i humbjes së burimeve mjedisore;
- Zvogëlimi i humbjeve të biodiversitetit duke arritur deri më 2010 një zvogëlim domethënës të shkallës së humbjes;

²http://ec.europa.eu/europe2020/index_en.htm

- Përgjysmimi i përqindjes së popullsisë pa qasje të qëndrueshme në ujë të pijshëm të sigurt dhe higjiena publike themelore deri në vitin 2015;
- Deri më 2020 të arrihet një përmirësim i rëndësishëm në jetë e së paku 100 banorëve të lagjeve të varfra.

Edhe pse në këto 15 vitet e fundit është bërë progres i dukshëm në arritjen e OZHM-ve, shumë objektiva nuk u arritën. Për të përshpejtuar progresin dhe avancuar zhvillimin përtej vitit 2015, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 25 shtator 2015 miratoi agjendën e zhvillimit të pas-2015, duke vendosur objektivat dhe pikësynimet e reja për 15 vitet e ardhshme. Agjenda e re përcakton shtatëmbëdhjetë (17) Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZHQ) ose Sustainable Development Goals (SDG), të cilat kanë si afat vitin 2030 dhe kërkojnë të ndërtojnë e plotësojnë atë që OZHM nuk e kanë arritur. Në këtë agjendë të re të zhvillimit, komponenta e mjedisit konsiderohet të ketë rol kyç në të gjitha dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm, për sa çështjet mjedisore kanë lidhje me disa probleme kryesore globale duke afektuar të gjitha aktivitetet njerëzore dhe cilësinë e jetës së njeriut. Kjo është arsyeja pse mjedisit i janë dhënë objektiva të posaçme (OZHQ nr. 11, 13 dhe 15) por edhe objektiva të tjera të cilat në thelb përmbajnë aspekte mjedisore. Këto objektiva janë të rëndësishme që të kenë një qasje gjithëpërfshirëse në trajtimin dhe adresimin e problemeve globale të mjedisit.

2.6. KONVENTA ÅRHUS, KONVENTA ESPOO DHE PROTOKOLLI I KIEVIT

KONVENTA ÅRHUS

Konventa e Aarhus-it (25 Qershor 1998), sipas të cilës shteti duhet të garantojë të drejtën e publikut për të pasur informacion për mjedisin, të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe t'i drejtohet trupave gjyqës në lidhje me çështjet e mjedisit.

Tri shtyllat kryesore të konventës:

- E drejta e publikut për informacion;
- E drejta e publikut për pjesëmarrje;
- E drejta e publikut për drejtësi.

KONVENTA ESPOO

Konventa Espoo përcakton obligimet e palëve për ta vlerësuar ndikimin në mjedis të aktiviteteve të caktuara në një fazë të hershme të planifikimit. Po ashtu i formulon obligimet e përgjithshme të shteteve për ta njoftuar njëra tjetrën dhe për t'u këshilluar me njëra tjetrën lidhur me të gjitha projekte të mëdha që janë në shqyrtim dhe që ka gjasa të kenë ndikim të rëndësishëm të pafavorshëm në mjedis përtej kufijve.

PROTOKOLLI I KIEVIT

Protokolli i Kievit kërkon që vlerësimi strategjik i mjedisit të kryhet për planet dhe programet të cilat përgatiten për bujqësi, pylltari, peshkim, energjetikë, industri përfshirë minierat, transportin, zhvillimin rajonal, menaxhimin e mbeturinave, menaxhimin e ujërave, telekomunikimin, turizmin, planifikimin e qytetit ose të fshatit ose shfrytëzim të tokës, dhe të cilat vendosin kornizën për miratimin e zhvillimit të ardhshëm për projektet. Protokolli lejon identifikimin dhe parandalimin e ndikimeve të mundshme

mjedisore që nga fillimi i procesit të vendimmarrjes duke zhvilluar politika të qëndrueshme të transportit se sa minimizimin e ndikimeve mjedisore në ndërtimin e rrugëve.

Protokolli i Kievit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, kërkon nga palët e tij që të vlerësojnë pasojat e planeve dhe programeve të tyre zyrtare. Protokolli i Kievit ofron një pjesëmarrje të gjerë të publikut në vendimmarrjen e qeverisë në sektorët zhvillimorë. Protokolli i Kievit rëndësi të veçantë i kushton edhe shëndetit njerëzor.

2.7. HISTORIKU LEGJISLATIV, ORGANET ADMINISTRATIVE PËRGJEGJËSE

LIGJI I KOSOVËS PËR VLERËSIMIN STRATEGJIK MJEDISOR

Ligji nr. 03/L-230 Për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, ka për qëllim që përmes vlerësimit strategjik mjedisor të planeve dhe programeve, të sigurojë shkallë të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit të njeriut. Ligji nënvizon rëndësinë e integritit të parimeve për mbrojtjen e mjedisit në procedurën e përgatitjes, miratimit dhe realizimit të planeve dhe programeve përkatëse me ndikim domethënës në mjedis, me synim të promovimit të zhvillimit të qëndrueshëm. Ligji përcakton kriteret për përcaktimin e nevojës për VSM, të dhëna mbi përgatitjen e raportit, informacionet që duhet përfshirë, debati publik, etj. Planet dhe programet të cilat duhet t'i nënshtrohen procesit të VSM, nuk mund të aprovohen ose t'i dorëzohen organit legjislativ për aprovim pa raportin e VSM. Ligji është përafshuar me Direktivën 2001/42/EC, datë 27 Qershor 2001.³ Përveç, Ligjit Nr. 03/L-230 të Kosovës për Vlerësimin Strategjik Mjedisor janë konsultuar edhe ligjet tjera relevante mjedisore dhe aktet nënligjore më të rëndësishme të aplikuara për hartimin e këtij raporti:

- Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
- Ligji nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor;
- Ligji nr.04/L-147 për Ujërat e Kosovës;
- Ligji nr. 03/L-233 mbi Mbrojtjen e Natyrës;
- Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, shfuqizuar pjesërisht nga Ligji nr. 04/L-040 për Rregullimin e Tokës;
- Ligji nr. 06/L-035 për Veprimtaritë Hidrometeorologjike;
- Ligji nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma;
- Ligji nr. 08/L-145 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes;
- Ligji nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja;
- Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis;
- Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, ndryshuar/plotësuar nga Ligji nr. 08/L-071 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina;
- Ligji nr. 04/L-197 për Kimikate;
- Ligji nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-197 për Kimikate;
- Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike;
- Ligji nr.08/L-137 për Pyjet;
- Ligji nr. 02/L-53 për Gjuetinë;
- Ligji nr. 08/L-084 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 02/L-53 për Gjuetinë;

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2711>

- Ligji nr. 08/L-074 për Turizmin;
- Ligji nr. 04/L-027 për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera;
- Ligji nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet;
- Ligji nr. 08/L-214 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Mineralet, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-158;
- Ligji 08/L-275 për Rrugët;
- Ligji 08/L-250 për Ndryshime Klimatike;
- Ligji 08/L-258 për Promovimin e Përdorimit të Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë;
- Ligji nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale;
- Ligji nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, etj.

LIGJI I KOSOVËS PËR PLANIFIKIM HAPËSINOR

Ligji për Planifikimin Hapësinor është aprovuar në Shtator 2003 dhe është ndryshuar në Nëntor 2008 (Ndryshimi i Ligjit për Planifikim Hapësinor, Ligji Nr. 03/L-106), ndërkaq në Korrik të viti 2013 është aprovuar Ligji i ri i Planifikimit (Ligji Nr. 04/L-174) duke pasur si qëllim kryesor:

- Rregullimin e të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me planifikimin hapësinor dhe urban;
- Duhet t'i respektojë parimet e mbrojtjes së burimeve natyrore të dhe ta përkrahë zhvillimin e qëndrueshëm;
- Duhet t'i përkrahë proceset gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse dhe duhet t'i përfshijë të gjitha palët e interesuara dhe komunitetet;
- Përkrahja e zhvillimeve hapësinore evropiane që janë duke ndodhur etj.

Sipas Ligji Nr. 04/L-174 në Kosovë ekzistojnë 2 nivele të planifikimit (qendror dhe lokal) dhe llojet e planeve janë Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta, Planet Zhvillimore Komunale (PZHK), Harta Zonale e Komunës, dhe Planet Rregulluese Urbane të Hollësishme. Për të gjitha ato lloje të planeve është i obligueshëm rishikimi dhe mundësitë për pjesëmarrjen e palëve të interesuara. PZHK, si lloji më i rëndësishëm për detyrën aktuale është plani multi-sektorial për gjithë territorin e komunës që i përcakton objektivat afatgjata për zhvillimin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor. Ai përfshin periudhën minimale 8 vjeçare dhe planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale brenda komunës. Të gjitha nivelet e planeve duhet të përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm si dhe për secilin plan obligohet përgatitja e raportit të VSM paralelisht me planin.

Sipas Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) është përgjegjëse për bashkërendimin e planifikimit hapësinor në Kosovë dhe për propozimin për politikën e zhvillimit hapësinor në fushën e planifikimit hapësinor, si dhe për hartimin e dokumenteve dhe të raporteve përkatëse për planifikimin hapësinor, shqyrtimin dhe monitorimin e të gjitha dokumenteve planifikuese në mbarë territorin e Kosovës. Ndërsa autoritetet lokale janë përgjegjës për zbatimin e zhvillimeve urbane të nivelit lokal të cilat duhet të jenë në harmoni me politikën dhe programet nacionale si dhe duke respektuar përgjegjësitë që dalin nga Ligji Nr. 04/L-174.

2.8. PLANET DHE PROGRAMET E TJERA TË RËNDËSISHME

Përveç legjislationit, raporti i VSM-së duhet të marrë parasysh edhe Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, Strategjinë për Mjedisin dhe Planin e Veprimit në Mjedis, si dhe disa plane, programe dhe dokumente të ndryshme të politikave të përgatitura dhe të lëshuara rishtazi nga autoritetet nacionale dhe institucionet e tjera relevante për të vazhduar më tutje me zbatimin e objektivave strategjike dhe të kërkesave ligjore.

3. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E VSM-së

Qëllimi i hartimit të VSM për Planin Zhvillimor Komunal të Ferizajt është që të bëjë identifikimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit, si edhe të japë alternativën më të favorshme për zhvillimin e tij nga pikëpamja mjedisore.

3.1. OBJEKTIVAT

- Të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit
- Të konsiderojë efektet e planit mbi mjedisin;
- Të identifikojë alternativat më të përshtatshme për mjedisin;
- Të identifikojë dhe parandalojë efektet kumulative;
- Të rrisë performancën e VNM;
- Të identifikojë dhe orientojë procesin lidhur me efektet potenciale negative mbi mjedisin;
- Të ofrojë argumente për justifikimin e projekteve të propozuara;
- Të reduktojë kohën për grumbullimin e informacionit apo për studime paraprake;
- Të integrojë çështjet mjedisore në procesin e vendimmarrjes;
- Të promovojë mbrojtjen e mjedisit;
- Të kontribuojë për një vendimmarrje sa më të mirë;
- Të ndihmojë për një vendimmarrje transparente, përballë interesave të publikut dhe grupeve të interesit.

3.2. PROCESI DHE METODOLOGJIA E VSM-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është një proces i identifikimit paraprak dhe shqyrtimit të ndikimeve të mundshme negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut, të shkaktuara nga zbatimi i planit, programit ose dokumenteve tjera strategjike. Në raportin e VSM përfshihen edhe masat e rekomanduara për mënjanimin dhe zbutjen e ndikimeve të dëmshme që dalin nga propozimet e planit. Për të siguruar efektivitetin e procesit të VSM, është thelbësore që dokumentet strategjike të marrin në konsideratë disa opsione alternative për arritjen e qëllimeve të identifikuar. Në këtë rast VSM lejon vendimmarrësit të marrin në konsideratë opsionin më miqësor ndaj mjedisit.

Fazat kryesore të procesit të VSM me bazë mbi praktikën ndërkombëtare:

SCREENING

- Plani/programi subjekt i VSM

SCOPING

- Çështjet që duhet të trajtohen në raportin e VSM

DOKUMENTET/RAPORTI

- Përgatitja e raportit të VSM dhe Projekt Planit/Programit

KONSULTIMI

- Konsultimi me grupet e interesit dhe me publikun

VENDIMMARRJA

- Lëshimi i vendimit për planin/programin përfundimtar bazuar në inputet nga hapi i konsultimit

MONITORIMI

- Monitorimi i efekteve mjedisore të planit përfundimtar

Nevojshmëria	Përshkrimi
Përfshirja/qëllimit të VSM-së	Identifikimi i çështjeve që do të përfshihen në studimin e VSM-së do të orientojë vlerësimin e gjendjes bazë të mjedisit, vlerësimin aktual të ndikimeve të pritshme dhe konsideratat për opsione të mundshme alternative. VSM merr në konsideratë përfshirjen e aspekteve më të gjera mjedisore apo sociale në zonë dhe konservimin e të gjitha asetëve më rëndësi kombëtare dhe ndërkombëtare.
Analiza e gjendjes ekzistuese	Analiza e gjendjes ekzistuese përbën bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe përpilimin e skemës së monitorimit. Për VSM-në është e rëndësishme të konsiderohen tendencat e mundshme të zhvillimit. Qëllimi i analizës së gjendjes ekzistuese është që të orientojë drejt një specifikimi me të mirë të çështjeve kyçe, dhe një identifikimi me të mirë të problemeve kryesore që lidhen me planet, programet apo projektet përkatëse.
Analiza e ndikimeve dhe formulimi i masave zbutëse	VSM analizon efektet e konsiderueshme negative si dhe ato pozitive të planeve të propozuara. VSM mundëson identifikimin e efekteve mjedisore të planit, dhe si i tillë ai do të adresojë efektet e pritshme kumulative, të cilat mund të rezultojnë prej aktiviteteve ose planeve të tjera në afërsi të zonës. VSM do të analizojë specifikisht masat adekuata përmirësuese që do të rezultojnë nga plani. Duke konsideruar, bashkërisht, ndikimet dhe raportin benefit/cost të veprimit ose mos veprimit do të analizohen opsionet dhe përzgjidhet ai që rezulton më i miri në planin ekonomik dhe mjedisor.
Hartimi i raportit të VSM-së	Raporti i VSM përmbledh të gjitha gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra gjatë gjithë procesit të VSM dhe shërben si bazë për konsultimet me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit. Qëllimi i kësaj faze është përgatitja e një raporti i cili paraqet të gjithë informacionin dhe të dhënat e rëndësishme, konkluzionet dhe rekomandimet në mënyrë të qartë, dhe kështu do të mundësojë konsultime efektive me autoritetet përkatëse dhe grupet tjera të interesit.
Adoptimi	Jepet informacion mbi përputhshmërinë e objektivave mjedisor me elementët kyçe të planit, të identifikuar paraprakisht. Mos përputhshmëria e objektivave mjedisor me planin nevojitet të rishikohen dhe propozohen ndryshime të mundshme në plan.
Monitorimi	Monitorimi i efekteve të konsiderueshme mjedisor dhe realizimi i veprimeve të duhura korrigjuese/zbutëse për çdo efekt mjedisor të konsiderueshëm të paparashikuar në këtë studim.

Tabela 1 Hapat e hartimit të VSM dhe përshkrime të shkurtra të punës

4. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

4.1. POZITA DHE KARAKTERISTIKAT NATYRORE

Komuna e Ferizajt shtrihet në jug të pjesës qendrore të Kosovës dhe karakterizohet nga një pozitë e favorshme gjeografike dhe strategjike. Ferizaj paraqet një nyje të rëndësishme të komunikimit rrugor dhe hekurudhor, pasi nëpër territorin e komunës kalojnë akse të rëndësishme që lidhin pjesën veriore me atë jugore dhe pjesën lindore me atë perëndimore të Kosovës, si dhe krijojnë lidhje me shtetet fqinje dhe rajonin.

Në lindje, Komuna e Ferizajt kufizohet me komunat e Gjilanit dhe Vitisë, në jug me Komunën e Kaçanikut, në jugperëndim me Komunën e Shtërpcës, në perëndim me territorin në drejtim të Prizrenit dhe Suharekës, ndërsa në veri me komunat e Shtimes dhe Lipjanit. Qyteti i Ferizajt ndodhet rreth 36 km nga Prishtina dhe rreth 48 km nga Shkupi, ndërsa Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës ndodhet në largësi rreth 33 km. Kjo pozitë i jep komunës rëndësi të veçantë në aspektin e lidhjeve rajonale, zhvillimit ekonomik dhe qarkullimit të njerëzve dhe mallrave.

Në aspektin fiziko-gjeografik, territori i komunës paraqet zonë kalimtare ndërmjet Rrafshit të Kosovës dhe hapësirave kodrinore e malore përreth. Komuna përfshin sipërfaqe të rrafshëta, kodrinore dhe malore, me ndryshime të konsiderueshme të lartësisë mbidetare. Pjesa më e madhe e vendbanimeve, infrastrukturës dhe aktiviteteve ekonomike është e përqendruar në zonat më të ulëta dhe më të rrafshëta të territorit, ndërsa pjesët më të larta, kryesisht në lindje dhe perëndim, arrijnë mbi 1,000 m lartësi mbidetare dhe karakterizohen në masë të konsiderueshme nga sipërfaqe pyjore.

Pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit, prania e sipërfaqeve fushore dhe malore, rrjeti hidrografik dhe mbulesa pyjore përbëjnë elemente bazë të karakterit natyror të komunës. Këto karakteristika përcaktojnë në masë të konsiderueshme mënyrën e shfrytëzimit të tokës, shpërndarjen e vendbanimeve, potencialin bujqësor dhe pyjor, si dhe ndjeshmërinë e territorit ndaj proceseve dhe presioneve të ndryshme mjedisore.

4.2. VEÇORITË MJEDISORE

GJELOGJIA DHE PEDOLOGJIA

Territori i Komunës së Ferizajt karakterizohet nga një përbërje e larmishme gjeologjike, ku paraqiten formacione sedimentare, metamorfike dhe magmatike, si dhe depozitime aluviale e lumore. Përgjatë lumit Nerodime janë të përhapura edhe sedimente liqenore të Pliocenit, të përfaqësuara kryesisht nga argjila ranore dhe mergele.

Nga aspekti pedologjik, territori karakterizohet nga disa lloje tokash, ndër të cilat dominojnë tokat e kuqërremta-kafe të lesivuara dhe ranore-deltinore, smonicat, tokat podzollake-pseudoglej, tokat aluviale dhe tokat livadhore-argjilore. Kjo përbërje krijon kushte të favorshme për zhvillimin e bujqësisë dhe paraqet një element të rëndësishëm për vlerësimin e shfrytëzimit dhe mbrojtjes së tokës në kuadër të VSM-së.




Figura 1 Karakteristikat gjeologjike, Komuna e Ferizajt




Figura 2 Formacionet pedologjike, Komuna e Ferizajt

RELIEVI, LARTËSIA MBIDETARE DHE PJERRËSIA

Territori i Komunës së Ferizajt karakterizohet nga reliev fushor, kodrinor dhe malor. Rreth 43% e sipërfaqes shtrihet deri në 600 m lartësi mbidetare, ku përqendrohet pjesa më e madhe e vendbanimeve, infrastrukturës dhe aktiviteteve ekonomike. Pjesët më të larta ndodhen kryesisht në lindje dhe perëndim të komunës dhe arrijnë mbi 1,000 m lartësi mbidetare.

Sa i përket pjerrësisë, pjesa më e madhe e territorit karakterizohet nga pjerrësi të ulëta deri mesatare. Rreth 34.9% e sipërfaqes ka pjerrësi deri në 3.8%, ndërsa rreth 15% shtrihet në intervalin 3.8–8.8%. Zonat me pjerrësi më të theksuar janë të përqendruara kryesisht në pjesët kodrinore dhe malore të komunës.




Figura 3 Hipsometria e terrenit




Figura 4 Pjerrësia e terrenit

KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE

Territori i Komunës së Ferizajt karakterizohet nga një rrjet i zhvilluar i lumenjve dhe përrrenjve, ku rrjedha kryesore është lumi Nerodime, i cili kalon edhe nëpër qytetin e Ferizajt. Komuna disponon me ujëra sipërfaqësore dhe nëntokësore, ndërsa sistemi hidrografik i Nerodimes përfshin edhe një numër të konsiderueshëm të degëve dhe përrrenjve.

Lumi Nerodime formohet nga Lumi i Madh dhe Lumi i Vogël dhe ka gjatësi rreth 29 km dhe pellg ujëmbledhës rreth 255 km². Veçori e rëndësishme natyrore e këtij sistemi është fenomeni i bifurkacionit të Nerodimes. Në territor gjenden edhe rrjedha të tjera ujore, përfshirë lumin e Pleshinës dhe të Gremes, të cilat shfrytëzohen edhe për ujitjen e tokave bujqësore.

PZHK evidenton gjithashtu prani të ujërave nëntokësore, por edhe shkallë të lartë të ndotjes së lumenjve dhe përrrenjve, veçanërisht në zonat me përqendrim më të madh të popullsisë.




Figura 5 Karakteristikat hidrografike, Komuna e Ferizajt

KUSHTET KLIMATIKE

Komuna e Ferizajt karakterizohet nga klimë kontinentale. Sipas të dhënave të IHMK-së të përdorura në PZHK, temperatura mesatare vjetore është rreth 10°C, ndërsa në viset malore rreth 9°C. Muajt më të ngrohtë janë Korriku dhe Gushti, ndërsa Janari është muaji më i ftohtë.

Reshjet janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë gjatë vitit, ndërsa lagështia relative mesatare vjetore është rreth 74.7%. Ferizaj karakterizohet gjithashtu nga insolim i konsiderueshëm vjetor dhe nga erëra me drejtime të ndryshme, ku frekuencë më të lartë kanë erërat verilindore. Këto kushte klimatike ndikojnë drejtpërdrejt në regjimin ujor, bujqësi, vegetacion dhe proceset tjera mjedisore në territorin e komunës.




Figura 6 Potenciali fotovoltai, Komuna e Ferizajt

BIODIVERSITETI, FLORA DHE FAUNA

Komuna e Ferizajt karakterizohet nga larmi e konsiderueshme e vegjetacionit dhe habitateve natyrore. Në territor evidentohen fitocenoza të qarrit, ahut malor, verrit të zi përgjatë rrjedhës së lumit Nerodime, lajthisë, si dhe komunitete të bimëve barishtore, shkurreve, bimëve mjekësore dhe llojeve të tjera të florës. Në disa zona, veçanërisht në Greme, Surqinë dhe përgjatë luginës së Nerodimes, është evidentuar edhe prania e shpendëve shtegtarë.

Gjendja e florës dhe faunës vlerësohet e ndikuar nga presionet antropogjene, përfshirë prerjen dhe djegien e pyjeve, gjuetinë dhe peshkimin e paligjshëm, urbanizimin, transportin, zhvillimin turistik dhe dëmtimin e habitateve natyrore. Këto presione paraqesin faktorë të rëndësishëm që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të ndikimeve të zhvillimeve të propozuara nga PZHK-ja.




Figura 7 Vlerat e llogaritura të biodiversitetit, Komuna e Ferizajt

PYJET DHE VEGJETACIONI

Pyjet përbëjnë një pjesë të rëndësishme të resurseve natyrore të komunës. Sipas PZHK-së, sipërfaqja pyjore arrin rreth 13,622 ha, prej të cilave rreth 9,242 ha janë pyje publike dhe 4,380 ha private. Llojet kryesore drunore janë dushku dhe ahu, ndërsa në zonat e caktuara paraqiten edhe pisha, bredhi, frashëri, shkoza, lajthia, verri, plepi dhe gështenja.

Gjendja e pyjeve ndikohet nga prerjet ilegale, zjarret dhe forma të tjera të shfrytëzimit të pakontrolluar. PZHK-ja evidenton nevojën për menaxhim më të qëndrueshëm, mbrojtje të sipërfaqeve pyjore dhe ndërhyrje në zonat e degraduara, për shkak të rolit të tyre në ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e tokës dhe stabilitetin mjedisor të territorit.

ZONAT E MBROJTURA DHE TRASHËGIMIA NATYRORE

Në territorin e Komunës së Ferizajt veçohet Bifurkacioni i lumit Nerodime, i shpallur rezervat special natyror në vitin 1979 dhe një nga vlerat më të rëndësishme të trashëgimisë natyrore të komunës. Po ashtu, hapësira ndërmjet Lumit të Madh dhe Lumit të Vogël të Nerodimes është përcaktuar si zonë turistike me sipërfaqe rreth 120 ha.

Gjendja e kësaj zone është ndikuar nga ndërhyrjet antropogjene, përfshirë ndërtimet, ngushtimin e shtretërve të degëve të lumit dhe shkarkimin e ujërave të ndotura. Sipas PZHK-së, dega e bifurkacionit në drejtim të Sitnicës nuk funksionon më si pasojë e ndërhyrjeve njerëzore, çka e bën këtë zonë veçanërisht të ndjeshme ndaj zhvillimeve të ardhshme.

FAKTORËT MJEDISORË DHE NIVELET E NDOTJES, KU MUND TA NDAJMË NË AJËR, UJË, TOKË DHE ZHURMË

Cilësia e ajrit

Në Komunën e Ferizajt mungon stacioni lokal për monitorimin e cilësisë së ajrit, prandaj nuk ekzistojnë të dhëna të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme për gjendjen e ajrit në territorin e komunës. Në mungesë të monitorimit lokal, PZHK ka përdorur si të dhëna referente rezultatet e stacioneve monitoruese në **Gjilan** dhe **Brezovicë**. Këto dy stacione përfaqësojnë kushte të ndryshme mjedisore: Gjilani karakterizohet nga ndikime më të theksuara urbane dhe të trafikut, ndërsa Brezovica paraqet një mjedis me karakter kryesisht malor dhe me presion dukshëm më të ulët antropogjen. Për këtë arsye, të dhënat e tyre mund të përdoren për të kuptuar tendencat rajonale, por nuk mund të konsiderohen si matje përfaqësuese të drejtpërdrejta të gjendjes së ajrit në Ferizaj.

Pavarësisht mungesës së matjeve lokale, karakteristikat urbane dhe ekonomike të Ferizajt mundësojnë identifikimin e disa burimeve kryesore potenciale të emetimeve. Në këtë grup përfshihen trafiku i dendur në zonën urbane dhe përgjatë korridoreve kryesore rrugore, aktivitetet industriale dhe ekonomike, aktivitetet ndërtimore dhe sistemet individuale të ngrohjes. PZHK evidenton veçanërisht nevojën për trajtimin e emetimeve nga transporti dhe reduktimin e ndotjes me PM10 dhe PM2.5 gjatë sezonit dimëror. Mungesa e sistemit publik të ngrohjes bën që një pjesë e konsiderueshme e ekonomive familjare të mbështeten në sisteme individuale, përfshirë përdorimin e drurit dhe burimeve të tjera të energjisë. Ky faktor merr rëndësi të veçantë gjatë sezonit dimëror, kur intensifikimi i djegies mund të ndikojë në rritjen e përqendrimeve të grimcave të suspenduara dhe përqësimin periodik të cilësisë së ajrit.

Bazuar në të dhënat në dispozicion, nuk është e mundur të jepet një vlerësim përfundimtar sasiore për cilësinë aktuale të ajrit në Komunën e Ferizajt, për shkak të mungesës së monitorimit lokal. Rezultatet nga Gjilani dhe Brezovica tregojnë se mesataret vjetore të ndotësve të monitoruar përgjithësisht mbeten brenda vlerave kufitare, por njëkohësisht evidentojnë dallime të konsiderueshme ndërmjet mjedisit urban dhe atij malor, veçanërisht për PM10 dhe PM2.5. Gjilani regjistron edhe episode të tejkalimit të vlerave ditore të PM10 gjatë sezonit dimëror, duke dëshmuar rëndësinë e analizës së ekspozimit afatshkurtër krahas mesatareve vjetore.

Duke marrë parasysh karakterin urban të Ferizajt, intensitetin e trafikut, zhvillimin ekonomik dhe industrial, aktivitetet ndërtimore dhe përdorimin e sistemeve individuale të ngrohjes, ekziston potencial për presion të shtuar mbi cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonën urbane dhe gjatë sezonit dimëror. Megjithatë, shkalla reale e këtij presioni nuk mund të përcaktohet pa të dhëna të monitorimit lokal. Për rrjedhojë, mungesa e një sistemi të monitorimit të cilësisë së ajrit duhet të konsiderohet një nga boshllëqet kryesore të informacionit mjedisor për Komunën e Ferizajt dhe një element që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit dhe monitorimit të zbatimit të PZHK-së.

Cilësia e ujërave

Lumi Nerodime, si trupi kryesor uhor në territorin e komunës, është i ekspozuar ndaj presioneve nga shkarkimet e ujërave të zeza komunale, aktivitetet bujqësore dhe burime të tjera antropogjene. Sistemi ekzistues i kanalizimit shkarkon ujërat e zeza kryesisht pa trajtim në lumin Nerodime dhe në përrenjtë përreth, ndërsa në territor janë evidentuar rreth 22 pika shkarkimi.

Vlerësimi i cilësisë së ujit në PZHK mbështetet në të dhënat e monitorimit fiziko-kimik dhe biologjik nga Raporti Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2023. Lumi Nerodime monitorohet në disa pika përgjatë rrjedhës, përfshirë Jezercën, Gërlicën dhe Kaçanikun, duke mundësuar evidentimin e ndryshimeve të cilësisë së ujit nga rrjedha e epërme drejt asaj të poshtme. Për stacionin e Bifurkacionit mungojnë të dhëna monitorimi.

Monitorimi fiziko-kimik

Në stacionin **Jezercë**, në rrjedhën e epërme të Nerodimes, cilësia e ujit paraqitet e mirë. Oksigjeni i tretur është 9 mg/l, ndërsa ngarkesa organike është e ulët (SHBO₅ 3 mg/l dhe SHKO 6 mg/l), duke treguar ndikim të kufizuar nga burimet ndotëse.

Në **Gërlicë** vërehet përkeqësim i dukshëm i cilësisë së ujit. SHBO₅ arrin 25 mg/l, ndërsa SHKO 55 mg/l; rritje e evidentohen edhe të karbonit organik total dhe fosfori. Materiet në suspension arrijnë 40 mg/l, mbi vlerën kufitare të paraqitur në PZHK. Këto rezultate tregojnë rritje të ngarkesës organike dhe sedimentare dhe lidhen me ndikimin e ujërave të ndotura komunale dhe aktivitetëve bujqësore.

Në rrjedhën e poshtme, në stacionin **Kaçanik**, gjendja përkeqësohet më tej, ku SHBO₅ arrin 28 mg/l dhe materiet në suspension 54 mg/l. Kjo tregon akumulimin e presioneve ndotëse përgjatë rrjedhës së lumit, edhe pse niveli i oksigjenit të tretur mbetet relativisht i favorshëm.

Monitorimi biologjik

Monitorimi biologjik përmes diatomeve, makroinvertebrorëve dhe peshqve e konfirmon të njëjtin trend. Në Jezercë, statusi ekologjik rezulton përgjithësisht i mirë, ndërsa në Gërlicë gjendja degradohet në kategoritë “i varfër” dhe “i keq”. Në segmentin e poshtëm, në Kaçanik, statusi ekologjik gjithashtu paraqitet kryesisht i varfër ose i keq.

Veçanërisht te Gërlica, monitorimi i makroinvertebrorëve dhe peshqve tregon degradim të theksuar të komuniteteve biologjike. Statusi i makroinvertebrorëve përkeqësohet nga “i varfër” në “i keq”, ndërsa statusi ekologjik i peshqve vlerësohet “i keq” gjatë gjithë periudhës së monitorimit, duke reflektuar presion të vazhdueshëm nga ndotja organike dhe ndryshimet e habitatit.

Rezultatet tregojnë një **përkeqësim progresiv të cilësisë së lumit Nerodime nga rrjedha e epërme drejt zonave më të ndikuara nga aktiviteti njerëzor**. Segmenti i Jezercës ruan gjendje relativisht të mirë dhe mund të konsiderohet pikë referente e gjendjes natyrore, ndërsa Gërlica paraqet degradim të dukshëm si në parametrat fiziko-kimikë ashtu edhe në statusin biologjik. Kjo tregon se shkarkimet e ujërave të zeza të patrajuara, aktivitetet bujqësore dhe presionet urbane përbëjnë ndër faktorët kryesorë që ndikojnë në gjendjen ekologjike të Nerodimes.

Ndotja e tokës

Aktualisht, në komunë nuk ekziston një sistem i monitorimit sistematik të cilësisë së tokës, prandaj mungojnë të dhëna të vazhdueshme mbi përqendrimin e metaleve të rënda, ndotësve organikë apo substancave të tjera potencialisht ndotëse në tokë.

Burimet potenciale të ndotjes dhe degradimit të tokës lidhen kryesisht me aktivitetet industriale dhe ekonomike, menaxhimin jo të plotë të mbeturinave, aktivitetet ndërtimore, zgjerimin urban dhe shfrytëzimin e resurseve minerale. Nxjerrja e materialeve si argjila, zhavorri dhe linjiti mund të shkaktojë degradim fizik të tokës dhe erozion në rast të menaxhimit jo adekuat.

Një presion të drejtpërdrejtë mbi tokën paraqesin edhe deponitë ilegale të mbeturinave. Sipas të dhënave të paraqitura në PZHK, në vitin 2023 janë evidentuar 6 deponi ilegale, ndërsa në vitin 2024 numri i tyre është zvogëluar në 5. Këto vendgrumbullime përmbajnë kryesisht mbeturina komunale, mbetje inerte dhe mbeturina nga ndërtimi, duke paraqitur potencial për ndotjen lokale të tokës dhe, përmes infiltrimit, edhe të ujërave nëntokësore.

Ndryshimi i përdorimit të tokës paraqet një presion tjetër të rëndësishëm. Zhvillimi i hovshëm urban, aktivitetet ekonomike dhe infrastrukturore mund të çojnë në humbje ose fragmentim të sipërfaqeve bujqësore dhe ndryshim të përhershëm të funksioneve natyrore të tokës. PZHK-ja evidenton gjithashtu zvogëlim të sipërfaqeve pyjore krahasuar me projeksionet e planit paraparak, çka mund të ndikojë në rritjen e ndjeshmërisë së tokës ndaj erozionit dhe degradimit.

Në mungesë të monitorimit sistematik, nuk mund të përcaktohet në mënyrë sasiore niveli aktual i ndotjes kimike të tokës në Komunën e Ferizajt. Duke pasur parasysh rëndësinë e tokës bujqësore dhe funksionet ekologjike të tokës, presionet e identifikuara duhet të konsiderohen gjatë vlerësimit të ndikimeve të zhvillimeve të propozuara nga PZHK.

Ndotja akustike

Burimet kryesore të zhurmës në Komunën e Ferizajt lidhen me trafikun rrugor, aktivitetet ekonomike dhe industriale, veçanërisht në zonën urbane dhe përgjatë akseve me qarkullim të lartë.

Aktualisht në komunë nuk ekziston sistem i rregullt i monitorimit të zhurmës, prandaj mungojnë të dhëna të matura që do të mundësonin vlerësimin e saktë të nivelit të ekspozimit të popullsisë. PZHK-ja e identifikon trafikun rrugor si burimin kryesor potencial të zhurmës, ndërsa aktivitetet industriale dhe ekonomike paraqesin burime shtesë lokale.

Ndotja akustike paraqet presion mjedisor kryesisht në zonën urbane dhe përgjatë korridoreve të transportit, por mungesa e monitorimit lokal kufizon përcaktimin sasior të gjendjes aktuale.

SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Në territorin e Komunës së Ferizajt janë evidentuar disa lloje të rreziqeve natyrore dhe mjedisore, ndër të cilat më të rëndësishmet janë **përmbytjet, erozioni dhe sedimentimi, rreziku sizmik, rrëshqitjet lokale të tokës dhe zjarret**. Shpërndarja e këtyre rreziqeve ndryshon në varësi të relievit, rrjetit hidrografik, përdorimit të tokës dhe shkallës së zhvillimit urban.

Përmbytjet

Përmbytjet paraqesin një nga rreziqet më të rëndësishme në komunë dhe shfaqen kryesisht gjatë periudhave me reshje të shtuara në pranverë dhe vjeshtë. Rrjedhat më të ndjeshme janë Nerodimja, Pleshina, Gaçka dhe kanali artificial Kosinë–Lubovc–Tërn. Në territorin e komunës janë identifikuar 6 zona që përmbjten periodikisht, ndërsa rreziku prek si toka bujqësore ashtu edhe zona të banuara.

Ndër zonat me rrezikshmëri më të lartë evidentohen Gurëza dhe Tërn, ndërsa përmbytje historike janë regjistruar edhe në Nerodime, Balaj, Nikadin, Varosh, Gurëz dhe në pjesë periferike të qytetit të Ferizajt. Në zonën urbane, problemet lidhen edhe me mirëmbajtjen e pamjaftueshme të rrjedhave ujore, ndërprerjen e kanaleve natyrore të drenazhimit dhe rritjen e sipërfaqeve të papërshkueshme nga urbanizimi.

Erozioni dhe sedimentimi

Komuna e Ferizajt në përgjithësi nuk karakterizohet nga rrezik shumë i lartë eroziv. Rreth 26% e territorit paraqet shkallë shumë të ulët të erozionit, 34% shkallë të ulët, 21% shkallë mesatare dhe rreth 19% shkallë të lartë. Zonat me erozion më të theksuar shtrihen kryesisht në pjesët perëndimore dhe lindore të komunës. Shpyllëzimi, ndryshimet në përdorimin e tokës dhe zgjerimi urban janë ndër faktorët që ndikojnë në intensifikimin e këtij procesi.

Rrëshqitjet e tokës

Rrëshqitjet masive të tokës nuk paraqiten si rrezik i theksuar në Ferizaj, për shkak të dominimit të terrenit të rrafshët dhe kodrinor me pjerrësi relativisht të moderuar. Megjithatë, janë evidentuar raste të vogla dhe të lokalizuara, sidomos pas reshjeve intensive dhe në zona ku terreni është ndryshuar nga ndërhyrjet ndërtimore ose infrastrukturore.

Rreziku sizmik

Komuna e Ferizajt shtrihet në një zonë me aktivitet sizmik të konsiderueshëm, të ndikuar nga zona sizmike Ferizaj–Viti–Gjilan. Sipas të dhënave të PZHK-së, territori i Ferizajt mund të ekspozohet ndaj intensitetit maksimal prej VIII–IX° sipas shkallës MSK-64, çka e bën rrezikun sizmik faktor të rëndësishëm në planifikimin e zhvillimeve të ardhshme.

Zjarret

Rreziku nga zjarret vlerësohet si i pranishëm, por kryesisht i lokalizuar dhe me intensitet të ulët deri mesatar. Rastet e evidentuara kanë prekur kryesisht sipërfaqe bari, shkurre dhe toka bujqësore, ndërsa nuk janë raportuar zjarre të mëdha pyjore me përhapje të pakontrolluar. Rreziku rritet veçanërisht gjatë periudhave të thata dhe me temperatura të larta, si dhe nga djegiet e pakontrolluara në zonat rurale dhe periferike.

5. PËRMBLEDHJE E PROBLEMEVE MJEDISORE

5.1. ZONAT ME PROBLEME MJEDISORE

Bazuar në analizën e gjendjes ekzistuese, në territorin e komunës dallohen zona ku presionet mjedisore janë tashmë të pranishme dhe zona të tjera të cilat, për shkak të vlerave natyrore dhe ndjeshmërisë së tyre, mund të pësojnë ndryshime të rëndësishme ose të pakthyeshme në rast të zhvillimeve të pakontrolluara.

Ky seksion përfshin një përmbledhje të:

- Zonave që vuajnë nga një degradim i thellë mjedisor apo që po kalojnë një shok mjedisor;
- Zonave me ndjeshmëri të veçantë mjedisore, të cilat mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme të ekosistemeve, nëse nuk u ofrohet një mbrojtje më e mirë mjedisore; dhe
- Përmbledhje të natyrës dhe shkallës së ndikimeve të mundshme në mjedis, nisur nga përshkrimet e bëra në këtë kapitull.

Ky klasifikim shërben për identifikimin e hapësirave ku zhvillimet e propozuara nga PZHK kërkojnë vëmendje të shtuar gjatë vlerësimit të ndikimeve.

5.1.1. ZONAT NË RREZIK TË DEGRADIMIT TË THELLË MJEDISOR

Në territorin e Komunës së Ferizajt nuk rezulton i identifikuar ndonjë **hotspot mjedisor i klasifikuar zyrtarisht** sipas Regjistrit të Hotspoteve Mjedisore të AMMK-së. Megjithatë, analiza e gjendjes ekzistuese evidenton disa zona vazhdimësia e presioneve antropogjene krijojnë rrezik për degradim të mëtejshëm të ujit, tokës, habitateve dhe cilësisë së mjedisit.

▪ Segmenti urban dhe rrjedha e poshtme e lumit Nerodime

Kjo zonë paraqet hapësirën me presionin më të theksuar dhe më të dokumentuar mjedisor në komunë. Shkarkimi i ujërave të zeza të patrajuara, presionet urbane dhe ndryshimet hidromorfologjike kanë rezultuar në përkeqësim të cilësisë së ujit dhe të statusit ekologjik përgjatë rrjedhës. Monitorimi tregon kalim nga gjendje e mirë në segmentin e sipërm në gjendje të varfër ose të keqe në segmentet më të ndikuara, duke treguar karakter kumulativ të degradimit. Për këtë arsye, segmenti urban dhe pjesa e poshtme e Nerodimes vlerësohen si zonë me rrezik të lartë për thellim të degradimit ekologjik.

▪ Zona përreth deponisë tranzite në Gërlicë

Zona përreth deponisë tranzite në Gërlicë paraqet një hapësirë tjetër me presion të përqendruar mjedisor. Prania e mbeturinave, mundësia e infiltrimit të ndotësve në tokë dhe ujëra nëntokësore, si dhe rastet e zjarreve të mbeturinave krijojnë rrezik të kombinuar për disa komponentë të mjedisit njëkohësisht. PZHK e identifikon këtë hapësirë si hotspot potencial që kërkon trajtim prioritar dhe monitorim të vazhdueshëm.

▪ **Zonat me përqendrim të aktiviteteve industriale**

Hapësirat me përqendrim të aktiviteteve prodhuese dhe përpunuese paraqesin zona me potencial për degradim lokal, veçanërisht të tokës dhe ujërave. Aktivitetet si përpunimi i plastikës, mishit dhe lëkurave, kromimi, galvanizimi dhe procese të tjera industriale mund të gjenerojnë ndotje difuze ose aksidentale. Aktualisht mungesa e monitorimit sistematik të tokës dhe ujërave nëntokësore nuk mundëson përcaktimin e plotë të shkallës së ndikimit, prandaj këto zona duhet të konsiderohen si hapësira me rrezik të shtuar në kuadër të VSM-së.

Në përgjithësi, këto zona karakterizohen nga presione ekzistuese dhe kumulative, ku vazhdimi ose intensifikimi i aktiviteteve pa kontroll adekuat mund të çojë në përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes mjedisore dhe në rritjen e kostos së rehabilitimit të tyre në të ardhmen.




Figura 8 Zonat me përqendrim të aktiviteteve industriale në Komunën e Ferizajt

5.1.2. ZONAT ME NDJESHMËRI TË VEÇANTË MJEDISORE

Në këtë kategori përfshihen zona dhe resurse që aktualisht ruajnë funksionin ekologjik, hidrologjik, biologjik ose prodhues dhe të cilat, në rast të urbanizimit, fragmentimit, ndotjes apo shfrytëzimit të pakontrolluar, mund të pësojnë ndryshime të pakthyeshme.

- **Bifurkacioni i lumit Nerodime dhe asetet e mbrojtura natyrore**

Bifurkacioni i lumit Nerodime përbën zonën me ndjeshmërinë më të veçantë mjedisore në komunë, për shkak të vlerës së tij hidrologjike dhe statusit si **Rezervat Special Natyror**. Ndërhyrjet në shtretërit e lumit, ndërtimet dhe ndryshimi i regjimit të rrjedhjes mund të cenojnë vetë funksionimin e fenomenit natyror, siç dëshmohet edhe nga mosfunksionimi i njërës prej degëve si rezultat i ndërhyrjeve.

Në të njëjtën kategori përfshihen edhe **11 drunj shekullorë** të llojit lis/cherre (*Quercus*) në lokalitete të ndryshme të komunës. Humbja ose dëmtimi fizik i këtyre aseteve do të përbënte humbje të pakthyeshme të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit lokal.

- **Rrjedha e epërme e lumit Nerodime – zona e Jezercës**

Segmenti i sipërm i Nerodimes në Jezercë paraqet një zonë me vlerë të veçantë ekologjike, pasi monitorimi fiziko-kimik dhe biologjik e karakterizon atë me gjendje të mirë ekologjike dhe presion të ulët antropogjen. PZHK e trajton segmentin si zonë referente për cilësinë e ujit, e cila duhet të ruajë parametrat fizikë, kimikë dhe biologjikë ekzistues. Për shkak të gjendjes relativisht natyrore, zhvillimet intensive, shkarkimet e ujërave të ndotura, ndërhyrjet në shtrat apo ndryshimet e regjimit hidrologjik mund të shkaktojnë degradim të ekosistemit dhe humbje të funksionit të kësaj zone si segment referues i Nerodimes.

- **Sipërfaqet pyjore dhe habitatet natyrore**

Sipërfaqet pyjore, veçanërisht masivet në Jezerc, Burrnik dhe Pleshinë, paraqesin zona të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e tokës dhe vazhdimësinë e habitateve natyrore. Nga rreth 13,622 ha tokë pyjore në komunë, rreth **9,535 ha klasifikohen si pyje të mbrojtura**, fragmentimi i të cilave sipërfaqe, prerjet e pakontrolluara apo zjarret mund të çojnë në humbjen e habitateve dhe ndërprerjen e korridoreve/lidhjeve ekologjike.

- **Tokat bujqësore me bonitet të lartë**

Tokat bujqësore të klasave I–IV konsiderohen gjithashtu zona me ndjeshmëri të veçantë, për shkak të potencialit të lartë prodhues dhe karakterit të kufizuar të këtij resursi. Sipas PZHK, rreth **59% e territorit të komunës** përbëhet nga toka me cilësi të lartë të klasave I–IV.

Ndryshimi i përhershëm i destinimit të këtyre tokave për ndërtime, industri ose infrastrukturë mund të shkaktojë humbje të pakthyeshme të funksionit të tyre bujqësor dhe ekologjik. Si rrjedhojë, PZHK identifikon konsolidimin dhe ruajtjen e tokave bujqësore si një nga prioritetet e shfrytëzimit të tokës.

Në kuadër të VSM, këto zona duhen konsideruar si **receptorë me ndjeshmëri të lartë**, ku edhe ndërhyrjet me shtrirje relativisht të kufizuar mund të prodhojnë pasoja afatgjata ose të pakthyeshme. Vëmendje e veçantë kërkohet aty ku zhvillimet e planifikuara mund të ndërthuren me zonat e mbrojtura, rrjedhat ujore me gjendje të mirë ekologjike, habitatet pyjore ose tokat bujqësore me vlerë të lartë.

6. PËRMBLEDHJE E PËRMBAJTJES SË PZHK-së

Vlerësimi Strategjik Mjedisor është mbështetur në qëllimet, objektivat, prioritetet strategjike, konceptin e zhvillimit hapësinor dhe zhvillimet e planifikuara të përcaktuara në draftin aktual të PZHK-së.

6.1 QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT E PZHK SIPAS FUSHAVE TEMATIKE

Plani Zhvillimor Komunal i Ferizajt 2026–2034 strukturon qëllimet dhe objektivat zhvillimore sipas fushave tematike e të cilat konkretizojnë vizionin e komunës dhe përcaktojnë drejtimet kryesore të zhvillimit për periudhën e planifikimit. Në kuadër të këtij dokumenti të VSM-së, qëllimet dhe objektivat merren si bazë për vlerësimin e përputhshmërisë së tyre me objektivat mjedisore dhe për identifikimin e ndikimeve të mundshme që mund të rezultojnë nga zbatimi i planit. Në vijim ato paraqiten sipas formulimit dhe ndarjes tematike të përcaktuar në dokumentin e PZHK.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

ZHVILLIMI EKONOMIK

QËLLIMI 1	Zhvillimi i një ekonomie konkurruese industriale dhe logjistike përmes konsolidimit të zonës ekonomik Babush dhe Gërlicë
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të pajisen me infrastrukturë të plotë teknike (rrugë, ujë, kanalizim, energji dhe internet) të paktën 150 ha zona industriale dhe logjistike në korridorin Prelez–Babush dhe Gërlicë.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të rritet numri i ndërmarrjeve prodhuese dhe logjistike me 20% krahasuar me vitin bazë 2025.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të krijohen së paku 1,000 vende të reja pune në sektorët e industrisë përpunuese, logjistikës dhe ndërtimtarisë.
Objektivi 4	Deri në vitin 2034 të zhvillohen së paku 3 zona të formalizuara ekonomike Babush, Gërlicë dhe Mirash.
QËLLIMI 2	Rritja e vlerës së shtuar në bujqësi dhe agro-përpunim përmes forcimit të zinxhirit të vlerës dhe mbrojtjes së tokës bujqësore
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të ruhet të paktën 95% e tokës bujqësore të klasave I-IV nga konvertimi në tokë ndërtimore.
Objektivi 2	Deri në vitin 2030 të krijohet së paku 3 qendër grumbulluese me kapacitete ftohjeje dhe paketimi për produktet bujqësore.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të rritet sipërfaqja e tokave me sisteme funksionale të ujitjes me 30%.
Objektivi 4	Deri në vitin 2028 të krijohet së paku 1 mikro-park agro-përpunues për qumësht, pemë-perime dhe produkte ushqimore.
Objektivi 5	Deri në vitin 2034 të reduktohet sipërfaqja e tokave djerrë me 25% krahasuar me vitin bazë.
QËLLIMI 3	Zhvillimi i ekonomisë së dijes, inovacionit dhe kapitalit njerëzor si bazë e transformimit ekonomik të Ferizajt
Objektivi 1	Deri në vitin 2029 të krijohet së paku 1 qendër e inovacionit dhe inkubator për startup-e në bërthamën urbane.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të trajnohen minimum 2,000 persona në profile të kërkuara nga tregu (ICT, CNC, logjistikë, përpunim druri, elektroteknikë).
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të krijohen së paku 200 biznese të reja në sektorët e teknologjisë, shërbimeve profesionale dhe industrive kreative.
Objektivi 4	Deri në vitin 2034 të krijohen minimum 10 partneritete funksionale universitet–biznes për zhvillimin e inovacionit dhe praktikës profesionale.
QËLLIMI 4	Zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm rural dhe malor si motor i diversifikimit ekonomik lokal
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të rritet numri i vizitorëve në destinacionet turistike të komunës me 50%.
Objektivi 2	Deri në vitin 2030 të zhvillohen ose rehabilitohen minimum 50 km shtigje turistike dhe rekreative në zonën Jezerc–Nerodime–Pleshinë–Burnnik–Rahovicë.
Objektivi 3	Zhvillimi i zonave turistike si Jezerc, Kodra e Sherretëve, Nerodime, Rahovicë.
Objektivi 4	Deri në vitin 2034 të krijohen së paku 5 pika turistike hyrëse (trailheads) me parking, sanitare dhe informacion turistik.
Objektivi 5	Deri në vitin 2034 të rritet kapaciteti i akomodimit rural me 30%.
Objektivi 6	Deri në vitin 2034 të zhvillohet një sistem i integruar i menaxhimit dhe promovimit të destinacionit turistik të Ferizajt.
QËLLIMI 5	Forcimi i ekonomisë së gjelbër, sigurisë energjetike dhe reziliencës mjedisore
Objektivi 1	Deri në vitin 2028 të integrohen kapacitetet energjetike të planifikuara BESS dhe të mbështeten investimet në energji solare në zonat ekonomike dhe objektet publike.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të instalohen sisteme fotovoltaike në minimum 20 ndërtesa publike ose zona ekonomike.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të funksionalizohet impianti për trajtimin e ujërave të zeza dhe të sigurohet trajtim i kontrolluar për shumicën e zonave urbane dhe industriale.
Objektivi 4	Deri në vitin 2034 të krijohet së paku 1 qendër për ekonomi qarkore dhe riciklim në zonën industriale.
Objektivi 5	Deri në vitin 2034 të reduktohet sasia e mbetjeve të depozituara pa trajtim me 30%.
QËLLIMI 6	Shfrytëzimi i qëndrueshëm i pasurive nëntokësore dhe materialeve ndërtimore në funksion të zhvillimit ekonomik lokal dhe mbrojtjes së mjedisit.
Objektivi 1	Deri në vitin 2030 të identifikohen, zonohen dhe menaxhohen 100% e lokacioneve aktive dhe potenciale për shfrytëzimin e materialeve minerale dhe ndërtimore, në përputhje me kriteret e mbrojtjes së tokës bujqësore, burimeve ujore dhe zonave turistike.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të rehabilitohen ose rikultivohen minimum 80% e sipërfaqeve të degraduara nga aktivitetet nxjerrëse, përmes planeve të detyrueshme të rehabilitimit dhe monitorimit mjedisor.
QËLLIMI 7	Rritja e kontributit të resurseve minerale dhe materialeve ndërtimore në ekonominë lokale përmes shfrytëzimit të kontrolluar dhe krijimit të vlerës së shtuar.
Objektivi 1	Deri në vitin 2028 të krijohen kushte infrastrukturore dhe planifikuese për zhvillimin e aktiviteteve nxjerrëse dhe përpunuese në zonat e përshtatshme ekonomike.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të rritet me 20% përpunimi lokal i materialeve ndërtimore dhe mineraleve krahasuar me vitin bazë 2025.

INFRASTRUKTURA TEKNIKE

▪ Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

QËLLIMI 1	Të sigurohet një sistem i integruar, i qëndrueshëm dhe rezilient i furnizimit me ujë, kanalizimit dhe menaxhimit të ujërave atmosferike, i cili garanton siguri ujore afatgjatë, mbrojtje të mjedisit, shëndet publik dhe mbështetje për zhvillimin urban, ekonomik dhe industrial të Komunës së Ferizajt.
Objekti 1	Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe afatgjatë me ujë të pijshëm për të gjitha zonat urbane dhe rurale të komunës.
Objekti 2	Diversifikimi i burimeve të furnizimit me ujë përmes zhvillimit të projekteve strategjike si Hidrosistemi Lepenc dhe Diga e Jezercit.
Objekti 3	Reduktimi i humbjeve teknike dhe komerciale të ujit përmes rehabilitimit të rrjetit dhe implementimit të sistemeve moderne të monitorimit.
Objekti 4	Ridimensionimi dhe zgjerimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit në përputhje me zhvillimin urban dhe projeksionet demografike.
Objekti 5	Sigurimi i infrastrukturës adekuate teknike për zonat ekonomike, industriale dhe zonat e reja të zhvillimit.
Objekti 6	Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të kanalizimit në të gjitha vendbanimet e komunës.
Objekti 7	Ndërtimi dhe funksionalizimi i Impiantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza (ITUZ Ferizaj Jug).
Objekti 8	Ndarja graduale e sistemeve të kanalizimit fekal dhe atmosferik.
Objekti 9	Përmirësimi i sistemit të drenazhimit urban dhe reduktimi i rrezikut nga vërshimet.
Objekti 10	Promovimi i ripërdorimit të ujërave atmosferikë dhe zbatimi i sistemeve Rainwater Harvesting (RWH).
Objekti 11	Rritja e reziliencës së sektorit ndaj ndryshimeve klimatike dhe periudhave të thatësirës.
Objekti 12	Digjitalizimi dhe modernizimi i menaxhimit të sistemeve përmes SCADA, GIS dhe DMA.

▪ Rrjeti i ujitjes

QËLLIMI 1	Zhvillimi i sistemit të ujitjes për tokat bujqësore, me qëllim rritjen e produktivitetit, qëndrueshmërisë dhe konkurrueshmërisë së sektorit bujqësor
Objekti 1	Zgjerimi i mbulueshmërisë së tokave bujqësore me sistem të organizuar dhe efikas të ujitjes, duke prioritetizuar zonat me potencial të lartë bujqësor.
Objekti 2	Zhvillimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së ujitjes, përmes ndërtimit, zgjerimit dhe modernizimit të rrjetit dhe objekteve përcjellëse.
Objekti 3	Rritja e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë në shfrytëzimin e burimeve ujore për bujqësi, duke promovuar sisteme bashkëkohore të ujitjes dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

▪ Energjia elektrike

QËLLIMI 1	Furnizimi i qëndrueshëm dhe vazhdueshëm i qytetareve me energji elektrike
Objekti 1	Reduktimi i humbjeve të energjisë elektrike në vazhdimësi.
Objekti 2	Kalimi nga rrjeti elektrik radial në rrjet elektrik unazor në nivelin 10(20) kV.
Objekti 3	Ndërtimi i rrjetit energjetik SMART në nivelin 10(20) dhe 0.4 kV.
QËLLIMI 2	Rritja e cilësisë së energjisë dhe diversifikimi i burimeve të energjisë
Objekti 1	Stimulimi i prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtitshme.
Objekti 2	Bashkërendimi në montimin e baterive akumuluese në afërsi të nënstacionit 400/110 kV.
Objekti 3	Rritja e kapaciteteve transformuese në rrjetin 110 kV.
QËLLIMI 3	Rrjet eficient dhe i mençur i ndriçimit publik
Objekti 1	Ndërtimi i rrjetit të ndriçimit publik me ndriçues eficient dhe menaxhim SMART i ndriçimit.
Objekti 2	Mirëmbajtje dhe rivitalizim i rrjetit ekzistues dhe vendosje e pajisjeve eficiente dhe të mençura.

▪ Energjia termike

QËLLIMI 1	Krijimi i kushteve për zhvillimin e një sistemi të organizuar të ngrohjes në Ferizaj
Objektivi 1	Hartimi i studimit të fizibilitetit për identifikimin e konceptit më të përshtatshëm të sistemit të organizuar të ngrohjes në Komunën e Ferizajt deri në vitin 2028.
Objektivi 2	Përcaktimi i zonave prioritare dhe hartimi i projektit kryesor për zhvillimin fazor të sistemit të organizuar të ngrohjes deri në vitin 2028.
Objektivi 3	Zbatimi fazor i planit për zhvillimin e sistemit të organizuar të ngrohjes në zonat prioritare deri në vitin 2034.
Objektivi 4	Zhvillimi gradual i infrastrukturës së ngrohjes në përputhje me nevojat e zhvillimit urban dhe rural.
QËLLIMI 2	Orientimi drejt diversifikimit të burimeve të energjisë për ngrohje
Objektivi 1	Promovimi i përdorimit të burimeve alternative dhe të ripërtëritshme të energjisë për ngrohje (biomasa, energjia diellore, energjia gjeotermale dhe gazi natyror).
Objektivi 2	Diversifikimi i furnizimit me energji termike përmes integritit të burimeve alternative dhe të ripërtëritshme të energjisë deri në vitin 2034.
QËLLIMI 3	Përmirësimi i efikasitetit energjik dhe zvogëlimi i ndikimit mjedisor
Objektivi 1	Rritja e performancës energjetike të ndërtesave përmes reduktimit të humbjeve të energjisë për ngrohje.
Objektivi 2	Integrimi i teknologjive dhe sistemeve moderne me efikasitet të lartë energjetik në sektorin e ngrohjes.
Objektivi 3	Reduktimi i ndikimit mjedisor dhe përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes aplikimit të zgjidhjeve më efikase të ngrohjes.

▪ Telekomunikimi dhe instalimet e ngjashme

QËLLIMI 1	Sigurimi i qasjes universale në infrastrukturë moderne dhe të qëndrueshme telekomunikuese për të gjithë banorët dhe bizneset e komunës së Ferizajt.
Objektivi 1	Të zgjerohet mbulueshmëria me rrjete mobile 5G në të gjitha zonat urbane dhe në minimum 90% të vendbanimeve rurale deri në vitin 2029.
Objektivi 2	Të zhvendosen së paku 60% e rrjeteve ajrore telekomunikuese në infrastrukturë të përbashkët nëntokësore brenda zonës urbane deri në vitin 2035.
Objektivi 3	Të sigurohet lidhje me fibër optike për 100% të institucioneve publike, shkollave, qendrave shëndetësore dhe objekteve administrative deri në vitin 2030.
Objektivi 4	Të krijohet një sistem i përbashkët komunal për koordinimin e infrastrukturës telekomunikuese me pjesëmarrjen e të gjithë operatorëve deri në vitin 2028.
QËLLIMI 1	Transformimi i Ferizajt në një komunë të lidhur dhe inteligjente përmes zhvillimit të infrastrukturës dhe shërbimeve digjitale
Objektivi 1	Të mundësohet integrimi i teknologjive Smart City në minimum 5 sektorë komunalë (trafik, siguri publike, energji, mjedis dhe administratë publike) deri në vitin 2035.
Objektivi 2	Të rritet numri i pikave publike Wi-Fi në hapësirat publike, institucionet komunale dhe qendrat e komunitetit në minimum 50 lokacione deri në vitin 2030.

▪ Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

QËLLIMI 1	Zhvillimi i një sistemi të integruar dhe të qëndrueshëm të menaxhimit të mbeturinave, përmes zgjerimit të mbulueshmërisë së shërbimeve, avancimit të ndarjes dhe riciklimit të mbeturinave, reduktimit të deponive ilegale dhe përmirësimit të monitorimit, me synim mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik
Objektivi 1	Vlerësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për grumbullimin e mbeturinave për të siguruar mbulim 100% për ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet publike deri në vitin 2030.
Objektivi 2	Zhvillimi i sistemit për ndarjen e mbeturinave në burim, riciklimin, kompostimin dhe trajtimin e kategorive të veçanta të mbeturinave deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Eliminimi i vend- deponive ilegale dhe reduktimi i hedhjes ilegale të mbeturinave përmes zbatimit, monitorimit dhe ndërgjegjësimit të publikut deri në vitin 2034.
Objektivi 4	Krijimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për menaxhimin e mbeturinave, duke përfshirë gjenerimin, grumbullimin, transportimin, trajtimin dhe riciklimin e tyre, si dhe inventarizimin e lokacioneve problematike deri në vitin 2030.
Objektivi 5	Krijimi i infrastrukturës për grumbullimin dhe menaxhimin e rrymave specifike të mbeturinave (vëllimshme, të rrezikshme, industriale, medicinale, shtazore dhe ndërtimore) deri në vitin 2031.

INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

QËLLIMI 1	Zhvillimi i një sistemi të integruar, funksional dhe të qëndrueshëm të infrastrukturës së transportit që mbështet organizimin hapësinor dhe zhvillimin ekonomik të Komunës së Ferizajt
Objektivi 1	Funksionalizimi i sistemit të qarkoreve të qytetit për ndarjen e trafikut tranzit nga trafiku urban.
Objektivi 2	Zhvillimi i rrjetit rrugor përmes realizimit të korridoreve të reja strategjike, zgjerimit të akseve kryesore zhvillimore dhe përmirësimit të lidhjeve ndërmjet zonave me potencial urban, ekonomik dhe logjistik.
Objektivi 3	Përmirësimi i hierarkisë funksionale të rrjetit rrugor sipas kategorive të planifikuara.
Objektivi 4	Përmirësimi i nivelit të shërbimit, kapacitetit dhe sigurisë së rrjetit rrugor.
Objektivi 5	Integrimi funksional i rrjetit rrugor me autoudhën, rrjetin hekurudhor dhe korridoret rajonale.
QËLLIMI 2	Zhvillimi i një sistemi të qëndrueshëm të mobilitetit me prioritet për këmbësorët, biçikletat dhe hapësirat publike cilësore
Objektivi 1	Zhvillimi i një rrjeti të vazhdueshëm dhe të sigurt të infrastrukturës për këmbësorët.
Objektivi 2	Zhvillimi i rrjetit të shtigjeve për biçikleta si pjesë integrale e mobilitetit urban.
Objektivi 3	Garantimi i aksesueshmërisë universale për të gjithë përdoruesit e hapësirës publike.
Objektivi 4	Integrimi i mobilitetit aktiv me transportin publik dhe sistemin e parkimeve.
Objektivi 5	Përmirësimi i cilësisë së hapësirave publike përgjatë korridoreve urbane.
QËLLIMI 3	Zhvillimi i një sistemi modern, funksional dhe të integruar të transportit publik
Objektivi 1	Zgjerimi i mbulueshmërisë territoriale me transport publik.
Objektivi 2	Riorganizimi i rrjetit të linjave sipas strukturës së zhvillimit urban
Objektivi 3	Integrimi funksional i transportit publik me transportin hekurudhor dhe nyjet multimodale.
Objektivi 4	Përmirësimi i infrastrukturës së transportit publik dhe modernizimi gradual i flotës.
QËLLIMI 4	Rritja e sigurisë rrugore dhe optimizimi i funksionimit të rrjetit të transportit
Objektivi 1	Zbatimi i hierarkisë funksionale të nyjeve dhe kontrollit të qasjeve në rrjetin strategjik.
Objektivi 2	Trajtimi i nyjeve strategjike dhe eliminimi i konflikteve ndërmjet trafikut rrugor dhe hekurudhor.
Objektivi 3	Standardizimi i profileve rrugore sipas funksionit dhe hierarkisë së rrugëve.
Objektivi 4	Përmirësimi i sigurisë për të gjithë përdoruesit e rrugës.
Objektivi 5	Zvogëlimi i konflikteve të trafikut dhe rritja e efikasitetit të qarkullimit.
QËLLIMI 5	Menaxhimi inteligjent i trafikut dhe parkimeve përmes teknologjive bashkëkohore
Objektivi 1	Organizimi dhe menaxhimi i parkimeve sipas funksioneve urbane.
Objektivi 2	Zhvillimi i sistemit "Parko dhe Udhëto" (P+U).
Objektivi 3	Implementimi gradual i Sistemeve Intelgjente të Transportit (SIT).
Objektivi 4	Digjitalizimi i menaxhimit të trafikut dhe parkimeve.
Objektivi 5	Krijimi i një platforme të integruar për monitorimin dhe analizën e të dhënave të trafikut.
QËLLIMI 6	Mbështetja e zhvillimit hapësinor të qëndrueshëm përmes një sistemi të balancuar dhe të integruar të transportit
Objektivi 1	Orientimi i zhvillimit urban sipas hierarkisë së rrjetit të transportit dhe korridoreve zhvillimore.
Objektivi 2	Integrimi i transportit me planifikimin e përdorimit të tokës dhe zhvillimin ekonomik të komunës.
Objektivi 3	Promovimi i zhvillimit kompakt urban dhe reduktimi i zgjerimit të pakontrolluar.
Objektivi 4	Përmirësimi i cilësisë së mjedisit urban përmes promovimit të mobilitetit të qëndrueshëm.

INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

■ Shëndetësia dhe mirëqenia sociale

QËLLIMI 1	Sigurimi i qasjes së barabartë dhe efikase në shërbimet shëndetësore për të gjithë banorët përmes një rrjeti të balancuar të infrastrukturës shëndetësore.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të sigurohet mbulim i plotë i zonave urbane dhe rurale me shërbime të kujdesit parësor shëndetësor sipas standardeve të qasjes dhe projeksioneve demografike.
Objektivi 2	Deri në vitin 2030 të zhvillohen kapacitete shtesë shëndetësore në zonat me mbulim të pamjaftueshëm dhe presion demografik, me fokus në Talinoc të Jerlive dhe pjesët lindore të zonës urbane.
QËLLIMI 2	Forcimi i kohezionit social dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet komunitare për të gjitha grupet e popullsisë.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të zhvillohet një rrjet i balancuar i qendrave sociale dhe komunitare në zonat urbane dhe rurale.
Objektivi 2	Deri në vitin 2030 të sigurohen hapësira të dedikuara për shërbime sociale, përkujdesje për grupet e cënueshme dhe aktivitete komunitare.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të rritet qasja në shërbime sociale në qendrat rurale me funksione zhvillimore.

■ Arsimi

QËLLIMI 1	Përmirësimi i qasjes në edukimin e hershëm përmes zgjerimit të rrjetit të institucioneve parashkollore dhe shpërndarjes së tyre të balancuar hapësinore.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të eliminohet deficieti i sipërfaqeve për institucione parashkollore në zonat urbane dhe rurale.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të zhvillohen kapacitete të reja parashkollore në pjesën lindore, veriore dhe perëndimore të zonës urbane si dhe në qendrat rurale me kërkesë të lartë.
QËLLIMI 2	Sigurimi i një rrjeti arsimor gjithëpërfshirës dhe funksional që garanton qasje cilësore dhe të barabartë në arsim.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të sigurohen kapacitete të mjaftueshme për arsimin fillor dhe të mesëm të ulët në zonat me deficit dhe rritje të popullsisë.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të përmirësohet mbulueshmëria territoriale e rrjetit arsimor në pjesët veri-lindore, jugore dhe qendrore të zonës urbane.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të zhvillohen hapësira mbështetëse për edukatë fizike, aktivitete jashtëmësimore dhe mësim gjithëditor në institucionet arsimore.

■ Administratë

QËLLIMI 1	Modernizimi i administratës publike dhe përmirësimi i qasjes së qytetarëve në shërbime publike përmes digjitalizimit, decentralizimit dhe forcimit të infrastrukturës së sigurisë publike.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të rritet qasja e qytetarëve në shërbime administrative digjitale përmes integritit dhe promovimit të platformave elektronike shtetërore dhe komunale.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të zvogëlohet nevoja për prezencë fizike të qytetarëve në administratë për shërbimet bazë administrative përmes transformimit digjital të proceseve komunale.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të përmirësohet mbulueshmëria territoriale e shërbimeve publike administrative në qendrat lokale dhe vendbanimet me funksione zhvillimore.
Objektivi 4	Deri në vitin 2034 të zhvillohen kapacitetet infrastrukturore të institucioneve të sigurisë publike, mbrojtjes civile dhe menaxhimit të emergjencave në përputhje me rritjen urbane dhe nevojat e popullsisë.

■ Kulturë, rini dhe sport

QËLLIMI 1	Zhvillimi i infrastrukturës kulturore dhe rinore si faktor i identitetit lokal, kreativitetit dhe jetës komunitare.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të krijohen hapësira të mjaftueshme sipas kërkesave ligjore për institucione kulturore në zonën urbane dhe rurale.
Objektivi 2	Deri në vitin 2028 të modernizohet qendra kulturore multifunkionale në Ferizaj dhe ndërtohen qendra rinore në zona rurale.
Objektivi 3	Deri në vitin 2034 të rritet qasja e të rinjve në aktivitete kulturore, edukative dhe kreative.
QËLLIMI 2	Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe shëndetit publik përmes zhvillimit të një rrjeti të integruar të hapësirave sportive dhe rekreative.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të krijohen hapësira të reja sportive dhe rekreative në zonat me mungesë të mbulueshmërisë, veçanërisht në pjesët jugore, veriore dhe jug-lindore të qytetit.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të lidhen hapësirat sportive me rrjetin e gjelbër, shtigjet e ecjes dhe çiklizmit.

▪ **Hapësira publike**

QËLLIMI 1	Krijimi i një sistemi të hapësirave publike cilësore dhe të qasshme që promovojnë ndërveprimin social dhe identitetin urban.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të krijohet një rrjet i lidhur i parqeve, shesheve dhe hapësirave publike në lagjet me densitet të lartë banimi.
Objektivi 2	Deri në vitin 2034 të sigurohet që çdo lagje urbane të ketë qasje në një hapësirë publike brenda distancës së ecjes.
QËLLIMI 2	Sigurimi i kapaciteteve të qëndrueshme dhe shpërndarjes së balancuar të varrezave publike në funksion të nevojave afatgjata të popullsisë dhe zhvillimit hapësinor të komunës.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të ruhen dhe sigurohen kapacitete të mjaftueshme hapësinore për varreza publike në përputhje me projeksionet demografike dhe standardet e planifikimit hapësinor.

MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

QËLLIMI 1	Mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në territorin e Komunës së Ferizajt
Objektivi 1	Reduktimi i ndotjes organike dhe sedimentare në lumin Nerodime përmes zgjerimit të rrjetit të kanalizimit, trajtimit të ujërave të ndotura dhe eliminimit të shkarkimeve të patrajuara në segmentet Gërlicë–Nerodime e Poshtme deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Mbrojtja e burimeve ujore dhe ujërave nëntokësore në zonat me ndjeshmëri të lartë dhe shumë të lartë, përmes përcaktimit dhe zbatimit të zonave të mbrojtjes sanitare, kontrollit të aktiviteteve ndotëse dhe përmirësimit të infrastrukturës së kanalizimit deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Përmirësimi i statusit ekologjik të lumit Nerodime në stacionet monitoruese Gërlicë dhe Kaçanik deri në vitin 2034, përmes reduktimit të presioneve urbane, bujqësore dhe hidromorfologjike që ndikojnë në komunitetet e diatomeve, makroinvertebrorëve dhe peshqve.
	Ruajtja e gjendjes së mirë ekologjike të segmentit të sipërm të lumit Nerodime në Jezercë si zonë referuese e cilësisë së ujit, duke parandaluar zhvillimet dhe aktivitetet që mund të cenojnë parametrat fizikë, kimikë dhe biologjikë të këtij trupi ujqor deri në vitin 2034.
QËLLIMI 2	Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe reduktimi i emetimeve nga burimet urbane, industriale dhe transporti
Objektivi 1	Krijimi dhe funksionalizimi i sistemit lokal për monitorimin e cilësisë së ajrit deri në vitin 2028, përmes vendosjes së së paku një stacioni automatik ose mobil monitorues në zonën urbane të Ferizajt, me fokus në parametrat PM10, PM2.5, NO ₂ , SO ₂ , CO dhe O ₃ .
Objektivi 2	Hartimi i inventarit lokal të burimeve ndotëse të ajrit deri në vitin 2028, duke identifikuar dhe kategorizuar burimet kryesore të emetimeve në zonën urbane, përgjatë korridoreve kryesore rrugore, zonave industriale, aktiviteteve ndërtimore dhe sektorit të ngrohjes në ekonomi familjare, institucionale dhe biznesore.
Objektivi 3	Reduktimi i ndotjes nga grimcat PM10 dhe PM2.5 gjatë sezonit dimëror në zonën urbane të Ferizajt deri në vitin 2034, përmes uljes së përdorimit të lëndëve djegëse për ngrohje, promovimit të sistemeve më efikase të ngrohjes dhe mbështetjes së ekonomive familjare, institucioneve publike dhe bizneseve për kalim drejt burimeve më të pastra të energjisë.
Objektivi 4	Reduktimi i emetimeve nga transporti brenda qytetit dhe përgjatë akseve rrugore me qarkullim të lartë deri në vitin 2034, përmes përmirësimit të transportit publik, krijimit të kushteve për transport alternativ, menaxhimit më të mirë të trafikut dhe uljes së ekspozimit të popullsisë ndaj NO ₂ dhe grimcave të pluhurit.
Objektivi 5	Kontrollimi dhe monitorimi i emetimeve nga zonat industriale, bizneset prodhuese dhe aktivitetet ndërtimore deri në vitin 2030, me fokus pluhurin, djegiet joformale, emetimet nga proceset prodhuese dhe respektimin e kushteve mjedisore nga operatorët ekonomikë.
Objektivi 6	Krijimi i bazës komunale të të dhënave për cilësinë e ajrit deri në vitin 2030.
Objektivi 7	Reduktimi i ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes akustike në zonat urbane, përgjatë korridoreve kryesore të transportit dhe zonave industriale deri në vitin 2030, përmes monitorimit të zhurmës dhe zbatimit të masave mbrojtëse.
QËLLIMI 3	Mbrojtja e tokës dhe menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore
Objektivi 1	Mbrojtja e tokës bujqësore me potencial të lartë prodhues në zonën e Ferizajt, Talinocit, Bibajt, Komogllavës, Rahovicës, Miroslalës, Mirashit dhe fushave bujqësore përreth vendbanimeve kryesore, përmes kufizimit të zgjerimit të pakontrolluar të zonave të ndërtimit dhe ruajtjes së fondit të tokës bujqësore deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Parandalimi i erozionit, degradimit të tokës dhe humbjes së biodiversitetit në zonat me ndjeshmëri të lartë, veçanërisht në Jezercë, Neredime të Epërme, Neredime të Poshtme, Manastirc, Pleshinë dhe Burmik; kontrolli i ndërhyrjeve në terrene me pjerrësi, ruajtja e mbulesës bimore dhe zbatimi i masave mbrojtëse deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Rehabilitimi dhe rikthimi i funksionit ekologjik dhe prodhues të sipërfaqeve të degraduara nga aktivitetet ndërtimore, nxjerrja e materialeve, erozioni dhe përdorimet e papërshtatshme të tokës deri në vitin 2034.
Objektivi 4	Reduktimi i ndotjes së tokës nga depozitimet e pakontrolluara të mbeturinave, shkarkimet e aktiviteteve ekonomike dhe përdorimi joadekuat i pesticideve, herbicideve dhe plehrave kimike në zonat bujqësore të komunës deri në vitin 2034.
Objektivi 5	Vendosja e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit periodik të cilësisë së tokës në bashkëpunim me Institutin Bujqësor të Kosovës dhe IHMK deri në vitin 2030, me fokus tokat bujqësore, zonat industriale dhe zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore.
QËLLIMI 4	Rritja e reziliencës ndaj fatkeqësive natyrore dhe ndryshimeve klimatike
Objektivi 1	Zvogëlimi i rrezikut nga përmbytjet në pellgun e lumit Nerodime, lumenjve Pleshina dhe Gaçka, si dhe përgjatë kanalit Kosinë–Lubovc–Tërn deri në vitin 2034, me rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve, kanaleve kulluese dhe sistemeve të drenazhimit, me fokus në zonat më të rrezikuara.
Objektivi 2	Integrimi i infrastrukturës së gjelbër dhe sistemeve të qëndrueshme të drenazhimit në zonat urbane dhe periurbane të Ferizajt, me qëllim rritjen e kapacitetit të territorit për menaxhimin e ujërave atmosferike deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Parandalimi dhe reduktimi i erozionit të tokës dhe sedimentimit në pellgun e lumit Nerodime deri në vitin 2034, përmes praktikave të pyllëzimit, stabilizimit të shpateve, kontrollit të shfrytëzimit të tokës dhe zbatimit të masave mbrojtëse në zonat me rrezik të lartë eroziv në pjesët perëndimore dhe lindore të komunës.
Objektivi 4	Monitorimi dhe menaxhimi i zonave me rrezik nga rrëshqitjet lokale të dheut deri në vitin 2030, me theks të veçantë në Zaskok dhe zonat tjera me pjerrësi të theksuar apo ndërhyrje infrastrukturore.
Objektivi 5	Minimizimi i rrezikut nga zjarret në zonat pyjore, rurale dhe bujqësore deri në vitin 2034, përmes forcimit të masave parandaluese, mirëmbajtjes së brezave mbrojtës, monitorimit sezonal dhe ndërgjegjësimit për parandalimin e djegieve të pakontrolluara të barishteve dhe mbetjeve bujqësore.
Objektivi 6	Përmirësimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm dhe përgatitja e planeve lokale të reagimit, për menaxhimin e emergjencave deri në vitin 2030.
Objektivi 7	Identifikimi, monitorimi dhe rehabilitimi i “hotspotëve” potenciale deri në vitin 2034, me fokus segmentin urban të lumit Nerodime, zonën përreth deponisë tranzite në Gërlicë dhe zonat me përqendrim të aktiviteteve industriale.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

Objektivi 8	Integrimi i masave të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin komunal deri në vitin 2034, duke shmangur zhvillimin në zonat e ekspozuara ndaj përmytyjeve dhe erozionit, duke rritur sipërfaqet e gjelbra dhe duke promovuar zgjidhje të bazuara në natyrë.
QËLLIMI 5	Mbrojtja e biodiversitetit, peizazhit natyror dhe hapësirave të gjelbra
Objektivi 1	Ruajtja dhe përmirësimi i habitateve natyrore, pyjeve dhe korridoreve ekologjike deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Rritja e sipërfaqeve të gjelbra publike dhe përmirësimi i lidhshmërisë ekologjike ndërmjet zonave urbane dhe rurale deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Mbrojtja dhe promovimi i monumenteve natyrore, vlerave peizazhore dhe trashëgimisë natyrore të komunës deri në vitin 2034.
Objektivi 4	Rritja e vetëdijes publike dhe edukimit mjedisor për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit deri në vitin 2030.
QËLLIMI 6	Promovimi i energjisë së ripërtëritshme dhe tranzicioni drejt energjisë së pastër
Objektivi 1	Rritja e përdorimit të sistemeve të energjisë së ripërtëritshme në ndërtesat publike komunale deri në vitin 2034, përmes instalimit të sistemeve fotovoltaike dhe teknologjive tjera të energjisë së pastër, me synim uljen e konsumit të energjisë nga burimet konvencionale.
Objektivi 2	Promovimi i përdorimit të energjisë së ripërtëritshme në sektorin rezidencial, komercial dhe industrial deri në vitin 2034, përmes lehtësimit të procedurave, ofrimit të informacionit teknik dhe mbështetjes së iniciativave për instalimin e sistemeve solare dhe teknologjive tjera.
Objektivi 3	Integrimi i parimeve të efikasitetit energjetik dhe energjisë së ripërtëritshme në planifikimin hapësinor dhe zhvillimin urban deri në vitin 2030, përmes përcaktimit të kriterëve dhe standardeve për ndërtimet e reja dhe zonat e zhvillimit.
Objektivi 4	Krijimi i bazës komunale të të dhënave për potencialin e energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2030, duke identifikuar zonat me potencial për energji solare, biomase dhe forma të tjera të energjisë së pastër për orientimin e investimeve të ardhshme.

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE NATYRORE

QËLLIMI 1	Mbrojtja, ruajtja dhe menaxhimi i integruar i trashëgimisë kulturore dhe natyrore përmes planifikimit hapësinor dhe zbatimit të legjislacionit.
Objektivi 1	Të integrohen të gjitha asetet e trashëgimisë kulturore dhe natyrore në dokumentet e planifikimit hapësinor, duke përcaktuar perimetrit dhe kufijtë mbrojtës, regjimet e zhvillimit dhe masat e menaxhimit sipas legjislacionit në fuqi.
Objektivi 2	Të përmirësohet gjendja fizike dhe ekologjike e së paku 30% e aseteve prioritare përmes konservimit, restaurimit dhe masave aktive të menaxhimit.
QËLLIMI 2	Valorizimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore si burim i identitetit lokal, edukimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.
Objektivi 1	Deri në vitin 2034 të krijohen të paktën 3 itinerare tematike kulturore dhe natyrore dhe të funksionalizohen minimumi 5 lokacione për vizitorë.
Objektivi 2	Të organizohen minimumi 3 aktivitete publike në vit, ndërsa të gjitha asetet e mbrojtura të pajisen me informim interpretues ose platformë digjitale deri në vitin 2034.

VENDBANIMET

QËLLIMI 1	Zhvillimi i qëndrueshëm hapësinor dhe menaxhimi racional i territorit
Objekti 1	Zhvillimi kompakt i zonës urbane.
Objekti 2	Organizimi policentrik i vendbanimeve.
Objekti 3	Shfrytëzimi racional i tokës.
Objekti 4	Parandalimi i zgjerimit të pakontrolluar urban.
QËLLIMI 2	Zhvillimi i balancuar i sistemit të vendbanimeve
Objekti 1	Konsolidimi i qytetit të Ferizajt.
Objekti 2	Përmirësimi i qasjes në shërbime publike.
QËLLIMI 3	Infrastrukturë moderne dhe mobilitet i qëndrueshëm
Objekti 1	Përmirësimi i rrjetit rrugor.
Objekti 2	Zhvillimi i transportit publik.
Objekti 3	Përmirësimi i infrastrukturës komunale.
Objekti 4	Rritja e sigurisë në komunikacion.
QËLLIMI 4	Mbrojtja e mjedisit dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
Objekti 1	Mbrojtja e burimeve natyrore.
Objekti 2	Menaxhimi i mbeturinave.
Objekti 3	Zhvillimi i infrastrukturës së gjelbër.
Objekti 4	Rritja e reziliencës klimatike.
QËLLIMI 5	Zhvillimi rural dhe bujqësia e qëndrueshme
Objekti 1	Modernizimi i bujqësisë.
Objekti 2	Përmirësimi i infrastrukturës rurale.
Objekti 3	Zhvillimi i agroturizmit, turizmit malor.
QËLLIMI 6	Zhvillimi dhe avancimi i cilësisë së jetesës dhe mirëqenies sociale
Objekti 1	Përmirësimi i shërbimeve publike.
Objekti 2	Zhvillimi i arsimit dhe shëndetësisë.
Objekti 3	Përmirësimi i kushteve të banimit.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

VENDBANIMET JO FORMALE

QËLLIMI 1	Integrimi i vendbanimeve joformale në strukturën zyrtare të planifikimit, respektivisht Eliminimi i strehimit joformal dhe sigurimi i banimit të dinjitetshëm për të gjithë
Objekti 1	Evidentimi dhe kategorizimi i tyre në bazë të kriterëve teknike dhe ligjore, deri në 2034.
Objekti 2	Hartimi i planeve rregulluese për integrimin e tyre gradual, deri më 2034.
Objekti 3	Strehim i sigurtë i të gjitha familjeve deri në vitin 2034.
QËLLIMI 2	Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike dhe inkluzionit shoqëror të komuniteteve të prekura dhe Reduktimi i pabarazive socio-hapësinore në vendbanime joformale
Objekti 1	Investime në infrastrukturë bazë, ashtu që familjet të kenë mundësi t'jë barabarta për mirëqenie, deri në 2034.
Objekti 2	Përfshirje aktive e banorëve në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes.
Objekti 3	Banorët e dikurshëm të vendbanimeve joformale të kenë përfaqësues të tyre (formal ose joformal) në mekanizmat konsultativë komunal, deri në 2034.
QËLLIMI 3	Legalizimi i Vendbanimeve joformale
Objekti 1	Legalizimi dhe paisja me dokumente pronësie 100% e njësive të banimit në kuadër të VJF, deri më 2034.
Objekti 2	Ofrimi i mbështetjes për legalizimin dhe formalizimin e pronës, deri më 2034.
QËLLIMI 4	Integrimi hapësinor dhe infrastrukturor i zonave të rehabilituara me qytetin
Objekti 1	Integrim funksional dhe estetik në zonat respektive të Ferizajt, deri më 2034.
Objekti 2	Mobiliteti - Sigurimi i lidhjes së transportit publik dhe rregullimi i qasjes (trotuare, ndriçim) , deri në 2034.
Objekti 3	Infrastruktura publike – shtrirja e rrjetit rrugor, ujësjellësit dhe kanalizimit deri në 2034
Objekti 4	Infrastruktura ambientale- Rehabilitimi mjedisor i truallit të liruuar, deri në 2034
QËLLIMI 5	Legalizimi i drejtë dhe funksional i ndërtimeve pa leje
Objekti 1	Krijimi i Regjistratit të ndërtimeve pa leje me ndarje sipas lokacionit dhe funksionit, deri me 2034
Objekti 2	Aplikimi i kriterëve të legalizimit të bazuara në siguri, mjedis dhe pronësi, deri me 2034
QËLLIMI 6	Parandalimi i ndërtimit të ri pa leje
Objekti 1	Forcimi i inspektoratit dhe vendosja e sanksioneve efektive, deri me 2034
Objekti 2	Rritja e transparencës në procesin e dhënies së lejeve për ndërtim, deri me 2034
QËLLIMI 7	Integrimi i ndërtimeve të legalizuara në sistemin urban dhe infrastrukturë
Objekti 1	Përditësimi i planeve urbanistike dhe investime në rrjetet infrastrukturore për ndërtimet e legalizuara, deri me 2034
QËLLIMI 8	Digjitalizimi dhe monitorimi
Objekti 1	Funksionalizimi i plotë i sistemit GIS dhe platformës digjitale për legalizim dhe monitorim, deri me 2034
Objekti 2	Krijimi i Njesisë për Legalizim dhe Zhvillim të Integruar në kuadër të komunës, deri me 2034
QËLLIMI 9	Përfshirja e komuniteteve në proces
Objekti 1	Angazhimi i komunitetit në planifikim për 100% të zonave me ndërtime pa leje, deri me 2034

BANIMI




QËLLIMI 1	Banimi i përballueshëm dhe gjithëpërfshirës
Objektivi 1	Rritja e aksesit në banim për familjet e reja dhe kategoritë në nevojë.
Objektivi 2	Aktivizimi i banesave të zbrazëta për banim social dhe të përballueshëm.
Objektivi 2	Zhvillim urban kompakt dhe i kontrolluar
Objektivi 1	Orientimi i rritjes urbane drejt densifikimit në zona me infrastrukturë ekzistuese.
Objektivi 2	Kufizimi i zgjerimit horizontal mbi tokën bujqësore.
QËLLIMI 3	Përmirësimi i cilësisë së jetesës në lagje
Objektivi 1	Shtimi i hapësirave publike, gjelbërimit dhe parkimeve.
Objektivi 2	Sigurimi i infrastrukturës së plotë në zhvillimet e reja.
QËLLIMI 4	Qëndrueshmëri energjetike dhe mjedisore
Objektivi 1	Rehabilitimi energjetik i fondit ekzistues të banimit.
Objektivi 2	Promovimi i standardeve të ndërtimit me efikasitet energjetik.

SHFRYTËZIMI I TOKËS

QËLLIMI 1	Menaxhimi racional dhe i qëndrueshëm i shfrytëzimit të tokës
Objektivi 1	Reduktimi i zgjerimit horizontal të vendbanimeve dhe orientimi i zhvillimit drejt konsolidimit të zonave ekzistuese urbane deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Integrimi i monitorimit të vazhdueshëm të ndryshimeve në shfrytëzimin e tokës përmes GIS dhe bazave digjitale deri në vitin 2034.
QËLLIMI 2	Mbrojtja e tokës bujqësore, pyjore dhe resurseve natyrore
Objektivi 1	Ruajtja e tokave bujqësore me produktivitet të lartë nga konvertimi në përdorime të tjera deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Stabilizimi dhe rigjenerimi i sipërfaqeve pyjore përmes masave të mbrojtjes dhe rryllëzimit deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Forcimi i mbrojtjes së korridoreve ekologjike, sipërfaqeve ujore dhe zonave me vlera të larta natyrore në përputhje me zhvillimin hapësinor deri në vitin 2034.
QËLLIMI 3	Zhvillimi i balancuar ekonomik dhe funksional i territorit
Objektivi 1	Planifikimi dhe konsolidimi i zonave industriale dhe ekonomike në korridoret kryesore zhvillimore deri në vitin 2030.
Objektivi 2	Orientimi i zhvillimeve ekonomike në zona me infrastrukturë të përshtatshme, duke minimizuar ndikimin në tokën bujqësore dhe zonat ekologjike deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Zhvillimi i zonave me përdorim të përzierë gjatë korridoreve urbane për të rritur efikasitetin e përdorimit të tokës deri në vitin 2034.
QËLLIMI 4	Zhvillimi i strukturës hapësinore policentrike dhe kompakte
Objektivi 1	Fuqizimi i qendrës urbane dhe qendrave sekondare si pole zhvillimi për banim, shërbime dhe ekonomi deri në vitin 2034.
Objektivi 2	Zhvillimi i korridoreve primare dhe sekondare të zhvillimit në përputhje me rrjetin e transportit dhe infrastrukturës komunale deri në vitin 2034.
Objektivi 3	Rritja e qasjes së popullsisë në hapësira rekreative, të gjelbra dhe shërbime publike përmes organizimit racional të përdorimit të tokës deri në vitin 2034.

6.2 KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Në kuadër të PZHK-së së Komunës së Ferizajt janë shqyrtuar tre skenarë hapësinorë, me qëllim analizimin e alternativave të mundshme të zhvillimit territorial, ekonomik, social dhe mjedisor. Skenarët janë përdorur si instrument për vlerësimin e drejtimeve të zhvillimit dhe ndikimeve të mundshme në shfrytëzimin e tokës, infrastrukturë, resurse natyrore dhe cilësi të mjedisit. Të tre skenarët dallojnë në mënyrën e shpërndarjes së zhvillimit, investimeve dhe funksioneve në territor.

Skenari	Koncepti zhvillimor	Implikimet mjedisore
 I. Skenari i zhvillimit policentrik (nga plani i vjetër 2016-2024)	Mbështetet në konceptin policentrik të PZHK-së së mëparshme, ku qyteti i Ferizajt funksionon si qendra kryesore administrative dhe ekonomike, ndërsa një rrjet nën-qendrash lokale merr funksione plotësuese. Zhvillimi orientohet drejt plotësimit dhe dendësimit të vendbanimeve ekzistuese, zhvillimit ekonomik përgjatë korridorit Ferizaj–Babush dhe fuqizimit të lidhjeve rrugore dhe hekurudhore.	Zhvillimi kompakt dhe shpërndarja e funksioneve në disa qendra mund të kufizojnë zgjerimin e pakontrolluar urban dhe të kontribuojnë në ruajtjen e sipërfaqeve bujqësore. Mbatja e trafikut të distancave të largëta jashtë qytetit mund të zvogëlojë presionet e trafikut në zonën qendrore. Megjithatë, zhvillimi përgjatë korridorit ekonomik dhe fuqizimi i disa qendrave lokale krijojnë presione të lokalizuara mbi tokën dhe resurset natyrore.
 II. Skenari i zhvillimit monocentrik, me fokus në korridoret strategjike	Ferizaj si qendër dominuese administrative, ekonomike dhe institucionale. Përqendron investimet përgjatë korridoreve kryesore të transportit. Aktivitetet industriale, prodhuese, tregtare dhe logjistike orientohen kryesisht në zonat industriale. Në zonën urbane parashihet densifikim dhe zgjerim i kontrolluar përgjatë korridoreve infrastrukturore.	Intensifikimi i aktiviteteve ekonomike dhe transportit përgjatë korridoreve krijon presion të shtuar mbi tokën bujqësore, cilësinë e ajrit, zhurmën dhe habitatet natyrore. Zhvillimi linear mund të nxisë fragmentimin e tokave me produktivitet të lartë përgjatë akseve të transportit. Infrastruktura e gjelbër dhe reziliencia ndaj ndryshimeve klimatike marrin rol më dytësor në këtë skenar.
 III. Skenari i zhvillimit maksimal 'skenar i zhvillimit policentrik'	Modeli preferencial i organizimit hapësinor. Mbështetet në strukturë policentrike, me Ferizajn si qendër kryesore dhe me qendra të rendit të mesëm që marrin funksione plotësuese. Korridoret veri–jug dhe lindje–perëndim organizojnë lidhjet kryesore territoriale, ndërsa Babushi dhe Gërlica zhvillohen si një strategjike ekonomike dhe logjistike. Zhvillimi urban orientohet drejt formës kompakte dhe të kontrolluar, duke synuar njëkohësisht fuqizimin e zonave rurale dhe qendrave sekondare.	Përqendrimi i zhvillimeve brenda qendrave dhe korridoreve të përcaktuara krijon kushte më të favorshme për ruajtjen e tokës bujqësore dhe zonave natyrore, ndërsa korridoret e gjelbra dhe mbrojtja e zonave me vlera natyrore mbështesin vazhdimësinë ekologjike dhe biodiversitetin. Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe orientimi drejt strukturës kompakte kontribuojnë gjithashtu në tranzicionin e gjelbër.

	Skenari integron në mënyrë më të drejtpërdrejtë edhe kapitalin natyror në konceptin zhvillimor, duke përfshirë zonat pyjore dhe malore të Jezercit, Bifurkacionin e Nerodimes, resurset ujore, tokat bujqësore dhe peizazhet natyrore. Parashihen gjithashtu korridore të gjelbra, zhvillim rekreativo-turistik dhe promovim i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.	Megjithatë, edhe ky skenar përmban zhvillime ekonomike, infrastrukture dhe turistike që mund të ushtrojnë presion mbi resurset natyrore nëse zbatohen jashtë kapaciteteve mbajtëse të territorit. Për këtë arsye, përparësitë e tij mjedisore varen nga respektimi i kufizimeve hapësinore dhe masave mbrojtëse gjatë zbatimit të PZHK-së.
--	---	--

Bazuar në vlerësimin e përparësive dhe mangësive të skenarëve, Skenari III është përcaktuar si skenar bazë për zhvillimin e mëtejshëm.

ASPEKTE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE MJEDISORE

Diskutimi i të dhënave bazë është të identifikojë gjendjen mjedisore në raport me vizionin, prioritetet dhe efektet e dëshiruara të zhvillimit dhe implementimit të Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt. Ndikimet potenciale të zhvillimeve të ardhshme duhen vlerësuar për nga evolucioni i mundshëm, me ose pa implementimin e planit, përmes indikatorëve të gjendur/supozuar sasiore ose cilësorë. Në thelb, gjendja mjedisore e komunës karakterizohet nga përshkrimi i receptorëve mjedisorë, në pëputhje me kërkesat e Direktivës mbi vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis, si: biodiversiteti, popullsia, shëndeti publik, fauna, flora, toka, uji, ajri, faktorët klimatikë, asetet materiale, trashëgimia kulturore duke përfshirë trashëgiminë arkitekturore dhe arkeologjike, peizazhi dhe ndërlidhja midis faktorëve të mësipërm.

POPULLSIA DHE SHËNDETI PUBLIK

Komuna e Ferizajt karakterizohet nga përqendrim më i madh i popullsisë në zonën urbane dhe në vendbanimet më të mëdha, ndërsa në një pjesë të zonave rurale evidentohen tendenca të depopullimit. Kjo shpërndarje ka rëndësi për VSM-në, pasi zonat me dendësi më të madhe të popullsisë janë njëkohësisht më të ekspozuara ndaj presioneve. Nga aspekti i shëndetit publik, një nga çështjet kryesore lidhet me menaxhimin e ujërave të ndotura. Edhe pse pjesa më e madhe e popullsisë është e lidhur me sistemin publik të kanalizimit, mungesa e trajtimit të ujërave të zeza para shkarkimit krijon presion mbi lumin Nerodime dhe receptorët e tjerë ujorë.

Presione të tjera relevante lidhen me cilësinë e ajrit në zonën urbane dhe përgjatë korridoreve me trafik të intensifikuar, zhurmën nga transporti dhe aktivitetet ekonomike, deponimin e pakontrolluar të mbeturinave dhe ekspozimin e popullsisë në zonat e rrezikuara nga përmytjet. Ndikimi i këtyre faktorëve mund të jetë më i theksuar në zonat ku përqendrohen banimi, transporti dhe aktivitetet ekonomike.

Në rast të mos-zbatimit të masave dhe orientimeve të PZHK, vazhdimi i tendencave ekzistuese mund të rezultojë në rritje të ekspozimit të popullsisë ndaj ndotjes, mbingarkim të infrastrukturës dhe rritje të cenueshmërisë në zonat me rrezik mjedisor. Në anën tjetër, **zbatimi i konceptit të zhvillimit të kontrolluar dhe kompakt**, përmirësimi i kanalizimit dhe trajtimit të ujërave, menaxhimi më i mirë i mbeturinave, mobiliteti i qëndrueshëm dhe zhvillimi i hapësirave të gjelbra krijojnë potencial për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe reduktimin e ekspozimit të popullsisë ndaj presioneve mjedisore.

VEÇORITË NATYRORE KRYESORE TË KOMUNËS DHE ZONAT QË NDIKOHEN

Veçoritë natyrore përbëjnë një element përcaktues për organizimin dhe orientimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor dhe përfaqësojnë receptorë mjedisorë që mund të ndikohen direkt ose indirekt nga urbanizimi, infrastruktura, aktivitetet ekonomike dhe zhvillimi turistik.

Lumi Nerodime dhe sistemi i tij ekologjik, përfshirë Bifurkacionin. Në konceptin hapësinor, zona e Nerodimes trajtohet si korridor ekologjik kryesor, ndërsa Bifurkacioni dhe hapësirat përreth tij si zona me rëndësi të veçantë për mbrojtje. Gjendja e këtyre hapësirave mund të ndikohet nga ndërhyrjet në shtratin e lumit, zhvillimet ndërtimore, ndotja e ujërave dhe fragmentimi i korridorit lumor.

Zona e Burrnikut–Jezercit përfaqëson një tjetër kompleks me vlera të rëndësishme natyrore. Zona konceptohet si një nga polet kryesore natyrore dhe rekreative të komunës. Zhvillimi i turizmit dhe infrastrukturës shoqëruese në zonë kërkon kontroll të kujdesshëm, me qëllim shmangjen e fragmentimit të habitateve, dëmtimin e vegjetacionit dhe ndryshimin e karakterit natyror.

Sipërfaqet pyjore në Jezerc, Burrnik dhe Pleshinë kanë rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit, stabilitetin e tokës dhe vazhdimësinë ekologjike. PZHK parasheh forcimin e lidhjeve ndërmjet këtyre sipërfaqeve përmes korridoreve të gjelbra dhe integrimin e tyre në sistemin më të gjerë të hapësirave natyrore të komunës.

Tokat bujqësore me bonitet të lartë, veçanërisht në pjesët fushore të komunës. Sipërfaqet janë të ndjeshme ndaj zgjerimit urban, zhvillimeve lineare përgjatë korridoreve të transportit dhe ndryshimit të destinimit të tokës. Për këtë arsye, koncepti zhvillimor parasheh respektimin e kufijve ndërtimorë dhe konsolidimin e tokave bujqësore të klasave I–IV.

Zona Pleshinë–Varosh–Talinoc përfaqëson një hapësirë ku zhvillimet e ardhshme duhet të harmonizohen me ruajtjen e karakterit agrar-natyror.

ZONIMI I TERRITORIT TË KOMUNËS

Duke u bazuar në strukturën policentrike të propozuar, karakteristikat e vendbanimeve, potencialin bujqësor dhe pyjor, korridoret strategjike të zhvillimit, resurset natyrore dhe objektivat për menaxhim të qëndrueshëm të tokës, PZHK e Ferizajt orienton territorin në zona kryesore të zhvillimit, shfrytëzimit dhe mbrojtjes. Koncepti synon konsolidimin e zonave ekzistuese të urbanizuara dhe kufizimin e zgjerimit të pakontrolluar.

ZONAT E BANIMIT, ZHVILLIMIT URBAN DHE ZONAT E RRTJES

Zhvillimi i ardhshëm urban orientohet kryesisht drejt plotësimit dhe dendësimit të zonave ekzistuese të ndërtimit, duke shmangur zgjerimin e vazhdueshëm horizontal. PZHK përcakton edhe **zonat e rritjes**, ku parashihet rizhvillim me intensitete më të larta në hapësirat që kanë infrastrukturë dhe qasje të mirë në shërbime, si dhe aktivizimi i tokës së zbrazët të përshtatshme për zhvillim. Kjo qasje synon një strukturë urbane më kompakte dhe reduktimin e presionit mbi tokat bujqësore dhe resurset natyrore.

ZONAT EKONOMIKE, INDUSTRIALE DHE LOGJISTIKE

Zhvillimet ekonomike dhe industriale orientohen përgjatë korridoreve kryesore të transportit dhe nyjeve strategjike infrastrukturore. Një nga zonat kryesore funksionale është **boshti industrial-logjistik Prelez–Babush–Gërlicë**, ku favorizohen industria përpunuese, aktivitetet prodhuese, magazinimi, terminalët e mallrave, tregtia me shumicë dhe funksionet logjistike.

ZONAT BUJQËSORE DHE BREZI AGRO-PRODHUES

Tokat bujqësore me produktivitet të lartë trajtohen si resurs strategjik i komunës. PZHK synon ruajtjen e tyre nga konvertimi në përdorime të tjera dhe kufizimin e zgjerimit urban mbi këto sipërfaqe. Në konceptin ekonomik identifikohet **brezi agro-prodhues**, i cili përfshin kryesisht fushat veriore dhe perëndimore dhe vendbanimet fushore përreth qytetit, me orientim drejt prodhimit bujqësor, serave, fermave, grumbullimit dhe përpunimit të produkteve bujqësore.

ZONAT PYJORE, NATYRORE DHE UJORE

Sipërfaqet pyjore, rrjetet ujore, korridoret ekologjike dhe peizazhet natyrore trajtohen si resurse strategjike për zhvillimin afatgjatë. PZHK parashihet stabilizimin dhe rigjenerimin e sipërfaqeve pyjore, forcimin e mbrojtjes së korridoreve ekologjike dhe sipërfaqeve ujore, si dhe kufizimin e zhvillimeve që mund të cenojnë vlerat e larta natyrore.

ZONAT TURISTIKE DHE REKREATIVE

Pjesët jugore dhe perëndimore të komunës kanë rol të veçantë në zhvillimin e turizmit malor, natyror dhe rekreativ. Në konceptin funksional identifikohet **brezi turistik-malor Jezerc–Nerodime–Pleshinë–Burrnik–Rahovicë**, ku parashihen aktivitete të agroturizmit, bujtina, shtigje rekreative, gastronomi dhe aktivitete të lidhura me natyrën dhe ekonominë rurale.

Zhvillimi i këtyre zonave duhet të realizohet në mënyrë të kontrolluar, duke shmangur ndërtimin e shpërndarë dhe ndërhyrjet që mund të degradojnë peizazhin dhe resurset natyrore.

ZONA URBANE E DIJES, SHËRBIMEVE DHE FUNKSIONEVE PUBLIKE

Qendra urbane e Ferizajt përbën bërthamën kryesore të administratës, shërbimeve, arsimit, shëndetësisë, tregtisë dhe aktiviteteve të bazuara në ekonomi të dijes. Koncepti e identifikon këtë hapësirë si **bërthamë të dijes dhe shërbimeve**, ku zhvillohen funksione të teknologjisë, inovacionit, shërbimeve profesionale, financiare, arsimore dhe shëndetësore.

KORRIDORET E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS

Korridoret rrugore, hekurudhore dhe të infrastrukturës teknike përbëjnë skeletin kryesor të organizimit territorial. PZHK mbështet fuqizimin e korridorit veri–jug përgjatë autostradës dhe hekurudhës, si dhe korridorin lindje–perëndim, për të siguruar lidhjen e qendrës urbane, qendrave sekondare, zonave ekonomike dhe vendbanimeve rurale.

ZONAT E REZILIENCËS MJEDISORE DHE ENERGJETIKE

Koncepti identifikon gjithashtu një dimension të veçantë të infrastrukturës së reziliencës, që përfshin Sojeven, korridoret e utiliteteve, zonën e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura dhe korridoret ujore. Në këto hapësira lidhen funksionet e energjisë së ripërtëritshme dhe ruajtjes së energjisë, trajtimit të ujërave të ndotura, menaxhimit të mbeturinave dhe mbrojtjes së ujit dhe tokës.

Në kuadër të kësaj, PZHK parasheh funksionalizimin e impiantit për trajtimin e ujërave të ndotura në Ferizaj Jug, zgjerimin e kolektorëve dhe integrimin gradual të vendbanimeve në sistemin publik të trajtimit, si dhe zhvillimin e sistemeve të drenazhimit dhe menaxhimit të ujërave atmosferike.

ÇËSHTJE MJEDISORE QË LIDHEN ME MJEDISIN FIZIK

Zhvillimet e ardhshme duhen harmonizuar me kapacitetet mjedisore të territorit, duke shmangur presionin mbi tokat bujqësore, burimet ujore, zonat natyrore dhe zonat e ekspozuara ndaj rreziqeve natyrore.

- Mbrojtja e tokës bujqësore me potencial të lartë prodhues nga zgjerimi urban, zhvillimet ekonomike dhe ndryshimi i pakontrolluar i destinimit të tokës;
- Kufizimi i zhvillimeve në zonat me rrezik nga përmytjet, veçanërisht përgjatë lumit Nerodime, lumenjve Pleshina dhe Gaçka dhe kanalit Kosinë–Lubovc–Tërn, si dhe rehabilitimi i shtretërve, kanaleve kulluese dhe sistemeve të drenazhimit;
- Parandalimi i erozionit dhe degradimit të tokës, veçanërisht në zonat me pjerrësi dhe ndjeshmëri më të lartë në Jezerc, Nerodime, Manastirc, Pleshinë dhe Burrnik;
- Kontrolli i zhvillimeve në terrenet potencialisht të ndjeshme ndaj rrëshqitjeve, përmes vlerësimeve gjeoteknike, kontrollit të prerjeve dhe mbushjeve të terrenit dhe masave për stabilizimin e shpateve;
- Mbrojtja e lumenjve, përrenjve, burimeve dhe zonave ujëmbledhëse, përmes brezave mbrojtës dhe kufizimit të ndërtimeve e aktiviteteve ndotëse në afërsi të tyre;
- Parandalimi i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, përmes trajtimit të ujërave të zeza, paratrajtimit të ujërave industriale dhe kontrollit të shkarkimeve;
- Mbrojtja e sipërfaqeve pyjore, habitateve dhe korridoreve ekologjike nga fragmentimi, ndërtimet e pakontrolluara, prerjet ilegale dhe aktivitetet që cenojnë biodiversitetin;
- Rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara nga ndërtimet, nxjerrja e materialeve, erozioni dhe përdorimet e papërshtatshme të tokës;
- Integrimi i rrezikut sizmik në zhvillimet urbane dhe infrastrukturore, duke zbatuar kriteret dhe standardet përkatëse të ndërtimit antisizmik;
- Integrimi i mbrojtjes nga zjarret në planifikimin hapësinor, veçanërisht në zonat bujqësore, rurale, periferike dhe pyjore të ndjeshme;
- Shmangia e zhvillimeve të papërshtatshme në zonat e mbrojtura dhe me ndjeshmëri të lartë mjedisore, duke ruajtur lidhjen funksionale ndërmjet pyjeve, lumenjve, tokave bujqësore dhe hapësirave të gjelbra.

ÇËSHTJE MJEDISORE QË LIDHEN ME BIODIVERSITETIN, FLORËN DHE FAUNËN

- Ruajtja e habitateve natyrore dhe korridoreve ekologjike, veçanërisht në zonat pyjore, malore dhe përgjatë rrjedhave ujore;
- Shmangia dhe kufizimi i fragmentimit të habitateve nga zhvillimet urbane, infrastrukturore, ekonomike dhe turistike;
- Ruajtja e lidhshmërisë ekologjike ndërmjet pyjeve, lumenjve, tokave bujqësore dhe hapësirave të gjelbra;
- Mbrojtja e zonave me vlera të larta natyrore dhe biodiversitet, duke kufizuar ndërhyrjet që mund të cenojnë funksionet ekologjike të tyre;
- Integrimi i kriterëve për mbrojtjen e biodiversitetit gjatë planifikimit dhe realizimit të infrastrukturës, zonave ekonomike dhe zhvillimeve turistike;
- Rehabilitimi dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara, me qëllim rikthimin e funksioneve ekologjike dhe përmirësimin e vazhdimësisë së habitateve.

PLANIFIKIMI I PËRDORIMIT TË TOKËS DHE ÇËSHTJE TË SIGURIMIT TË SHËRBIMEVE

- Prioritizimi i plotësimit dhe densifikimit të zonave ekzistuese të urbanizuara përpara zgjerimit në sipërfaqe të reja;
- Orientimi i zonave të rritjes në hapësira me infrastrukturë dhe qasje të përshtatshme në shërbime, duke kufizuar zhvillimin në zona me kapacitete të pamjaftueshme;
- Kushtëzimi i zgjerimeve të reja urbane me kapacitetet e infrastrukturës teknike dhe sociale, si dhe me nevojat reale demografike dhe ekonomike;
- Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm me ujë, kanalizimit dhe drenazhimit për zonat e reja të banimit, qendrat e zhvillimit dhe korridoret strategjike;
- Paraprirja e zhvillimit me investime infrastrukturore në zonat ku kapacitetet ekzistuese janë të pamjaftueshme;
- Sigurimi i infrastrukturës së përshtatshme në zonat ekonomike dhe industriale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe paratrajtimin e ujërave industriale;
- Fuqizimi i qendrës urbane dhe qendrave sekondare si pole për ofrimin e shërbimeve publike, sociale dhe ekonomike, me qëllim shpërndarjen më të balancuar të funksioneve në territor;
- Përmirësimi i qasjes në transport publik, mobilitet aktiv dhe rrjetin rrugor;
- Sigurimi i hapësirave publike, gjelbërimit dhe infrastrukturës sociale në zhvillimet e reja;
- Kufizimi i zhvillimeve lineare dhe të shpërndara, veçanërisht përgjatë korridoreve rrugore dhe në tokat bujqësore periferike, për të reduktuar kostot infrastrukturore dhe fragmentimin e territorit.

RREZIQET NATYRORE NË MJEDISIN FIZIK

- **Përmbytjet** paraqesin një nga rreziqet kryesore, veçanërisht përgjatë pellgut të lumit Nerodime, lumenjve Pleshina dhe Gaçka dhe sistemit të kanaleve kulluese. Zonat e Gurrëzës dhe Tërnit evidentohen me nivel më të lartë të rrezikut, ndërsa historikisht janë prekur edhe Nerodimja, Balaj, Nikadini, Varoshi dhe pjesë të zonës urbane.
- **Erozioni** paraqitet kryesisht në pjesët perëndimore dhe lindore të komunës, ku pjerrësia e terrenit, reduktimi i mbulesës bimore dhe ndërhyrjet antropogjene rrisin ndjeshmërinë e tokës. Zonat me shkallë të lartë të erozionit përbëjnë rreth 19% të territorit.
- **Rrëshqitjet** e tokës nuk paraqiten si rrezik i madh në shkallë komunale, por ekziston potencial për raste lokale në zona me ndërhyrje ndërtimore, gërmime, prerje dhe mbushje të terrenit. Për këto zona kërkohet integrimi i kriterëve gjeoteknike dhe masave për stabilizimin e shpateve.
- **Rreziku sizmik** duhet të konsiderohet në të gjitha zhvillimet ndërtimore dhe infrastrukturore. Vlerësimet e PZHK-së tregojnë intensitet maksimal deri në VIII–IX° MSK-64 për territorin e Ferizajt, duke kërkuar respektimin e standardeve dhe kodeve sizmike në projektim dhe ndërtim.
- **Zjarret** paraqiten kryesisht në zonat bujqësore, rurale dhe periferike dhe karakterizohen si rrezik i lokalizuar me intensitet të ulët deri mesatar. Planifikimi duhet të përfshijë identifikimin e zonave me rrezik sezonal, menaxhimin e mbulesës bimore, krijimin e brezave mbrojtës dhe kufizimin e djegieve të hapura.

7. PARIME, OBJEKTIVA DHE KRITERE MJEDISORE

7.1. OBJEKTIVAT E VSM

Duke u bazuar në qëllimin e VSM-së, që përkon edhe me qëllimin e mbrojtjes mjedisore të vetë PZHK-së së Komunës së Ferizajt, janë përcaktuar objektivat mjedisore të VSM-së. Objektivat mjedisore qëndrojnë po njëjloj për planet e niveleve tjera. Për më tepër, këto objektiva janë ndërtuar në përputhje me politikat e strategjitë mjedisore kombëtare, me Planin Hapësinor të Kosovës, si dhe me qëndrimet e sektorëve përkatës (që preken nga objektivat). Për çdo objektiv janë listuar ndikimet e mundshme të Planit në mjedis, nëse objektivi nuk realizohet, pra nëse nuk merren masat zbutëse, eliminuese apo parandaluese të dëmit mjedisor.

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva primare apo globale dhe në objektiva lokale.

Vlerësimi realizohet për secilën nga Objektivat Mjedisore të listuara më poshtë:

Objektivi Mjedisor 1 (OM1) – Ajri:

Reduktimi i emetimeve të gazrave serrë (p.sh., duke promovuar çiklizmin dhe përmbushja e standardeve të Bashkimit Evropian);

Objektivi Mjedisor 2 (OM2) – Uji:

Përmirësimi, ruajtja e cilësisë së ujit, zbutja, kufizimi dhe parandalimi i efekteve negative të aktivitetit njerëzor në territorin, përmirësimi ruajtja e aftësisë për të deponuar ujin, minimizimi i përdorimit të panevojshëm të ujit;

Objektivi Mjedisor 3 (OM3) – Toka:

Mbrojtja dhe përdorimi e manaxhimi i qëndrueshëm i tokës, parandalimi i erozionit të tokës, ruajtja e kapacitetit prodhues të tokës (kullosave);

Objektivi Mjedisor 4 (OM4) – Biodiversiteti:

Mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i biodiversitetit, ruajtja e specieve organike dhe habitateve në funksion të ruajtjes së ekosistemeve, veçanërisht specieve endemike dhe endemo-relikte të rralla dhe të kërcënuara;

Objektivi Mjedisor 5 (OM5) – Pyjet:

Menaxhimi i qëndrueshëm i pyjeve në funksion të garantimit të aftësisë vetë-ripërtëritëse të ekosistemit pyjor, zbutjes së efekteve të ndryshimeve klimatike;

Objektivi Mjedisor 6 (OM6) – Peizazhi dhe Ekosistemet:

Revitalizimi i ekosistemeve dhe peizazheve të prekura nga aktivitetet njerëzore, ruajtja e karakteristikave të dallueshme të peizazhit dhe pamjeve, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 7 (OM7) – Ndryshimet klimatike:

Ndërtimi i infrastrukturës për të mos kontribuar në ndryshimet klimatike, reduktimi i emetimeve të gazrave sere duke promovuar mobilitetin urban, çiklizmin dhe ecjen;

Objektivi Mjedisor 8 (OM8) – Trashëgimia kulturore:

Konservimi e restaurimi, ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe arkitekturore, duke përfshirë traditat lokale;

Objektivi Mjedisor 9 (OM9) – Shëndeti:

Përmirësimi i shëndetit të popullatës njerëzore, garantimi i zhvillimit social dhe ekonomik në harmoni me mjedisin dhe burimet natyrore dhe ulja e ekspozimit ndaj rrezikut natyror;

Objektivi Mjedisor 10 (OM10) – Social-ekonomik:

Përmirësimi i mirëqenies sociale dhe ekonomike të komunitetit në përputhje me qëllimet e mbrojtjes së mjedisit, duke përfshirë zhvillimin e projekteve dhe politikave të qëndrueshme, rritjen e përfitimeve të komunitetit nga burimet natyrore, dhe promovimin e përdorimit të teknologjive mjedisore në prodhim dhe konsum;

Objektivat e mësipërme synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë (rritjen e sigurisë, ofrimin e mundësive për mënyrë aktive jetese, shtimin i sipërfaqeve të gjelbra, përmirësimin i cilësisë së ajrit, etj.). Ato duhen shoqëruar me veprime operacionale konkrete që çojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të planit.

Ndër të tjera, PZHK duhet të zbatojë disa parime dhe modele zhvillimi të pranuar gjerësisht, si Parimi i Subsidiaritetit që konsiston në ofrimin e shërbimeve publike, infrastrukturore, sociale dhe mjedisore sa më afër qytetarit, duke ndikuar drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së jetës, reduktimin e kostove të qasjes në shërbime dhe promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm territorial.

7.2. PARIME, OBJEKTIVA E KRITERE MJEDISORE QË KUFIZOJNË ZHVILLIMIN KOMUNAL

Ky kapitull paraqet parimet për planifikimin hapësinor të qëndrueshëm, objektivat strategjike dhe veprime operacionale në kuadër të hartimit të PZHK-së. Më tej paraqiten edhe kriteret mjedisore që kufizojnë zhvillimin komunal në vendbanime të ndryshme të komunës dhe pjesë të caktuara të qytetit.

Parimet e përgjithshme të planifikimit hapësinor

Parimet e përgjithshme për planifikimin hapësinor janë një tërësi rregullash të bazuara mbi eksperiencat ndërkombëtare, të cilat shkurtimisht mund të përmbledhen si më poshtë:

- Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm;
- Parandalimi i ndikimit të dëmshëm në mjedisin natyror;
- Ruajtja e tipareve karakteristike natyrore, peizazhore, të florës e faunës;
- Zhvillim ekologjikisht i shëndetshëm, ruajtje e korridoreve ekologjike për të garantuar mbrojtjen e habitateve dhe komunikimin e habitateve mes veti;
- Marrja e masave parandaluese dhe rigjenerimi i mjediseve natyrore;
- Përfshirja e parimeve të tilla si „ndotësi paguan” ose „përdoruesi paguan”;
- Përdorimi i teknikave dhe metodave më të mira për mbrojtjen e mjedisit;
- Përdorimi i teknologjisë më të mirë të disponueshme bazuar në ndikimin minimal, ndërtimin pa ndotje dhe përgatitjen e sheshit;
- Informimi i publikut, përfshirja e komunitetit në vendimmarrje dhe akses i publikut në informacion; dhe
- Bashkëpunim ndërkombëtar.

Në kuadër të hartimit të PZHK-së, parimet e mësipërme përkthehen në përparësitë e mëposhtme (siç janë paraqitur edhe në këtë material):

- Densifikim përpara shtrirjes – kjo ka për qëllim përdorimin e tokës në vendbanime në mënyrë më efektive dhe ngadalësimin e shpërndarjes së disa vendbanimeve përtej kufijve të planifikuar;
- Strukturimi dhe ristrukturimi i zhvillimit koherent të vendbanimeve – kjo synon kryesisht të krijojë një përdorim më efektiv të tokës;
- Krijimi i rrugëve të reja brenda strukturës së vendbanimeve – akses i nëpër vendbanime dhe komuna fqinje është një faktor madhor për udhëheqjen e zhvillimit;
- Rehabilitimi i tokës bujqësore;
- Ri-zhvillimi i pyjeve ekzistuese, pyllëzime të reja;
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore – historike dhe natyrore;
- Ruajtja e shumëllojshmërisë së aktiviteteve dhe përdorimeve nëpër vendbanime;
- Zgjerimi i zonave të banimit atje ku kushtet janë të favorshme.

7.3. QËLLIMET STRATEGJIKE

Sipas rëndësisë së tyre, objektivat mund të ndahen në objektiva globale dhe në objektiva të nivelit lokal. Objektivat kryesore të shqyrtimit të gjerë që lidhen me këtë plan mund të definojnë si:

- Zhvillimi i përmirësuar, ku të gjithë aktorët kanë të drejtën për informacion, të dëgjohen, të ndikojnë dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes, me ndikim në jetën dhe të ardhmen e tyre. Një nga qëllimet globale është se gjatë zhvillimit dhe implementimit të këtij dokumenti ne kemi pjesëmarrje të cilësisë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm, i shpejtë e intensiv dhe ndryshimet në strukturën socio-ekonomik, përfshijnë zhvillimin e barabartë në kuadër të komunës;
- Për të krijuar kushte për një rritje të përhershme në punësim, zhdukjen e varfërisë, luftimin e sëmundjeve, përmirësimin e shëndetit dhe reduktimin e vdekshmërisë së fëmijëve në bazë të standardeve që do të ofrojnë qëllimet themelore të ndryshimit në strukturën sociale-ekonomike, zhvillimi dinamik i ekonomisë dhe nivelit të jetës dhe forcimin e rolit të sektorit privat në socio-zhvillimin ekonomik;
- Rritja e vazhdueshme e sigurisë në të gjitha dimensionet (krijimi i sigurisë për edukim themelor, siguri sociale dhe fizike, siguri të mjedisit etj.);
- Zhvillimi i partneritetit global për zhvillim.

Qëllimet strategjike të mësipërme synojnë të sigurojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe të drejtën për informim për të gjithë aktorët e interesuar, duke u mundësuar atyre të ndikojnë në procesin e vendimmarrjes dhe të kenë rol aktiv në përcaktimin e të ardhmes së tyre. Fokusi vihet në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe në ndryshimet në strukturën sociale dhe ekonomike, duke përfshirë zhvillimin e balancuar në nivel komunal për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme dhe të drejtë për të gjithë banorët.

Qëllimet hartohen në përpjekje për të krijuar kushte për përmbushjen e nevojave themelore, duke garantuar qasje të barabartë në shërbimet dhe burimet e nevojshme. Gjithashtu, ato synojnë sigurimin e kushteve për edukim, siguri sociale dhe fizike, si dhe siguri mjedisore, në funksion të krijimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt.

PZHK parashikon një qasje integrale për zhvillimin e territorit të Komunës së Ferizajt, duke u bazuar në konceptin e zhvillimit kompakt, policentrik dhe funksionalisht të integruar. Dokumenti orienton zhvillimin e ardhshëm drejt konsolidimit dhe densifikimit të strukturave ekzistuese, fuqizimit të qendrës urbane dhe qendrave sekondare, zhvillimit të korridoreve strategjike dhe përdorimit racional të tokës, duke harmonizuar nevojat për zhvillim ekonomik dhe infrastrukturor me mbrojtjen e tokës bujqësore dhe resurseve natyrore.

Duke qenë se PZHK përcakton orientimet strategjike dhe hapësinore për zhvillimin e tërë territorit komunal, për zona të caktuara zhvillimore do të jetë i nevojshëm specifikimi i mëtejshëm përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRRH). Kjo është veçanërisht relevante për zonat urbane, qendrat sekondare, zonat e rritjes dhe hapësirat që kërkojnë ristrukturim ose zhvillim të ri, ku duhet të përcaktohen më hollësisht përdorimi i tokës, intensiteti i ndërtimit, infrastruktura, hapësirat publike dhe kushtet mjedisore. Vetë PZHK evidenton se zonat urbane dhe qendrat sekondare mund të kërkojnë hartimin e PRRH-ve.

Në zonën urbane, zhvillimi duhet të orientohet fillimisht drejt plotësimit të hapësirave të lira, kompaktësimit të strukturës ekzistuese dhe densifikimit të kontrolluar. Zgjerimi në sipërfaqe të reja duhet

të realizohet vetëm pas vlerësimit të rezervave të brendshme zhvillimore, nevojave reale demografike dhe ekonomike dhe kapaciteteve të infrastrukturës teknike dhe sociale. Kjo qasje synon njëkohësisht kontrollin e kufirit urban dhe parandalimin e shtrirjes së pakontrolluar drejt tokave bujqësore dhe vendbanimeve përreth.

PZHK-ja synon menaxhimin racional dhe të qëndrueshëm të tokës në të gjithë territorin komunal, duke përfshirë zonat e reja të banimit, zonat ekonomike dhe industriale, korridoret infrastrukturore, zonat turistike dhe rekreative, si dhe sipërfaqet natyrore dhe të gjelbra. Nga aspekti i VSM-së, rëndësi të veçantë ka që zhvillimet e ardhshme të mos shkaktojnë fragmentim të habitateve dhe korridoreve ekologjike, humbje të tokës bujqësore, degradim të pyjeve apo ndërprerje të lidhjeve funksionale ndërmjet sistemeve natyrore.

Në këtë drejtim, duhet të sigurohet ruajtja dhe përmirësimi i habitateve natyrore, pyjeve dhe korridoreve ekologjike, si dhe lidhshmëria ndërmjet zonave urbane dhe rurale. Veçanërisht të rëndësishme janë sistemi ekologjik i lumit Nerodime dhe Bifurkacionit, zonat pyjore dhe malore të Jezercit, Burrnikut dhe Pleshinës, si dhe sipërfaqet e tjera natyrore që krijojnë vazhdimësi ekologjike në territor. PZHK-ja parashikon mbrojtjen e korridoreve ekologjike, sipërfaqeve ujore dhe zonave me vlera të larta natyrore, si dhe stabilizimin dhe rigjenerimin e sipërfaqeve pyjore.

Rëndësi të veçantë ka edhe harmonizimi i zhvillimeve industriale, ekonomike dhe infrastrukturore me kapacitetet mjedisore të territorit. Zonat ekonomike duhet të konsolidohen në korridoret e përcaktuara zhvillimore dhe në hapësira me infrastrukturë të përshtatshme, duke minimizuar ndikimin në tokën bujqësore, ujërat, habitatet natyrore dhe zonat ekologjike të ndjeshme.

Si konkludim, për përmbushjen e qëllimeve strategjike të përcaktuara është e nevojshme të zbatohen parimet e zhvillimit të qëndrueshëm hapësinor, duke u mbështetur në konceptin e zhvillimit kompakt dhe policentrik, siç parashihet edhe në PZHK. Përqendrimi i zhvillimeve në zonat ekzistuese dhe në qendrat e përcaktuara mundëson shfrytëzim më efikas të infrastrukturës, ul nevojën për zgjerim të pakontrolluar dhe kontribuon në mbrojtjen e natyrës dhe tokës bujqësore. Vetë skenari i përzgjedhur nga PZHK-ja e vlerëson këtë model si më miqësor ndaj mjedisit dhe si mundësi për mbrojtjen e tokës bujqësore dhe zhvillimin e balancuar të territorit.

Në mënyrë të përmbledhur, objektivat për mbrojtjen e mjedisit në kuadër të planit mund të përmbledhen si më poshtë:

- Përmirësimi i menaxhimit të mbeturinave, eliminimi dhe parandalimi i deponive ilegale, si dhe zhvillimi i riciklimit, kompostimit dhe ekonomisë qarkore;
- Mbrojtja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
- Përmirësimi i menaxhimit dhe trajtimit të ujërave të zeza;
- Ruajtja e tokave bujqësore me produktivitet të lartë dhe kufizimi i konvertimit të tyre;
- Parandalimi i degradimit dhe ndotjes së tokës, rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara dhe menaxhimi i qëndrueshëm i përdorimit të pesticideve, herbicideve dhe plehrave kimike;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit;
- Zvogëlimi i ndotjes akustike, veçanërisht në zonën urbane, përgjatë korridoreve kryesore të transportit dhe pranë zonave ekonomike;
- Rritja e efikasitetit energjetik dhe promovimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- Ruajtja dhe zhvillimi i sipërfaqeve të gjelbra, pyjeve, habitateve natyrore dhe korridoreve ekologjike;
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe ekosistemeve;

- Mbrojtja nga përmbytjet dhe reduktimi i erozionit, si dhe menaxhimi i rrëshqitjeve lokale, zjarreve dhe rreziqeve të tjera natyrore;
- Integrimi i adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në planifikimin hapësinor;
- Identifikimi, monitorimi dhe rehabilitimi i zonave me presion të lartë mjedisor dhe hotspoteve potenciale;
- Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, natyrore, historike dhe peizazhore;
- Përmirësimi i monitorimit të parametrave mjedisorë;
- Integrimi i kriterëve mjedisorë në zhvillimet e ardhshme urbane, ekonomike, turistike dhe infrastrukturore.

PIKAT E FORTA TË STRATEGJISË SË ZHVILLIMIT

Në qendër të strategjisë së zhvillimit të Komunës së Ferizajt është koncepti i **zhvillimit kompakt, policentrik dhe funksionalisht të integruar**, i cili synon balancimin ndërmjet zhvillimit ekonomik, urban dhe infrastrukturor, mbrojtjes së mjedisit dhe përmirësimit të cilësisë së jetesës. Fuqizimi i qendrës urbane dhe qendrave sekondare mundëson shpërndarje më të balancuar të aktiviteteve, shërbimeve dhe investimeve në territor.

Një nga pikat kryesore të forta është orientimi i zhvillimit drejt **plotësimit, kompaktësimit dhe densifikimit të strukturave ekzistuese**, duke reduktuar zgjerimin e pakontrolluar dhe presionin mbi tokën bujqësore dhe resurset natyrore.

Strategjia orienton zhvillimet ekonomike dhe industriale drejt zonave dhe korridoreve të përcaktuara, ndërsa njëkohësisht integron mbrojtjen e resurseve ujore, pyjeve, biodiversitetit, menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet, rehabilitimin e zonave të degraduara dhe adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve, plani:

- mundëson përdorim më efikas të tokës dhe infrastrukturës;
- përmirëson shpërndarjen territoriale të shërbimeve dhe funksioneve publike;
- lidh zhvillimet e reja me kapacitetet infrastrukturore;
- mbron tokën bujqësore, ujërat, pyjet dhe korridoret ekologjike;
- promovon mobilitetin e qëndrueshëm, energjinë e ripërtëritshme dhe reziliencën klimatike.

7.4. PËRMIRËSIMI I MJEDISIT, CILËSIA, OFRIMI I SHËRBIMEVE, DHE EFIÇENCA E ENERGJISË

Strategjitë e zhvillimit të komunave në të shkuarën, kishin prirje t'i trajtonin çështjet e mjedisit si 'shtojca' të strategjive, pa u kushtuar vëmendjen që këto kanë sot. Ky vlerësim strategjik mjedisor vlerëson tendencën e strategjisë së planit për të marrë parasysh ndikimet e prodhimit urban dhe konsumit përtej kufinjve të zonës urbane, minimizimin e ndikimit mbi sipërfaqet e gjelbra, tokën pjellore, lumenjtë, biodiversitetin, ndryshimin e klimës, etj. Është e rëndësishme që plani të marrë në konsideratë çështje dhe formulojë strategji specifike në tri fusha për të përmirësuar performancën mjedisore:

- Cilësia e mjedisit
- Cilësia e ofrimit të shërbimeve
- Efiçenca e energjisë

Lidhur me këto tri fusha, me theks të veçantë cilësia e mjedisit, përcaktohen kritere të cilat duhen respektuar me qëllim ruajtjen e mjedisit të komunës.

KRITERET E FORTA MJEDISORE

Këto kritere përcaktojnë hapësirat dhe resurset që kërkojnë mbrojtje të veçantë gjatë zhvillimit të territorit.

(I) Zonat me ndjeshmëri të veçantë mjedisore përfshijnë:

- lumenj Nerodime, Bifurkacionin dhe rrjetin e burimeve e rrjedhave ujore;
- burimet ujore dhe zonat me rëndësi për mbrojtjen e ujërave nëntokësore;
- tokat bujqësore me produktivitet të lartë;
- sipërfaqet pyjore dhe habitatet natyrore;
- korridoret ekologjike dhe zonat që sigurojnë lidhshmërinë ndërmjet pyjeve, lumenjve, tokave bujqësore dhe hapësirave të gjelbra;
- monumentet natyrore dhe zonat me vlera të larta peizazhore.

Në këto zona, zhvillimet duhet të planifikohen në mënyrë që të shmangen ndikimet që mund të shkaktojnë degradimin e tyre.

(II) Zonat me kufizime për zhvillim përfshijnë:

- shtretërit e lumenjve dhe brezat mbrojtës përgjatë tyre;
- zonat e ekspozuara ndaj përmytjeve;
- zonat me shkallë të lartë të erozionit;
- terrenet me potencial për rrëshqitje lokale dhe pjerrësi të theksuar;
- tokat bujqësore me vlerë të lartë prodhuese;
- zonat e mbrojtura natyrore, kulturore dhe arkeologjike.

Në këto zona duhet të shmangen zhvillimet që mund të rrisin ekspozimin ndaj rrezikut, të ndryshojnë regjimin hidrologjik, të destabilizojnë terrenin ose të shkaktojnë humbje të resurseve me vlerë të lartë.

Nuk lejohen ndërtimet në (apo pranë) shtretërve të lumenjve pasi ndërtimet mund të jenë në zonën e përmytjeve, mund të shkaktojnë erozion të brigitëve, si dhe të cenojnë regjimin hidrologjik të sistemit ujor.

Tokat bujqësore janë të rëndësishme për prodhimin bujqësor dhe si të tilla, ndërhyrjet e paplanifikuara dhe praktikat bujqësore jo-të qëndrueshme rrezikojnë të shkaktojnë ndotje të rënda të burimeve ujore nëntokësore dhe degradimin e tokës.

Në mënyrë të ngjashme, nuk lejohen ndërtimet në zonat vulnerabël ndaj proceseve të erozionit dhe rrëshqitjeve dhe janë një rrezik publik i përhershëm. Plani përmban “hartën e planifikuar për mbrojtjen nga rreziqet natyrore”.

(III) Zonat me presione mjedisore ekzistuese

Në territorin e Komunës së Ferizajt nuk janë identifikuar hotspote të kategorizuara zyrtarisht, por PZHK evidenton zona me presion të lartë mjedisor dhe potencial për t'u trajtuar si hotspote. Këtu përfshihen:

- segmentet urbane dhe të poshtme të lumit Nerodime;
- zona përreth deponisë tranzite në Gërlicë;
- zonat me përqendrim të aktiviteteve industriale dhe ekonomike me potencial ndotës.

Këto hapësira kërkojnë monitorim të vazhdueshëm, kontroll të burimeve të ndotjes dhe masa rehabilituese e rikultivuese, me qëllim parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të gjendjes së mjedisit.

8. NDIKIMET E MUNDSHME MJEDISORE DHE MASAT PËR ZBUTJEN E TYRE

8.1 METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E SHKALLËS SË NDIKIMEVE

Për parashikimin e karakteristikave të shkallës së ndikimeve, janë përdorur metoda të ndryshme, duke përfshirë vëzhgimet e thjeshta, ilustrime fizike, informacione sasiore, etj. Identifikimi i ndikimeve mjedisore është zhvilluar përmes metodave që përfshijnë listat e kontrollit, matricat, rrjetet dhe diagrama, GIS dhe gjykime profesionale.

Para përshkrimit të ndikimeve në mjedis, janë analizuar të gjitha zhvillimet e planifikuara sipas planit. Gjatë hartimit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor të Planit Zhvillimor Komunal të Ferizajt, me theks të veçantë janë përfshirë këta komponentë mjedisorë:

Identifikimi i efekteve/ndryshimeve për elementet e mëposhtme:		
Uji	Sipërfaqësor	Shkarkime të substancave toksike, inorganike, organike, etj
	Nëntokësor	Filtrime drejt ujërave nëntokësorë
Ajri		Emetimet në ajër që ndikojnë në cilësinë e ajrit
Klima		Emetimet e gazrave me efekt serrë
Toka		Erozioni dhe sedimentimi
Zhurmat		Emetimet e mundshme të zhurmës
Flora, fauna, habitat		Ndikimet e zhvillimeve të propozuara mbi florën, faunën dhe ç'rregullimin e habitateve
Peizazhi		Ndryshime thelbësore të formës së përdorimit të tokës p.sh. shpyllëzim, urbanizim, etj.
Mbeturinat		Depozitimi, djegia dhe riciklimi
Vlera të trashëgimisë natyrore e kulturore		Asete të cilat mund të dëmtohen nga aktivitetet e propozuara

Tabela 2 Komponentët mjedisor të parapara në raportin e VSM

Vlerësimi i ndikimeve mjedisore të Planit Zhvillimor Komunal për Ferizajn është realizuar në përputhje me qasjet e rekomanduara ndërkombëtarisht për Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Për të arritur këtë, është

përdorur një metodologji që synon të identifikojë, analizojë, dhe vlerësojë ndikimet e mundshme mjedisore të zhvillimeve të propozuara në plan.

8.2 PËRCAKTIMI I INDIKATORËVE DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Indikatorët mjedisorë janë përcaktuar për të vlerësuar ndikimet e ndryshme të zhvillimeve të planifikuara në tokë, ujë, ajër, biodiversitet, klimë, mbeturina, zhurmë, peizazh, dhe trashëgimi kulturore. Për secilin indikatorë, janë përdorur kriteret e vlerësimit si mëposhtë:

A

Pa ndikim/ndikim pozitiv:

Zhvillimet e planifikuara nuk kanë ndikim negativ ose kontribuojnë pozitivisht ndaj qëllimeve mjedisore.

B

Ndikim i parëndësishëm:

Ndikimet janë të vogla dhe nuk pritet të kenë efekte të ndjeshme afatgjate.

C

Ndikimi bëhet i parëndësishëm për shkak të zbatimit të masave zbutëse:

Ndikimet potencialisht negative mund të zbuten efektivisht përmes zbatimit të masave të përshtatshme.

D

Ndikim i rëndësishëm:

Ndikimet janë të mëdha dhe mund të kenë efekte të konsiderueshme negative mjedisore që kërkojnë veprime të mëtejshme për menaxhimin e tyre.

E

Ndikim shkatërrues:

Ndikimet janë aq të mëdha sa që mund të dëmtojnë seriozisht mjedisin ose të çenojnë qëndrueshmërinë e zonave të caktuara.

X

Vlerësimi i ndikimit nuk është i mundur:

Nuk ka mjaftueshëm të dhëna për të bërë një vlerësim të qartë ose ndikimi është shumë kompleks për të vlerësuar në këtë fazë.

8.3 ANALIZA E NDIKIMEVE

Indikator	Zhvillimi i planifikuar	Përshkrimi i ndikimit	Shkalla e vlerësimit	Masa zbutëse
Uji	Ndërtimi dhe funksionalizimi i ITUZ, zgjerimi i kolektorëve dhe rrjetit të kanalizimit	Reduktim i ndjeshëm i shkarkimeve të patrajtuara dhe përmirësim i cilësisë së lumit Nerodime dhe receptorëve të tjerë ujorë.	A	Funksionalizimi i plotë i ITUZ; zgjerimi i kolektorëve; monitorimi i cilësisë së ujit dhe kontrolli i shkarkimeve.
	Ndarja e rrjetit fekal nga ai atmosferik dhe përmirësimi i drenazhimit	Reduktim i mbingarkesës së kanalizimit dhe rrezikut nga përmbytjet urbane; përmirësim i menaxhimit të ujërave atmosferike.	A	Zgjerimi i drenazhimit, mirëmbajtja e kanaleve dhe përdorimi i sistemeve të qëndrueshme për ujërat atmosferike.
	Zhvillimi i zonave industriale dhe ekonomike në Prelez–Babush–Gërllicë	Rritje potenciale e konsumit të ujit dhe e shkarkimeve industriale, me rrezik për ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore.	C	Kanalizim industrial, paratrajtim i detyrueshëm i ujërave industriale, monitorim dhe kontroll i shkarkimeve. PZHK e parashikon paratrajtimin si pjesë të infrastrukturës së zonave ekonomike.
Ajri	Zhvillimi industrial, ekonomik, logjistik dhe aktivitetet ndërtimore	Potencial për rritje të emetimeve, pluhurit dhe ndotësve nga industria, transporti i mallrave dhe fazat e ndërtimit.	C	Breza të gjelbër tampon, kontroll i pluhurit dhe emetimeve, standarde mjedisore për operatorët dhe monitorim lokal i cilësisë së ajrit.
	Zhvillimi i transportit publik dhe mobilitetit të qëndrueshëm	Mundësi për reduktimin afatgjatë të varësisë nga automjetet private, emetimeve dhe ngarkesës së trafikut në zonën urbane. PZHK përcakton transportin publik dhe mobilitetin e qëndrueshëm si prioritet.	A/B	Prioritizimi i transportit publik, ecjes dhe çiklizmit dhe integrimi i tyre me qendrat e zhvillimit.
Klima / Energjia	Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme, PV dhe përmirësimi i efijencës energjetike	Reduktim potencial i përdorimit të burimeve konvencionale dhe emetimeve të gazeve serrë; rritje e sigurisë dhe qëndrueshmërisë energjetike.	A	Përzgjedhje e përshtatshme e lokacioneve, shmangie e tokave me vlerë të lartë natyrore dhe bujqësore dhe zbatim i standardeve mjedisore.
Toka	Zhvillimi kompakt, policentrik, plotësimi dhe densifikimi i vendbanimeve	Reduktim i presionit për zgjerim horizontal, përdorim më efikas i tokës dhe mbrojtje e tokave bujqësore me produktivitet të lartë.	A	Prioritet densifikimit dhe plotësimit para zgjerimit; respektim i kufijve ndërtimorë.
	Zhvillimi dhe konsolidimi i zonave industriale dhe logjistike	Mundësi për konvertim të tokës, rritje të sipërfaqeve të papërkshueshme dhe ndotje lokale të tokës, veçanërisht në rast të zhvillimit pa infrastrukturë adekuate.	C	Përqendrim në zonat e përcaktuara, menaxhim i ujërave atmosferike, kontroll i ndotjes dhe shmangie e tokave bujqësore cilësore.
Toka / Peizazhi / Biodiversiteti	Zhvillimi i kontrolluar i aktivitetëve nxjerrëse dhe përpunimit të materialeve minerale e ndërtimore	Mund të shkaktojë degradim të tokës, ndryshim të relievit dhe peizazhit, pluhur, zhurmë dhe humbje lokale të habitateve. PZHK parasheh krijimin e kushteve për zhvillimin e aktivitetëve nxjerrëse në zona të përshtatshme.	D	Përrjashtim i zonave të mbrojtura, pyjeve, tokave bujqësore cilësore dhe resurseve ujore; VNM sipas kërkesave ligjore; rehabilitim dhe rikultivim pas shfrytëzimit.
Flora, fauna dhe habitatet	Mbrojtja e pyjeve, korridoreve ekologjike dhe kapitalit natyror	Përmirësim i lidhshmërisë ekologjike, mbrojtje e habitateve dhe reduktim i fragmentimit të sistemeve natyrore. PZHK trajton pyjet, Nerodimen, tokat në mbrojtje dhe peizazhet natyrore si elemente strategjike.	A	Ruajtja e vegetacionit, ripyllëzimi, mbrojtja e korridoreve ekologjike dhe kontrolli i ndërtimeve në zonat e ndjeshme.
	Zhvillimi i brezit turistik-malor Jezerc–Nerodime–Pleshinë–Burnnik–Rahovicë	Potencial për presion mbi habitatet, vegetacionin dhe faunën nga ndërtimet, shtigjet, trafiku dhe rritja e numrit të vizitorëve.	B/C	Zhvillim me intensitet të kontrolluar, shmangie e ndërtimeve të shpërndara, menaxhim i vizitorëve dhe ruajtje e habitateve e korridoreve ekologjike.
Peizazhi	Zhvillimi kompakt dhe krijimi i korridoreve të gjelbra	Përmirësim i organizimit hapësinor, reduktim i fragmentimit dhe ruajtje më e mirë e peizazhit urban e rural.	A/B	Integrimi i infrastrukturës së gjelbër dhe ruajtja e elementeve karakteristike të peizazhit.
	Zonat industriale, logjistike dhe korridoret e reja zhvillimore	Ndryshim i karakterit vizual të territorit dhe potencial për fragmentim të peizazhit, veçanërisht në zonat periferike dhe rurale.	C	Kritere të projektimit, breza tampon të gjelbër, kontroll i lartësisë dhe volumit të objekteve dhe rehabilitim peizazhor.
Mbeturinat	Zhvillimi i sistemit të menaxhimit të mbeturinave, riciklimit dhe kompostimit	Reduktim i deponimit të pakontrolluar, ndotjes së tokës dhe ujërave dhe përmirësim i menaxhimit të resurseve. PZHK parashikon pastrimin e deponive ilegale, kompostimin,	A	Zgjerimi i mbulimit me shërbim, eliminimi i deponive ilegale, ndarja në burim, riciklimi dhe kompostimi.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

		riciklimin dhe promovimin e ekonomisë qarkore.		
Zhurma	Zhvillimi i transportit, korridoreve infrastrukturore dhe zonave ekonomike	Potencial për rritje të zhurmës nga trafiku, transporti i rëndë, aktivitetet industriale dhe fazat e ndërtimit.	B/C	Tampon zona ndërmjet industrisë dhe banimit, menaxhim i trafikut të rëndë, kufizim i aktiviteteve me zhurmë dhe monitorim.
Trashëgimia kulturore	Mbrojtja, restaurimi dhe valorizimi turistik i trashëgimisë kulturore dhe natyrore	Ndikim përgjithësisht pozitiv në konservimin e aseteve, identitetin territorial dhe promovimin e turizmit kulturor. PZHK përcakton mbrojtjen, restaurimin dhe menaxhimin e integruar si prioritet.	A/B	Respektimi i perimetrit dhe zonave mbrojtëse, kontrolli i ndërtimeve dhe integrimi i aseteve në planifikimin territorial.
Rreziqet natyrore	Menaxhimi i përmbytjeve, rehabilitimi i shtretërve dhe përmirësimi i drenazhimit	Reduktim i ekspozimit të popullsisë, tokës bujqësore dhe infrastrukturës ndaj përmbytjeve.	A	Mirëmbajtja dhe rehabilitimi i shtretërve e kanaleve, drenazhim, kufizim i zhvillimeve në zonat e rrezikuara dhe zgjidhje të bazuara në natyrë.
Rreziqet natyrore / Klima	Masat kundër erozionit, rrëshqitjeve dhe zjarreve dhe adaptimi ndaj ndryshimeve klimatike	Reduktim i degradimit të tokës, cenueshmërisë së shpateve dhe ekspozimit të zonave rurale e pyjore ndaj zjarreve dhe ngjarjeve ekstreme. PZHK parashikon masa specifike për erozionin, rrëshqitjet, zjarret dhe adaptimin klimatik.	A/B	Stabilizim i shpateve, ripyllëzim, breza mbrojtës, kontroll i ndërhyrjeve dhe zhvillimeve në zonat e rrezikuara dhe sisteme paralajmërimi të hershëm.

Tabela 3 Analiza e shkallës së ndikimit në komponentët mjedisore

Nga analiza e shkallës së ndikimit rezulton se shumica e zhvillimeve të planifikuara në PZHK kanë **ndikim pozitiv ose të menaxhueshëm** në komponentët mjedisorë. Ndikimet më pozitive lidhen me përmirësimin e menaxhimit të ujërave të ndotura, mbrojtjen e tokës bujqësore, ruajtjen e biodiversitetit, përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe reduktimin e rreziqeve natyrore.

Ndikime potencialisht negative paraqiten kryesisht nga zhvillimi industrial dhe logjistik, infrastruktura, aktivitetet nxjerrëse dhe zgjerimi turistik, veçanërisht në raport me ajrin, zhurmën, tokën, peizazhin dhe habitatet natyrore. Megjithatë, shumica e këtyre ndikimeve vlerësohen si të zbutshme përmes vendosjes së kushteve mjedisore, kontrollit të zhvillimit dhe zbatimit të masave adekuate mbrojtëse.

8.4 PËRPUTHSHMËRIA MJEDISORE

Niveli i përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit në funksion të Objektivave Mjedisore (OM):

FUSHAT TEMATIKE	OBJEKTIVAT MJEDISORE	OM1	OM2	OM3	OM4	OM5	OM6	OM7	OM8	OM9	OM10
	Qëllimet PZHK	Ajri	Uji	Toka	Biodiversiteti	Pyjet	Peizazhi	Nd. Klimatike	T. Natyrore Kulturore	Shëndeti	Social-ekonomik
ZHVILLIMI EKONOMIK	Q1	+/-	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	0	+	++
	Q2	+	+/-	++	+	0	+	+	0	+	++
	Q3	+	0	0	0	0	0	+	0	+	++
	Q4	+	+/-	+/-	+/-	+/-	+/-	+	++	+	++
	Q5	++	+	+	+	+	+	++	0	++	++
	Q6	-	-	-	-	-	-	-	0	-	+
	Q7	-	-/-	-/-	-/-	-	-/-	-	0	-	++
INFRASTRUKTURA TEKNIKE	Rrjeti i ujësjellësit, kanalizimit dhe drenazhimi										
	Q1	+	++	+	+	0	+	++	0	++	++
	Ujitja										
	Q1	0	+/-	++	+/-	0	+	++	0	+	++
	Energjia elektrike										
	Q1	+	0	0	0	0	+/-	+	0	+	++
	Q2	++	0	+/-	+/-	+/-	+/-	++	0	+	++
	Q3	+	0	0	0	0	+	++	0	+	+
	Energjia termike										
	Q1	++	0	0	0	+	0	+	0	++	+
	Q2	++	0	0	0	+	0	++	0	++	+
	Q3	++	0	0	+	+	+	++	0	++	+
	Telekomunikimi dhe instalimet e ngjashme										
	Q1	0	0	0	0	0	+	0	0	+	++
	Q2	+	0	0	0	0	0	+	0	+	++
	Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave										
	Q1	+	++	++	+	+	++	+	0	++	++
INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT	Q1	+/-	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	0	+	++
	Q2	++	0	0	+	0	+	++	0	++	++
	Q3	++	0	0	0	0	+	++	0	++	++
	Q4	+	0	0	0	0	0	+	0	++	++
	Q5	+	0	+/-	0	0	+/-	+	0	+	++
	Q6	++	+	+	+	+	+	++	+	++	++
INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale										
	Q1	0	0	+/-	0	0	0	0	0	++	++
	Q2	0	0	+/-	0	0	+	0	0	++	++

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

	Arsimi										
	Q1	0	0	+/-	0	0	+/-	0	0	+	++
	Q2	0	0	+/-	0	0	+	0	0	+	++
	Administratë										
	Q1	+	0	0	0	0	0	+	0	++	++
	Kulturë, rini dhe sport										
	Q1	0	0	+/-	0	0	+	0	++	+	++
	Q2	++	+	+/-	+	0	++	++	0	++	++
	Hapësira publike										
	Q1	++	+	+/-	+	+	++	++	+	++	++
MJEDISI DHE SIP. ME RREZIKSHMERI	Q2	0	+/-	-	0	0	+/-	0	+/-	+	+
	Q1	+	++	+	++	+	+	+	0	++	+
	Q2	++	+	+	+	+	+	++	0	++	+
	Q3	+	+	++	+	+	+	+	0	+	+
	Q4	+	++	++	+	+	+	++	+	++	++
	Q5	+	+	+	++	++	++	++	+	++	+
T.KULTURORE DHE NATYRORE	Q6	++	0	+/-	+/-	+/-	+/-	++	0	++	++
	Q1	0	+	+	++	+	++	+	++	+	++
VENDBANIMET	Q2	+	0	+	+/-	+/-	++	+	++	+	++
	Q1	+	+	++	+	+	++	+	+	+	++
	Q2	+	+	+	+	0	+	+	0	++	++
	Q3	++	+	+/-	+/-	0	+	++	0	++	++
	Q4	++	++	++	++	++	++	++	+	++	++
	Q5	+	+/-	++	+	+	++	++	+	+	++
V. JOFORMALE	Q6	+	+	0	+	0	+	+	+	++	++
	Q1	+	+	+	0	0	+	+	0	++	++
	Q2	0	0	0	0	0	0	0	0	++	++
	Q3	0	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	+/-	+	++
	Q4	+	++	+	0	0	+	+	0	++	++
	Q5	0	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	+/-	+	++
	Q6	+	+	++	+	+	++	+	+	+	++
	Q7	+	++	+	0	0	+	+	0	++	++
	Q8	0	0	+	0	0	+	+	0	+	++
BANIMI	Q9	0	0	0	0	0	0	0	0	+	++
	Q1	0	0	+	0	0	+	+	0	++	++
	Q2	+	+	++	+	+	++	++	+	++	++
	Q3	++	+	+/-	+	0	++	++	+	++	++
	Q4	++	0	0	0	0	+	++	0	++	++

SHFRYTËZIMI I TOKËS	Q1	+	+	++	+	+	++	+	+	+	++
	Q2	+	++	++	++	++	++	++	+	+	++
	Q3	+/-	+/-	+/-	+/-	0	+/-	+/-	0	+	++
	Q4	+	+	++	+	+	+	++	+	++	++

Tabela 4 Tabela e përputhshmërisë mjedisore të objektivave të planit në funksion të Objektivave Mjedisore

Sqarim:

++	Përputhshmëri në nivel të konsiderueshëm;
+	Përputhshmëri e knaqshme;
0	Nuk ka efekt;
-	Konflikt i vogël i mundshëm;
- / -	Konflikt i mundshëm domethënës;
+/-	Elemente të puthshmërisë dhe konfliktit;

Analiza e përputhshmërisë ndërmjet objektivave të PZHK-së dhe Objektivave Mjedisore (OM) tregon se struktura strategjike e planit paraqet një raport pozitiv ndërmjet zhvillimit të propozuar dhe kërkesave për mbrojtjen e mjedisit, por niveli i përputhshmërisë ndryshon ndjeshëm ndërmjet sektorëve.

Përputhshmëria më e lartë evidentohet te objektivat që kanë në vetvete funksion mbrojtës ose përmirësues të mjedisit, veçanërisht në fushën e menaxhimit të ujërave dhe ujërave të ndotura, mbeturinave, mbrojtjes së tokës dhe biodiversitetit, menaxhimit të rrezeve natyrore, energjisë së ripërtëritshme, mobilitetit të qëndrueshëm dhe zhvillimit të hapësirave të gjelbra e publike. Në këto raste ekziston një lidhje e drejtpërdrejtë ndërmjet qëllimeve të PZHK-së dhe përmirësimit të receptorëve mjedisorë.

Një nivel i lartë përputhshmërie paraqitet gjithashtu te zhvillimi kompakt dhe policentrik, banimi i planifikuar dhe përmirësimi i infrastrukturës publike e sociale. Efekti mjedisor i këtyre objektivave është kryesisht indirekt, por i rëndësishëm, pasi densifikimi i kontrolluar, përdorimi më efikas i infrastrukturës ekzistuese dhe shpërndarja më e balancuar e shërbimeve reduktojnë presionin për zgjerim të pakontrolluar të zonave të ndërtuara dhe, rrjedhimisht, humbjen e tokës bujqësore dhe fragmentimin e territorit.

Në anën tjetër, matrica eidenton se konfliktet kryesore potenciale përqendrohen në objektivat me intensitet më të lartë fizik të zhvillimit, kryesisht zhvillimin industrial dhe logjistik, aktivitetet nxjerrëse dhe përpunimin e resurseve minerale, korridoret dhe infrastruktura e re e transportit, si dhe disa forma të zgjerimit urban dhe turistik. Këto objektiva mund të krijojnë presione të njëkohshme mbi tokën, ujërat, cilësinë e ajrit, biodiversitetin dhe peizazhin. Veçanërisht aktivitetet nxjerrëse paraqesin shkallën më të lartë të konfliktit potencial, për shkak të karakterit të tyre transformues dhe mundësisë për efekte afatgjata mbi territorin.

Prania e vlerësimeve “+/-” në një numër të objektivave tregon se ndikimi mjedisor nuk përcaktohet vetëm nga vetë qëllimi zhvillimor, por në masë të madhe nga lokacioni, intensiteti, mënyra e projektimit dhe kushtet e zbatimit. Përputhshmëria e plotë e PZHK-së me objektivat mjedisore nuk mund të sigurohet vetëm në nivel strategjik, por kërkon kontroll në fazat pasuese të planifikimit dhe realizimit.

Në këtë kuptim, analiza nuk evidenton konflikte sistematike që do ta bënin konceptin zhvillimor të PZHK-së mjedisorisht të papranueshëm. Përkundrazi, drejtimi i përgjithshëm i planit është pozitiv, ndërsa konfliktet janë të përqendruara kryesisht në sektorë dhe ndërhyrje specifike. Për këto zhvillime kërkohet aplikimi rigorozi i kufizimeve hapësinore, masave zbutëse, kushteve mjedisore dhe, sipas rastit, vlerësimeve të mëtejshme në nivel projekti.

Si përfundim, matrica tregon se **performanca mjedisore e PZHK-së së Ferizajt do të varet më pak nga orientimet e përgjithshme strategjike, të cilat janë kryesisht të përputhshme me OM-të, dhe më shumë nga mënyra se si do të menaxhohen zhvillimet me presion të lartë territorial gjatë zbatimit.** Për këtë arsye, VSM-ja duhet të ketë rol të drejtpërdrejtë në përcaktimin e kushteve, masave zbutëse dhe monitorimit për këto zhvillime.

8.5 EFEKTET KUMULATIVE

Efektet kumulative i referohen ndikimeve të kombinuara të planit, në mjedis, me kalimin e kohës, duke marrë parasysh ndërveprimet e tyre dhe çdo sinergji ose kompromis. Në kontekstin e VSM-së, është e rëndësishme të merren parasysh efektet kumulative sepse projektet individuale mund të kenë ndikime minimale në vetvete, por kur kombinohen me projekte ose aktivitete të tjera, efektet kumulative mund të jenë të rëndësishme. Kjo mund të rezultojë në degradimin e mjedisit dhe përkeqësimin e cilësisë së jetës për komunitetin.

Për qëllime vlerësimi të mëtejshme, do të konsiderohen prioritetet strategjike të planit, të cilat potencialisht mund të kenë ndikim në mjedis.

Për vlerësimin e efekteve kumulative janë përdorur kriteret e mëposhtme:

A - Ndikim pozitiv me objektivat mjedisore;

B - Ndikim i vogël pozitiv ose neutral;

C - Ndikim i moderuar;

D – Ndikim i rëndësishëm negativ;

E - Ndikim potencialisht kritik;

X – Vlerësimi nuk është i mundur.

Komponenti mjedisor	Zhvillimi industrial, logjistik dhe aktivitetet në jetë	Zhvillimi kompakt urban dhe banimi	Transporti dhe mobiliteti	Menaxhimi i ujërave dhe ujërave të ndotura	Menaxhimi i mbeturinave / ekonomia qarkore	Energjia e ripërtëritshme dhe eficientia	Turizmi dhe rekreacioni	Mbrojtja e kapitalit natyror dhe tokës bujqësore
Uji	C	B	C	A	A	B	C	A
Ajri	D	B	C	B	A	A	B	A
Klima	C	A	C	A	B	A	B	A
Toka	D	B	C	B	A	C	C	A
Zhurma	D	B	C	B	B	B	C	A
Flora/fauna, habitatet	D	B	C	A	A	C	C	A
Peizazhi	D	B	C	B	B	C	C	A
Mbeturinat	C	C	B	B	A	B	C	B
Trashëgimia natyrore kulturore	C	C	C	B	B	B	A	A
Rreziqet natyrore dhe rezilienca	C	B	C	A	B	B	C	A

Tabela 5 Analizë matricore e efekteve kumulative të elementeve të PZHK-së

Analiza tregon se efektet kumulative më të rëndësishme potencialisht negative lidhen me koncentrimin e zhvillimit industrial, logjistik, transportues dhe të aktiviteteve nxjerrëse. Në veçanti, konsolidimi i zonave industriale dhe ekonomike në boshtin Prelez–Babush–Gërlicë dhe Mirash, së bashku me rritjen e transportit të mallrave dhe zhvillimin e infrastrukturës përcjellëse, mund të krijojë një akumulim të presioneve mbi ajrin, tokën, zhurmën, habitatet dhe peizazhin. PZHK vetë e orienton zhvillimin ekonomik drejt këtyre korridoreve dhe nyjeve strategjike.

Në këtë rast, ndikimi kumulativ është më i rëndësishëm sesa ndikimi i secilit aktivitet veçmas. Një industri e vetme mund të ketë ndikim të menaxhueshëm, por kombinimi i industrisë, magazinimit, transportit të rëndë, aktiviteteve përpunuese, ndërtimeve dhe eventualisht aktiviteteve nxjerrëse në të njëjtin korridor mund të rrisë ekspozimin e zonës ndaj ndotjes së ajrit, zhurmës, ndotjes së tokës dhe ujërave dhe ndryshimeve të peizazhit. Për këtë arsye, këto korridore duhet të konsiderohen zona prioritare për monitorim mjedisor, kanalizim industrial, paratrajtim të ujërave, breza mbrojtës dhe kontroll të trafikut të rëndë. PZHK-ja e identifikon paratrajtimin e ujërave industriale si masë të nevojshme për mbrojtjen e rrjetit dhe receptorëve natyrorë.

Nga ana tjetër, efekti kumulativ më i rëndësishëm pozitiv lidhet me menaxhimin e ujërave. Ndërtimi i ITUZ, zgjerimi i kolektorëve, lidhja e vendbanimeve me kanalizim, ndarja e ujërave fekale nga ato atmosferike dhe paratrajtimi i ujërave industriale, të zbatuara së bashku, mund të sjellin përmirësim të konsiderueshëm të cilësisë së lumit Nerodime dhe të receptorëve të tjerë ujorë. Megjithatë, ekziston një varësi e rëndësishme ndërmjet ritmit të zhvillimit dhe ritmit të ndërtimit të infrastrukturës. Nëse zonat e reja urbane dhe industriale zhvillohen më shpejt sesa ITUZ, kolektorët dhe sistemet e paratrajtimin, efekti kumulativ mund të jetë i kundërt: rritje e shkarkimeve dhe përkeqësim i mëtejshëm i gjendjes së Nerodimes. Aktualisht PZHK evidenton se ujërat e zeza shkarkohen ende të patrajtuar dhe se disa pjesë të rrjetit kanë kapacitete të pamjaftueshme. Prandaj, infrastruktura mjedisore duhet t'i paraprijë ose së paku të zhvillohet paralelisht me rritjen urbane dhe industriale.

Një tjetër ndërveprim i rëndësishëm lidhet me tokën bujqësore. Modeli kompakt dhe policentrik ka efekt pozitiv kumulativ, sepse orienton rritjen drejt strukturave ekzistuese, densifikimit dhe përdorimit të kapaciteteve ekzistuese. Kjo redukton nevojën për zgjerim horizontal dhe konsum të ri të tokës. Megjithatë, ky efekt pozitiv mund të dobësohet nëse zgjerimi i zonave ekonomike, korridoreve të transportit, objekteve publike, infrastrukturës energjetike dhe zhvillimeve periferike realizohet në mënyrë të shpërndarë. Secili zhvillim mund të kërkojë sipërfaqe relativisht të kufizuar, por efekti i tyre i kombinuar mund të çojë në fragmentim dhe humbje graduale të tokës bujqësore, veçanërisht në zonat fushore përreth qytetit dhe korridoreve kryesore.

Në raport me biodiversitetin, pyjet dhe peizazhin, ndërveprimi më i ndjeshëm paraqitet ndërmjet mbrojtjes së kapitalit natyror dhe zhvillimit turistik. PZHK synon zhvillimin e Jezercit dhe zonave të tjera malore për rekreacion, ecje, kamping dhe turizëm natyror, duke i lidhur këto hapësira me korridore të gjelbra. Kjo mund të krijojë efekte pozitive ekonomike dhe të nxisë valorizimin e natyrës, por rritja kumulative e bujtinave, rrugëve të qasjes, parkingjeve, objekteve turistike dhe numrit të vizitorëve mund të shkaktojë fragmentim të habitateve, presion mbi pyjet, prodhim të mbeturinave dhe ndryshim të karakterit peizazhor. Për këtë arsye, Jezerca, Nerodimja, Pleshina dhe Burrniku kërkojnë kontroll më të lartë të intensitetit të zhvillimit turistik dhe shmangien e ndërtimit të shpërndarë.

Efekte të rëndësishme pozitive kumulative priten edhe nga tranzicioni energjetik. Kombinimi i energjisë së ripërtëritshme, rehabilitimit energjetik të ndërtesave, zhvillimit të sistemit të organizuar të ngrohjes dhe mobilitetit të qëndrueshëm mund të reduktojë gradualisht emetimet dhe varësinë nga sistemet individuale joefikase të ngrohjes. PZHK parashikon diversifikim të burimeve të ngrohjes, integrim të burimeve të ripërtëritshme dhe përmirësim të performancës energjetike të ndërtesave. Megjithatë, këto përfitime mund të kompensohen pjesërisht nga rritja e aktiviteteve industriale dhe transportit të mallrave; për këtë arsye, efekti neto klimatik do të varet nga shkalla reale e kalimit drejt transportit të qëndrueshëm, energjisë së pastër dhe efijencës energjetike.

Menaxhimi i mbeturinave paraqet një tjetër efekt pozitiv ndërsektorial. Kalimi drejt ndarjes në burim, riciklimit, kompostimit dhe ekonomisë qarkore mund të ulë njëkohësisht presionin mbi tokën, ujërat dhe ajrin. Ky efekt bëhet veçanërisht i rëndësishëm pasi zhvillimi industrial, ndërtimor, turistik dhe urban do të rrisë sasinë dhe diversitetin e mbeturinave. Për këtë arsye, kapacitetet e menaxhimit të mbeturinave duhet të rriten paralelisht me zhvillimet që gjenerojnë flukse të reja të mbetjeve.

Nga aspekti hapësinor, analiza identifikon disa zona ku ndërthurja e presioneve kërkon vëmendje të veçantë:

- korridori Prelez–Babush–Gërlicë–Mirash, për shkak të kombinimit të industrisë, logjistikës, transportit dhe zhvillimeve infrastrukturore;
- lumi Nerodime dhe segmentet urbane e të poshtme të tij, ku ndërthuren shkarkimet urbane, industriale, zhvillimi territorial dhe rreziku nga përmytjet;
- tokat bujqësore në periferi të zonës urbane dhe përgjatë korridoreve zhvillimore, për shkak të presionit kumulativ për ndryshim përdorimi;
- zonat Jezerc–Nerodime–Pleshinë–Burnnik, ku zhvillimi turistik ndërvepron me pyjet, biodiversitetin dhe peizazhin;
- zonat e ekspozuara ndaj përmytjeve dhe erozionit, ku zhvillimet e reja mund të rrisin ekspozimin dhe dëmet potenciale.

9. MASAT E NEVOJSHME PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

9.1 KONCEPTET ZHVILLIMORE TË PËRDORIMIT TË TOKËS, ZHVILLIMI KOMPAKT

Zhvillimi kompakt dhe policentrik paraqet një nga masat kryesore për kufizimin e presionit mbi tokën dhe resurset natyrore. PZHK orienton rritjen drejt zonave ekzistuese të ndërtuara, përmes plotësimit të hapësirave të lira dhe densifikimit të kontrolluar, duke synuar reduktimin e zgjerimit të panevojshëm në tokat bujqësore dhe zonat natyrore.

Në zbatim të këtij koncepti duhet të:

- kufizohet zgjerimi horizontal mbi tokat bujqësore me vlerë të lartë;
- shmanget zhvillimi i shpërndarë dhe linear përgjatë rrugëve;
- orientohen zhvillimet e reja në zona me infrastrukturë të mjaftueshme;
- përqendrohen aktivitetet industriale dhe logjistike në zonat e planifikuara;
- ruhen korridoret ekologjike, brezat e gjelbër dhe ndarja funksionale ndërmjet zonave urbane dhe rurale;
- kushtëzohen zhvillimet më intensive me plane të hollësishme dhe vlerësim të kapaciteteve infrastrukturore.

Këto masa janë të rëndësishme sidomos për të shmangur humbjen graduale dhe fragmentimin e tokës si rezultat i ndërthurjes së zhvillimeve urbane, ekonomike dhe infrastrukturore.

9.2 NDRYSHIMET KLIMATIKE

Ndryshimet klimatike duhet të trajtohen në PZHK kryesisht përmes rritjes së reziliencës së territorit ndaj përmytjeve, reshjeve intensive, valëve të nxehtësisë dhe degradimit të tokës. Në Ferizaj, sistemi aktual i drenazhimit dhe kanalizimit atmosferik ka kapacitete të kufizuara në disa zona dhe gjatë reshjeve intensive paraqitet rrezik për mbingarkesë dhe vërshime lokale.

Masat kryesore duhet të përfshijnë:

- Përmirësimin dhe ndarjen graduale të sistemit të drenazhimit atmosferik nga kanalizimi fekal;
- Kufizimin e zhvillimeve të reja në zonat e ekspozuara ndaj përmytjeve dhe erozionit;
- Zvogëlimin e sipërfaqeve të papërshkueshme dhe rritjen e sipërfaqeve të gjelbra në zonën urbane;
- Ruajtjen e korridoreve ujore dhe brezave mbrojtës përgjatë lumenjve;
- Shtimin e gjelbërimit dhe hijezimit në zonat me dendësi të lartë ndërtimore;
- Promovimin e efikasitetit energjetik, energjisë së ripërtëritshme dhe mobilitetit të qëndrueshëm;
- Integrimin e rrezikut klimatik në planifikimin e ndërtimeve dhe infrastrukturës së re.

PZHK e përcakton adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike dhe rritjen e reziliencës si prioritet të zhvillimit, ndërsa për zonën urbane kërkon sisteme më të qëndrueshme të drenazhimit, më shumë gjelbërim dhe zvogëlim të sipërfaqeve të papërshkueshme.

9.3 CILËSIA E AJRIT

Vlerësimi i cilësisë së ajrit në Ferizaj kufizohet nga mungesa e një stacioni lokal monitorues. Për këtë arsye, një nga masat prioritare është krijimi i sistemit lokal të monitorimit dhe inventarizimi i burimeve kryesore të emetimeve, në mënyrë që masat e ardhshme të bazohen në të dhëna reale për territorin e komunës.

Masat kryesore për përmirësimin e cilësisë së ajrit përfshijnë:

- Vendosjen e së paku një stacioni lokal për monitorimin e PM10, PM2.5, NO₂, SO₂, CO dhe O₃;
- Identifikimin dhe hartëzimin e burimeve të ndotjes nga trafiku, ngrohja, industria dhe aktivitetet ndërtimore;
- Reduktimin gradual të emetimeve nga ngrohja individuale përmes eficiencës energjetike dhe përdorimit të burimeve më të pastra;
- Përmirësimin e transportit publik, mobilitetit aktiv dhe menaxhimit të trafikut në zonat me ngarkesë të lartë;
- Kontrollin e emetimeve dhe pluhurit nga zonat industriale dhe aktivitetet ndërtimore;
- Integrimin e brezave dhe korridoreve të gjelbra në zonën urbane dhe përgjatë akseve me trafik të lartë.

9.4 HAPËSIRAT E GJELBRA DHE INFRASTRUKTURA E GJELBËR

Hapësirat e gjelbra duhet të trajtohen si pjesë funksionale e strukturës urbane dhe ekologjike të komunës, jo vetëm si sipërfaqe rekreative. PZHK parasheh krijimin e një rrjeti të integruar që lidh parqet, sheshet, sipërfaqet sportive, brezat mbrojtës dhe korridoret përgjatë rrjedhave ujore, me lidhje funksionale edhe me Bifurkacionin e Nerodimes dhe zonat natyrore jashtë qytetit.

Masat kryesore përfshijnë:

- Ruajtjen dhe zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane dhe peri-urbane;
- Krijimin e parqeve të reja dhe brezave të gjelbër në zonat me dendësi më të lartë ndërtimore;
- Ruajtjen e korridoreve ekologjike që lidhin pyjet, lumenjtë, tokat bujqësore dhe hapësirat e gjelbra;
- Sigurimin e brezave mbrojtës dhe gjelbërimit përgjatë lumit Nerodime dhe rrjedhave të tjera ujore;
- Ripyllëzimin dhe rehabilitimin e sipërfaqeve të degraduara;
- Shmangien e fragmentimit të pyjeve dhe habitateve nga zhvillimet e reja urbane, infrastrukturore dhe turistike.

9.5 ENERGJIA E RIPËRTËRITSHME DHE EFIÇIENCA ENERGJETIKE

Zhvillimi i energjisë së ripërtëritshme dhe rritja e efiçencës energjetike paraqesin masa të rëndësishme për reduktimin e emetimeve dhe përmirësimin e performancës mjedisore të komunës. PZHK identifikon potencial për energji diellore dhe të erës, por kërkon që zhvillimi i këtyre kapaciteteve të mos cenojë tokat bujqësore me vlerë të lartë, pyjet, habitatet dhe peizazhet natyrore.

Masat kryesore përfshijnë:

- Përcaktimin e zonave të përshtatshme për zhvillimin e energjisë diellore dhe të erës;
- Instalimin e sistemeve fotovoltaike në objekte publike, biznese dhe zona ekonomike;
- Shmangien e projekteve energjetike në tokat bujqësore cilësore dhe zonat me ndjeshmëri të lartë mjedisore;
- Rehabilitimin energjetik të ndërtesave ekzistuese dhe përmirësimin e izolimit termik;
- Aplikimin e standardeve të efiçencës energjetike në ndërtesat e reja;
- Promovimin e sistemeve më efikase dhe më të pastra të ngrohjes.

PZHK parashikon gjithashtu projekte pilot për efiçencë energjetike, instalimin e sistemeve fotovoltaike dhe vlerësimin e mundësive për zhvillimin e një sistemi të organizuar të ngrohjes.

9.6 MBROJTJA E TOKËS

Mbrojtja e tokës është veçanërisht e rëndësishme për Ferizajn për shkak të presionit nga zgjerimi urban, aktivitetet ekonomike, ndërtimtaria, mbeturinat dhe proceset erozive. PZHK e trajton mbrojtjen e tokës bujqësore dhe menaxhimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore si prioritet të zhvillimit.

Masat kryesore përfshijnë:

- Kufizimin e konvertimit të tokave bujqësore me vlerë të lartë në përdorime ndërtimore;
- Rehabilitimin dhe rikultivimin e sipërfaqeve të degraduara;
- Kontrollin e ndotjes së tokës nga aktivitetet industriale, mbeturinat dhe materialet ndërtimore;
- Monitorimin e zonave të ekspozuara ndaj erozionit dhe degradimit;
- Stabilizimin e sipërfaqeve me rrezik të lartë eroziv;
- Kontrollin e përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike në zonat bujqësore;
- Integrimin e masave për mbrojtjen e tokës në projektet infrastrukturore dhe zhvillimore.

Në zonat e prekura nga aktivitetet nxjerrëse duhet të kërkohet rehabilitim dhe rikultivim i detyrueshëm pas përfundimit të shfrytëzimit, ndërsa zhvillimet e reja duhet të shmangin tokat bujqësore, zonat ujore dhe sipërfaqet me ndjeshmëri të lartë mjedisore.

9.7 MBROJTJA E RESURSEVE UJORE

Mbrojtja e resurseve ujore përbën një nga prioritetet kryesore mjedisore për Ferizajn, veçanërisht për lumin Nerodime dhe ujërat nëntokësore. Presionet kryesore lidhen me shkarkimet e ujërave të patrajtuara, aktivitetet industriale, zhvillimet urbane dhe ndërhyrjet përgjatë rrjedhave ujore. PZHK synon reduktimin e këtyre presioneve dhe përmirësimin gradual të gjendjes ekologjike të lumit Nerodime.

Masat kryesore përfshijnë:

- Ndërtimin dhe funksionalizimin e ITUZ Ferizaj Jug dhe zgjerimin e rrjetit të kanalizimit;
- Eliminimin gradual të shkarkimeve të patrajtuara në lumin Nerodime dhe përrenjtë;
- Paratrajtimin e detyrueshëm të ujërave të ndotura industriale para shkarkimit në rrjetin publik;
- Ndarjen graduale të kanalizimit fekal nga sistemi i ujërave atmosferike;
- Përcaktimin dhe respektimin e brezave mbrojtës përgjatë lumenjve, burimeve dhe zonave ujëmbledhëse;
- Kontrollin e ndërtimeve dhe aktiviteteve ndotëse në zonat me ndjeshmëri të lartë ujore;
- Ruajtjen e segmentit të sipërm të Nerodimes në Jezercë nga zhvillimet që mund të cenojnë cilësinë e ujit;
- Monitorimin periodik të cilësisë së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore.

9.8 REDUKTIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË NATYRORE

Rreziqet kryesore natyrore në Ferizaj lidhen me përmbytjet, erozionin, rrëshqitjet lokale dhe zjarret. Zonat e Gurrëzës dhe Tërnit paraqiten me rrezik më të lartë nga përmbytjet, ndërsa rreth 19% e territorit është identifikuar me shkallë të lartë të erozionit.

Masat kryesore përfshijnë:

- Kufizimin e ndërtimeve të reja në zonat me rrezik të lartë nga përmbytjet;
- Pastrimin dhe mirëmbajtjen e lumenjve, kanaleve dhe sistemeve të drenazhimit;
- Krijimin e zonave tampon dhe sipërfaqeve për mbajtjen dhe infiltrimin e ujërave atmosferike;
- Integrimin e hartave të rrezikut në planifikimin e zhvillimeve të reja;
- Pyllëzimin dhe rikthimin e mbulesës bimore në zonat e ekspozuara ndaj erozionit;
- Kontrollin e ndërtimeve dhe punimeve infrastrukturore në terrenet e ndjeshme;
- Zbatimin e masave për stabilizimin e shpateve dhe drenazhimin në zonat me potencial për rrëshqitje lokale;
- Mirëmbajtjen e zonave pyjore dhe masat parandaluese ndaj zjarreve.

9.9 MENAXHIMI I MBETURINAVE

Menaxhimi i mbeturinave në Ferizaj duhet të kalojë gradualisht nga sistemi i orientuar kryesisht në grumbullim dhe largim, drejt një sistemi që përfshin ndarjen në burim, riciklimin, kompostimin dhe trajtimin e rrymave të veçanta të mbeturinave. Megjithëse mbulueshmëria me shërbim është relativisht e lartë, në zonat rurale ajo mbetet e pabarabartë, ndërsa mungojnë kapacitete të organizuara për riciklim dhe kompostim.

Masat kryesore përfshijnë:

- Zgjerimin e shërbimit të grumbullimit në të gjitha vendbanimet, me prioritet zonat rurale;
- Vendorsjen graduale të sistemit të ndarjes së mbeturinave në burim;
- Krijimin e pikave dhe qendrave për grumbullim, ndarje dhe riciklim;
- Zhvillimin e kapaciteteve për kompostimin e mbeturinave organike;
- Menaxhimin e veçantë të mbeturinave ndërtimore, industriale, elektronike, të rrezikshme dhe të vëllimshme;
- Eliminimin dhe rehabilitimin e lokacioneve me hedhje ilegale dhe forcimin e kontrollit për parandalimin e tyre;
- Krijimin e një baze të unifikuar të të dhënave për gjenerimin, grumbullimin, trajtimin dhe riciklimin e mbeturinave.

PZHK i përcakton këto ndërhyrje si pjesë të kalimit drejt ekonomisë qarkore, duke synuar reduktimin e sasisë së mbeturinave që përfundon në deponim dhe përmirësimin e kontrollit mbi të gjithë ciklin e menaxhimit të tyre.

10. PLANI I MONITORIMIT

Monitorimi në vetvete, është grumbullimi sistematik, analiza dhe përdorimi i informacionit mbi progresin e një strategjie, plani, programi apo projekti, në një periudhë të caktuar. Ai jep mundësinë për konstatimin e problemeve dhe zgjidhjen e tyre gjatë zbatimit. Bazohet mbi objektivat e caktuara dhe aktivitetet e planifikuara gjatë fazave të planifikimit të procesit, duke ndihmuar në ruajtjen e përqendrimit në kapacitetet dhe kapacitete më të mira të manaxhimit. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor mandaton autoritetet përgjegjëse të monitorojnë efektet e mundshme mjedisore të secilit plan apo program, me qëllim identifikimin e efekteve të kundërta, të paparashikuara, në një fazë më të hershme, që të mund të ndërmerren veprime të menjëhershme rehabilituese.

Deri më sot, Kosova ka ndjekur përafrimin me standardet mjedisore të BE-së me përparime të rëndësishme në legjislacion në lidhje me mbrojtjen e mjedisit në tërësi, VNM, VSM, IPPC (International Plant Protection Convention) dhe Mbrojtjen e Natyrës. Mbrojtja e Mjedisit, VSM, VNM dhe Planifikimi Hapësinor grupohen në legjislacionin horizontal dhe transpozimi i legjislacionit të BE-së në sektorin horizontal është i avancuar. Direktiva e VSM 2001/42/EC dhe Direktiva për Pjesëmarrjen Publike 2003/35/EC raportohen si të transpozuar plotësisht. Për sa i përket vlerësimit të ndikimit në mjedis, transpozimi i plotë është arritur në lidhje me dispozitat e Direktivës 2011/92/BE.

Neni 10 i Direktivës së VSM gjithashtu mandaton shtetet anëtare të monitorojnë efektet e rëndësishme mjedisore të zbatimit të planeve dhe programeve në mënyrë që, ndër të tjera, të identifikojnë në një fazë të hershme efektet negative të paparashikuara dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin veprimet e duhura korrigjuese.

Qëllimi i planit të monitorimit është që të sigurojë të dhëna përmes të cilave vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, duke siguruar që aktivitetet e propozuara nuk shkaktojnë nivele të papranueshme të efekteve mjedisore apo rrezik për shëndetin publik. Monitorimi i elementeve të mjedisit është aspekt kryesor për të mbajtur nën kontroll zbatimin e strategjive, planeve, programeve dhe projekteve.

Me qëllim që PZHK të zbatohet me efektivitet dhe të realizohen objektivat dhe synimet që janë paraparë me këtë plan, është e domosdoshme që të monitorohet zbatimi i të njëjtit, për të shmangur që në fazat fillestare ndikimet eventuale negative në mjedis. Në mënyrë që zbatimi i planit të monitorimit mjedisor të jetë sa më efektiv, tabela e mëposhtme i referohet objektivave të përcaktuara për mbrojtjen e mjedisit dhe seksionin që trajton ndikimet dhe masat zbutëse. Realizimi me sukses kërkon angazhimin e institucioneve relevante, për bashkërendimin e aktiviteteve përkatëse monitoruese nën drejtimin e Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).

Mbështetur në Ligjin Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Ligjin Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor dhe Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Komuna e Ferizajt ka për detyrë të kryej monitorimin e aktiviteteve që kryhen në kuadrin e zbatimit të PZHK-së. Sipas Ligjit për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, rezultatet e monitorimit duhet të publikohen nga Komuna, në mënyrë periodike çdo vit. Për elementet e tjerë të mjedisit dhe monitorimin, duhet të procedohet sipas ligjeve që mbulojnë fushën e VSM, dhe rezultatet t'i përcillen Komunës dhe AMMK-së. Kjo e fundit ka detyrimin ligjor t'i publikojë në kuadër të Raportit Vjetor për Gjendjen e Mjedisit në Republikën e Kosovës.

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

Receptorët mjedisor	Objektivat e monitorimit	Indikatori	Raportimi	Institucioni pergjegjes
Ajri	Përmirësimi i cilësisë së ajrit dhe kontrolli i burimeve të emetimeve	PM10, PM2.5, NO ₂ , SO ₂ , CO, O ₃ ; numri i burimeve të identifikuar; emetimet nga industria, trafiku dhe ngrohja	Monitorim i vazhdueshëm pas vendosjes së stacionit; raportim vjetor	DUMM; IHMK/ MMPHI
Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore	Përmirësimi i cilësisë së Nerodimes dhe mbrojtja e burimeve ujore	Parametrat fiziko-kimikë dhe biologjikë; numri i shkarkimeve të patrajuara; cilësia e ujërave nëntokësore; gjendja e segmentit Gërlaç–Nerodime e Poshtme	Tremujor; raportim vjetor	DSHPE; MMPHI
Ujërat e ndotura dhe kanalizimi	Reduktimi i shkarkimeve të patrajuara dhe rritja e mbulimit me trajtim	% e popullsisë së lidhur në kanalizim; % e ujërave të trajtuara; numri i shkarkimeve direkte; progresi i ITUZ Ferizaj Jug; funksionimi i kolektorëve	6 muaj	DSHPE; KRU “Bifurkacioni” Sh.A. – Ferizaj; për ITUZ-in edhe MMPHI dhe institucionet përkatëse të Komunës së Kaçanikut
Toka dhe sipërfaqet e degraduara	Parandalimi i ndotjes dhe rehabilitimi i sipërfaqeve të degraduara	Sipërfaqja e tokës së degraduar; lokacionet me ndotje; sipërfaqet e rehabilituara; ndryshimi i përdorimit të tokës; rezultatet e analizave të tokës në zonat prioritare	Vjetor; analiza shtesë sipas nevojës	DUMM; AMMK
Toka bujqësore	Kufizimi i humbjes dhe fragmentimit të tokave bujqësore me vlerë të lartë	Sipërfaqja e tokës bujqësore e konvertuar; sipërfaqja sipas klasave të bonitetit; përdorimi i pesticideve dhe plehrave kimike	Vjetor	DBP; DUMM
Biodiversiteti dhe habitatet	Ruajtja e habitateve, korridoreve ekologjike dhe zonave me vlera natyrore	Gjendja dhe sipërfaqja e habitateve; ndryshimi/fragmentimi i korridoreve ekologjike; ndërhyrjet në zonat natyrore; gjendja e Bifurkacionit të Nerodimes	Vjetor	DUMM; MMPHI / Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
Pyjet	Ruajtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i fondit pyjor	Sipërfaqja pyjore; sipërfaqja e rryllëzuar; prerjet ilegale; sipërfaqet e dëmtuara nga zjarret dhe erozioni	Vjetor	DBP; Agjencia e Pyjeve e Kosovës / MBPZHR

DRAFT VLERËSIMI STRATEGJIK MJEDISOR I PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË FERIZAJT 2026 - 2034

Hapësirat e gjelbra dhe peizazhi	Rritja e infrastrukturës së gjelbër dhe kufizimi i fragmentimit të peizazhit	Sipërfaqja e hapësirave të gjelbra; parqet e reja; gjatësia/sipërfaqja e korridoreve të gjelbra; brezat mbrojtës; ndërhyrjet me ndikim të lartë peizazhor	Vjetor	DUMM
Klima dhe energjia	Rritja e reziliencës klimatike dhe reduktimi i konsumit dhe emetimeve nga energjia	Konsumi energjetik i ndërtesave publike; numri/sipërfaqja e instalimeve fotovoltaike; objektet e rehabilituara energjetikisht; përdorimi i burimeve të ripërtëritshme	Vjetor	DUMM; Drejtoria për Infrastrukturë; Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE)
Mbeturinat	Rritja e mbulimit me shërbim dhe kalimi drejt ndarjes, riciklimit dhe kompostimit	% e mbulimit me shërbim; sasia e mbeturinave të grumbulluara; sasia e ndarë/ricikluar/kompostuar; numri i deponive ilegale; lokacionet e rehabilituara	6 muaj	DSHPE; KRM “Pastërtia” Sh.A. – Ferizaj
Përmbytjet	Reduktimi i ekspozimit të popullsisë, ndërtimeve dhe infrastrukturës ndaj përmbytjeve	Sipërfaqja dhe objektet e ekspozuara; numri i ngjarjeve; gjendja e shtretërve dhe kanaleve; ndërhyrjet në zonat e rrezikuara	Vjetor dhe pas ngjarjeve të mëdha	DSHPE; MMPHI
Erozioni dhe rrëshqitjet lokale	Kufizimi i degradimit të tokës dhe stabilizimi i zonave të ndjeshme	Sipërfaqja sipas shkallës së erozionit; lokacionet me rrëshqitje; sipërfaqet e stabilizuara/ripyllëzuara; sedimentimi në rrjedhat ujore	Vjetor dhe pas reshjeve ekstreme	DBP; DUMM
Zjarret	Parandalimi dhe reduktimi i dëmeve nga zjarret në pyje dhe sipërfaqe rurale	Numri i rasteve; sipërfaqja e djegur; lokacionet e përsëritura; masat parandaluese të realizuara	Sezonal dhe vjetor	DSHPE; DBP
Zhurma	Reduktimi i ekspozimit ndaj ndotjes akustike në zonat urbane dhe përgjatë korridoreve të transportit	Nivelet dB(A); numri i zonave/lokacioneve me tejkalime; ankesat; burimet kryesore të zhurmës	6 muaj në zonat prioritare; raportim vjetor	DUMM; MMPHI
Trashëgimia natyrore dhe kulturore	Mbrojtja e aseteve dhe kontrolli i ndikimeve nga zhvillimet e reja	Gjendja e aseteve të mbrojtura; ndërhyrjet pranë tyre; projektet e restaurimit; presionet turistike dhe urbanistike	Vjetor	Për trashëgiminë natyrore: DUMM / Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës; për

				trashëgiminë kulturore: DKRS / institucionet kompetente të trashëgimisë kulturore
Shëndeti publik	Evidentimi i ndikimeve mjedisore me rëndësi për shëndetin e popullsisë	Tregues të lidhur me cilësinë e ujit dhe ajrit; rastet me potencial lidhjeje me ndotjen; ekspozimi ndaj rreziqeve natyrore	Vjetor	DSHMS; institucionet shëndetësore kompetente
Shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimi urban	Kontrolli i zbatimit të konceptit kompakt dhe mbrojtja e zonave me kufizime mjedisore	Ndryshimet e përdorimit të tokës; zgjerimi i sipërfaqeve të ndërtuara; densifikimi; zhvillimet në tokë bujqësore dhe zona të ndjeshme	Vjetor, përmes GIS	DUMM

Tabela 6 Plan i Monitorimit Mjedisor

11. PËRFUNDIME

Raporti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor i PZHK së Komunës së Ferizajt, ka për qëllim të integrojë sistematikisht çështjet mjedisore. Gjatë implementimit të PZHK si dhe procesit të vendimmarrjes, VSM synon të marrë masa plotësuese për projektet të cilat do të realizohen. VSM, si e tillë përkufizohet si:

- Një nga instrumentet kyç për integrimin e çështjeve mjedisore dhe parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm në planifikimin strategjik dhe vendimmarrjen. Ai është një mjet i njohur globalisht për planifikimin me pjesëmarrje që përdoret për të analizuar dhe përfshirë çështjet e mjedisit në politikat, planet dhe programet e propozuara;
- Instrument i cili do të sigurojë udhëzime për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve dhe konsideratave mjedisore të PZHK-së;
- VSM jep udhëzime për përfshirjen e çështjeve mjedisore në projektet të cilat do të realizohen në të ardhmen;
- Raporti i VSM-së propozon rregullore institucionale për menaxhimin e qëndrueshëm të aspekteve mjedisore të PZHK-së.

PZHK prezanton një profil, koncept të zhvillimit hapësinor, vizion, prioritetet strategjike, e masa zbatimi. Skenari i përzgjedhur, i bazuar në zhvillimin policentrik dhe integrimin funksional të territorit, synon shpërndarjen më të balancuar të zhvillimit ndërmjet qytetit, qendrave të rendit të mesëm dhe korridoreve zhvillimore.

Nga analiza e gjendjes ekzistuese rezulton se çështjet që kërkojnë vëmendjen më të madhe gjatë zbatimit të Planit janë ndotja e lumit Nerodime, mungesa e trajtimit të plotë të ujërave të ndotura, presioni mbi tokën bujqësore, ndotja e ajrit, menaxhimi i mbeturinave, degradimi lokal i tokës, rreziku nga përmbytjet dhe erozioni, si dhe presioni mbi pyjet, habitatet dhe peizazhet natyrore. Një kufizim i rëndësishëm mbetet mungesa e monitorimit të vazhdueshëm lokal për disa komponentë, veçanërisht ajrin dhe tokën.

Analiza e përputhshmërisë tregon se pjesa më e madhe e objektivave të PZHK-së janë në përputhje me objektivat mjedisore. Përfitimet më të qarta lidhen me zhvillimin kompakt, trajtimin e ujërave të ndotura, përmirësimin e sistemit të mbeturinave, energjinë e ripërtëritshme, mobilitetin e qëndrueshëm, mbrojtjen e tokës dhe biodiversitetit dhe rritjen e reziliencës ndaj ndryshimeve klimatike.

Në anën tjetër, zhvillimi industrial dhe logjistik, aktivitetet nxjerrëse, infrastruktura e re e transportit dhe zhvillimet turistike në zonat natyrore paraqesin burimet kryesore të ndikimeve potencialisht negative. Nëse këto zhvillime përqendrohen në të njëjtat zona, ndikimet individuale mund të kombinohen dhe të krijojnë presion më të madh mbi ajrin, ujërat, tokën, zhurmën, biodiversitetin dhe peizazhin. Për këtë arsye, vlerësimi i projekteve të veçanta nuk duhet të bëhet vetëm në bazë të ndikimit të tyre individual, por edhe duke marrë parasysh zhvillimet ekzistuese dhe të planifikuara në zonën përreth.

VSM nuk ka identifikuar ndikime strategjike të një niveli të tillë që do ta bënin PZHK-në të papranueshme në aspektin mjedisor. Megjithatë, kjo vlen me kusht që masat mbrojtëse dhe zbutëse të integrohen në fazat e mëtejshme të planifikimit dhe zbatimit, veçanërisht në zonat industriale dhe ekonomike, përgjatë lumit Nerodime, në tokat bujqësore me vlerë të lartë, në zonat me rrezik nga përmbytjet dhe në hapësirat pyjore e malore.

Është prioritet që zgjerimi urban dhe ekonomik të shoqërohet ose të paraprihet nga infrastruktura për kanalizim dhe trajtim të ujërave, drenazhim, menaxhim të mbeturinave, transport dhe shërbime të tjera. Përndryshe, zhvillimi mund të tejkalojë kapacitetet ekzistuese dhe të rrisë presionet që PZHK synon t'i reduktojë.

Në këtë kuptim, VSM duhet të trajtohet si pjesë e procesit të zbatimit të PZHK-së dhe jo vetëm si dokument përcjellës. Masat e përcaktuara dhe plani i monitorimit duhet të përdoren për të verifikuar në mënyrë periodike nëse zhvillimet po realizohen në përputhje me objektivat mjedisore dhe për të ndërmarrë masa korrigjuese kur evidentohen ndikime të paparashikuara. Vetë qëllimi i monitorimit në VSM është identifikimi në fazë të hershme i efekteve negative dhe mundësi i ndërhyrjeve korrigjuese.

Si përfundim, PZHK e Ferizajt mund të konsiderohet e pranueshme nga aspekti i Vlerësimit Strategjik Mjedisor, me kusht që kriteret mjedisore, masat zbutëse dhe sistemi i monitorimit të përcaktuar në këtë raport të zbatohen gjatë gjithë periudhës së implementimit të Planit 2026–2034.

12. LITERATURA

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Raport Vjetor për Gjendjen e Mjedisit 2023. Prishtinë, 2024.
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK). Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë 2023–2024. Prishtinë, 2025.
- Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave 2024 dhe të dhënat statistikore për Komunën e Ferizajt.
- KRU “Bifurkacioni” Sh.A. – Ferizaj. Raporti Vjetor 2024.
- Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës / AMMK. Të dhënat dhe raportet e monitorimit të cilësisë së ajrit dhe ujërave të përdorura për vlerësimin e gjendjes mjedisore.
- Komuna e Ferizajt dhe institucionet komunale përkatëse. Të dhëna sektoriale për përdorimin e tokës, infrastrukturën, pyjet, bujqësinë, mbeturinat, rreziqet natyrore dhe trashëgiminë.

13. LEGJISLACIONI DHE DOKUMENTET NDËRKOMBËTARE

- Republika e Kosovës. Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit.
- Republika e Kosovës. Ligji Nr. 03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor.
- Republika e Kosovës. Ligji Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor.
- Republika e Kosovës. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- Republika e Kosovës. Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja.
- MMPH. Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor.
- Bashkimi Evropian. Direktiva 2001/42/EC për vlerësimin e efekteve të planeve dhe programeve të caktuara në mjedis.
- Bashkimi Evropian. Direktiva 2003/35/EC për pjesëmarrjen e publikut në hartimin e planeve dhe programeve të caktuara që lidhen me mjedisin.
- Bashkimi Evropian. Direktiva 2011/92/EU për vlerësimin e ndikimeve të projekteve të caktuara publike dhe private në mjedis.
- UNECE. Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters – Aarhus Convention, 1998.
- United Nations. Transforming our World: the 2030 Agenda for Sustainable Development, 2015.